



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Akademia e Drejtësisë - Akademija Pravde - Academy of Justice**

---

# **RAPORTI VJETOR**

## **2020**

Prishtinë, 2021

I. Tabela e Përmbajtjes .....	2
II. FJALA HYRËSE .....	6
III. Përmbledhje ekzekutive.....	7
IV. Mandati i Akademisë së Drejtësisë .....	8
2.1 Korniza ligjore dhe fuqizimi i Akademisë së Drejtësisë.....	8
2.2 Funkcionet dhe kompetencat e Akademisë së Drejtësisë.....	10
2.3 Organet e Akademisë së Drejtësisë.....	10
2.3.1 Këshilli Drejtues -Përbërja, kompetencat dhe aktivitetet e ndërmarra.....	11
Aktivitetet e Këshillit Drejtues .....	12
2.3.2 Këshilli Programor - Përbërja, kompetencat dhe aktivitetet e ndërmarra .....	13
2.3.4 Organizimi i brendshëm dhe udhëheqja e Akademisë së Drejtësisë.....	14
V. Të arriturat dhe sfidat në zbatimin e planit të punës dhe programin trajnues gjatë vitit 2020 .....	17
3.1 Sfidat në zbatimin e programeve trajnuese gjatë vitit 2020 .....	18
3.2 Të arriturat në zbatimin e programit trajnues 2020.....	19
3.2.1 Arritja e objektivave në kuadër të Programeve të Akademisë së Drejtësisë .....	19
3.2.2 Ngritja e cilësisë së trajnimeve dhe avancimi i metodologjisë trajnuese në programet e Akademisë së Drejtësisë .....	20
VI. Përshkrim i aktiviteteve të realizuara sipas programeve të Akademisë së Drejtësisë.....	23
4.1 Programi i Trajnimit Fillestar .....	26
4.1.1 Të arriturat dhe sfidat sipas objektivave të parapara në Programin e Trajnimit Fillestar për vitin 2020.....	27
4.1.2 Vazhdimi i trajnimit fillestar për gjyqtarët e sapoemëruar, gjenerata e VII (2019-2020).....	27
4.1.3 Vazhdimi i trajnimit fillestar i prokurorëve - gjenerata e tetë (2019-2020).....	28
4.1.4 Metodologjia trajnuese.....	29
4.1.5 Testi përfundimtar .....	29
4.2 Programi për Trajnime të Vazhdueshme .....	29
4.2.1 Objektivat e Programit për Trajnim të Vazhdueshëm për vitin 2020 .....	30
4.2.2 Aktivitetet trajnuese të zhvilluara në PTV .....	30
4.2.3 Pjesëmarrja në Programin e Trajnimit të Vazhdueshëm .....	32
4.2.4 Trajnimet e vazhdueshme sipas fushave .....	34
Program i specializuar trajnimi për zhvillimin e kapaciteteve në luftën kundër korrupsionit .....	35
Program i specializuar trajnimi në forcimin e kapaciteteve profesionale në luftimin e shpëlarjes së parave.....	35

Program i specializuar trajnimi për prokurimin publik.....	36
Program i specializuar trajnimi në forcimin e kapaciteteve profesionale në luftimin e krimit kibernetik .....	36
Pjesëmarrja në trajnimet e specializuara .....	36
Trajnimet për mbrojtjen nga dhuna në familje.....	37
4.2.5 Bashkpunimi dhe mbështetja e donatorëve në ofrimin e Trajnimeve të Vazhdueshme .....	43
4.3 Mësimi në distancë nëpërmes platformës E-learning .....	44
4.4 Trajnimet për Trajnues .....	46
4.5 Trajnimet për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial si dhe për profesionet e lira .....	47
4.5.1 Trajnimi për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial .....	48
4.6 Trajnimi për profesionet e lira .....	49
4.6.1 Trajnimi për Avokatët shtetëror .....	49
4.6.2 Trajnimi për zyrtarët e Agjencionit për ndihmë juridike falas .....	49
4.6.3 Trajnimi për përmbauesit privat .....	50
4.7 Programi për Hulumtime dhe Publikime (PHP) .....	50
4.7.1 Aktivitetet në PHP .....	50
VII. Bashkpunimi me donatorë dhe projekte ndërkombëtare - punëtori, tryeza pune dhe aktivitete tjera.....	53
5.3 Aktivitetet e realizuara me Këshillin e Evropës, zyra në Prishtinë .....	55
5.4 Aktivitetet e realizuara me zyrën e Bashkimit Evropian dhe projektet e saj .....	56
5.6 Aktivitetet e realizuara me projektin “Forcimi i Sistemit të Drejtësisë në Kosovë” të financuar nga Ambasada Britaneze .....	58
5.7 Aktivitetet e realizuara me Shkollën e Magjistraturës së Francës ENM të mbështetur nga Ambasada Franceze .....	58
5.8 Aktivitetet e realizuara me Akademinë e Drejtësisë së Republikës së Turqisë dhe KE .....	58
5.9 Aktivitetet e realizuara me UNDP .....	58
5.10. Aktivitetet e realizuara me TAIEX dhe EUROJUST .....	59
5.11 Aktivitetet e realizuara me Rrjetinë e Institucioneve të Trajnimit Gjyqësor të Evropës Juglindore.....	59
5.13 Programi për praktikantë.....	59
VIII. Administrata dhe Financat.....	60
6.1 Burimet Njerëzore në Akademinë e Drejtësisë .....	61
6.2 Nevojat për staf shtesë dhe ngritja e kapaciteteve profesionale të stafit të Akademisë së Drejtësisë	61
6.3 Asetet e Akademisë së Drejtësisë .....	63

6.3.1 Planifikimi për asete të reja dhe ndërtesën e Akademisë .....	63
6.4 Shërbimet e përgjithshme.....	64
6.5 Financat, buxheti dhe shpenzimet në Akademinë e Drejtësisë .....	65
5.6 Mbështetja financiare nga donatorët .....	70
6.7 Auditimi nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm .....	71
IX. Sfidat dhe rekomandimet .....	71
X. Anekset.....	72
Aneksi 1 – Trajnimet e realizuara në PTV.....	73
Aneksi 2 – Aktivitetet e realizuara në PTF .....	77
Aneksi 3 – Aktivitetet e realizuara në PHP.....	79
Aneksi 4 – Aktivitetet e realizuara për stafin administrativ të gjykatave dhe prokurorive .....	80
Aneksi 5 – Trajnimet e realizuara për trajnues .....	81
Aneksi 6 - Trajnimet e realizuara për profesionet e lira (Zyrtarët nga Agjencioni për Ndihmë Juridike Falas si dhe Përmbaruesit Privat).....	82
Aneksi 7 – Kurset trajnuese përmes platformës së mësimit në distancë.....	83

## Akronimet

ABEK - Asociacioni i Bibliotekave Elektronike të Kosovës  
AD – Akademia e Drejtësisë  
AQP – Agjencia Qendrore e Prokurimit  
ANJF - Agjencioni për Ndihmë Juridike Falas  
DAF – Departamenti i Administratës dhe Financave  
DHPGJS-Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme  
EIFL - Electronic Information for Libraries  
ENM – L'École Nationale de la Magistrature  
GIZ - Deutsche Gesellschaft fuer Internationale Zusammenarbeit  
GJEDNJ – Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut  
IGJK – Instituti Gjyqësor i Kosovës  
ILIAS – Integriertes Lern – Informations - und Arbeitskooperations-System  
KDM – Kodi i Drejtësisë për të Mitur  
KEDNJ – Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut  
KGJK – Këshilli Gjyqësor i Kosovës  
KPK – Këshilli Prokurorial i Kosovës  
KPMSHCK – Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës  
KPPK – Kodi i Procedurës Penale i Kosovës  
LMD – Ligji mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve  
OSBE – Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë  
OPP - Oda e Përmbauesve Privat  
PHP – Programi për Hulumtime dhe Publikime  
PTF – Programi i Trajnimit Fillestar  
PTV – Programi i Trajnimit të Vazhdueshëm  
SIMFK – Sistemi Informativ për Menaxhimin e Financave të Kosovës  
TAIEX – Technical Assistance and Information Exchange Instrument  
TI – Teknologjia Informative  
USAID - The United States Agency for International Development  
ZKA – Zyra e Kombëtare e Auditimit

## II. FJALA HYRËSE

Në emër të Akademisë së Drejtësisë së Kosovës, kam kënaqësinë që përmes këtij raporti të prezantojë aktivitetet dhe zhvillimet tjera të rëndësishme të cilat u realizuan gjatë vitit 2020.

Bazuar në Ligjin për Akademinë e Drejtësisë dhe akteve tjera nënligjore, Planit Strategjik 2019-2021, Planit të Punës dhe Programit trajnues për vitin 2020, të gjitha aktivitetet e Akademisë kanë qenë të orientuara në drejtim të zhvillimit dhe ngritjes së mëturjes së kapaciteteve të gjyqtarëve, prokurorëve, stafit administrativ të gjykatave dhe prokurorëve e gjithashtu edhe për profesionistët tjerë ligjorë përmes zbatimit të trajnimeve si dhe ofrimit të burimeve dhe materialeve tjera ligjore. Karakteristikë e veçantë e këtij viti ishin rrethanat e reja të krijuara nga pandemia COVID-19, ku si rezultat i kësaj situatë, Akademia e Drejtësisë të gjitha aktivitetet i ka ridizajnuar në pajtim me masat për parandalim dhe respektim të distancës duke i realizuar ato përmes platformave të mësimin në distancë siç janë Zoom si dhe E-learning.

Në Programin e Trajnimeve të Vazhdueshme (PTV) janë realizuar trajnime nga të gjitha fushat e së drejtës në të cilat janë përfshirë gjyqtarët dhe prokurorët nga të gjitha departamentet dhe divizionet, e gjithashtu edhe stafi esencial administrativ me theks të veçantë, bashkëpunëtorët profesional, administratorët, ndihmës administratorët referentët dhe kategori tjera të rëndësishme për procesin e punës në gjykata dhe prokurori. Programi gjithashtu ka ofruar edhe trajnimet e specializuara në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, pastrimit të parave, hetimeve financiare, krimeve kibernetike, si dhe mashtrimin në prokurimin publik. Gjithashtu, Akademia e Drejtësisë aktivitetet e konsiderueshme të trajnimeve ka ndërmarrë edhe në parandalimin dhunës në familje dhe dhunës ndaj gruas, trajnime ndërlidhur me Konvetën evropiane të Drejtave të njeriut dhe jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Ndërsa, në Programin e Trajnimit Fillestar (PTF) janë realizuar trajnime teorike dhe praktike sipas kurrikulës së këtij programi, për prokurorët e sapo emëruar të gjeneratës së VIII viti 2019-2020, si dhe për gjeneratën e VII të gjyqtarëve të sapo emëruar gjatë vitit 2019-2020.

Në kuadër të Programit për Hulumtime dhe Publikime (PHP) janë realizuar aktivitetet në fushën e hulumtimeve që kryesisht ishin në dobi të vlerësimit të nevojave trajnuese dhe përmirësimit të programeve trajnuese si dhe aktivitetet në fushën e botimeve. Biblioteka e Akademisë ka vazhduar të jetë në shërbim të gjyqtarëve, prokurorëve dhe profesionistëve tjerë dhe varësisht prej kërkesave të përfituesve të saj janë ofruar burimet juridike dhe materialet e ndryshme ligjore qoftë nga katalogu i bibliotekës fizike ashtu edhe nga biblioteka elektronike.

Raporti gjithashtu ofron edhe aktivitetet e realizuara me partnerët ndërkombëtar, të cilat kanë qenë të orientuara kryesisht në drejtësinë komerciale, në risitë ligjore të Kodit civil, në fushën e të drejtave të njeriut si dhe në luftimin e formave të ndryshme të kriminalitetit. Raporti përfshinë edhe aktivitetet e shumta në kuadrin e Departamentit për Administratë dhe Financa, të cilat janë realizuar në mbështetje të realizimit të mandatit ligjor të Akademisë.

Në përfundim, dëshiroj të theksoj se, përkundër situatës dhe rretahaneve nga pandemia COVID-19, Akademia ka arritur të përmbushë mandatin ligjor duke treguar përkushtim të lartë nga stafi i Akademisë. Prandaj, në emër të Këshillit Drejtues të AD-së, falënderoj të gjithë përfituesit, institucionet e sistemit gjyqësor dhe prokurorial, institucionet tjera vendore, organizatat ndërkombëtare, partnerë, donatorë dhe miq të AD-së, pa mbështetjen e të cilëve rezultatet e arritura gjatë këtij viti nuk do të ishin në nivelin siç janë prezantuar në këtë raport.

Sinqerisht,

Enver Peci

Kryetar i Këshillit Drejtues

### III. Përmbledhje ekzekutive

Ngritja e kapaciteteve profesionale dhe interdisiplinare e gjyqtarëve dhe prokurorëve duke përfshirë edhe profesionistët tjerë ligjor është mandat i përcaktuar me Ligjin nr. 05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë. Përmes këtij ligji ky institucion është autoritet i vetëm dhe kompetent për trajnimin gjyqësor e gjithashtu edhe hartimi dhe zbatimi i programit trajnues bazuar në nevojat trajnuese të përfituesve të saj. Objektivat e përcaktuara në Planin e Punës dhe Programin Trajnues, Akademia e Drejtësisë ka arritur t'i përmbushë me sukses. Gjatë vitit 2020, Akademia e Drejtësisë me tërë potencialin e saj është angazhuar në zhvillimin e kapaciteteve të gjyqtarëve dhe prokurorëve duke përfshirë edhe stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial si dhe profesionistët tjerë ligjor. Deri në muajin mars, gjitha aktivitetet janë realizuar sipas kalendarit dhe planit të punës, ndërkaq nga muaji prill, për shkak të pandemisë COVID-19 aktivitetet e planifikuara janë realizuar përmes platformave të ndryshme elektronike duke ju përshtatur rrethanave të krijuara për parandalimin e pandemisë dhe në përputhje me rekomandimet e institucioneve përkatëse.

Në përputhje me objektivat e Planit Strategjik 2019-2021, Akademia e Drejtësisë gjatë vitit 2020 me sukses ka arritur që të zhvillojë dhe aprovoj Programin Trajnues Kornizë 2021-2022 qëllimi i të cilit është adresimi real i kërkesave për trajnime, menaxhimi dhe koordinimi më i mirë i projekteve me donator si dhe planifikimi dhe shpenzimi adekuat i buxhetit. Me prioritet të veçantë ishte edhe veprimtaria botuese dhe ofrimi i burimeve ligjore për përfituesit e AD-së nga resurset me të cilat ka disponuar biblioteka ligjore. Gjithashtu edhe qasja në platformat elektronike me burime ligjore ndërkombëtare përmes ABEK.

Si çdo vit, edhe gjatë vitit 2020 Akademia ka marrë pjesë në konferenca e takime regjionale e ndërkombëtare, që kishin në fokus zhvillimin e kapaciteteve të gjyqësorit dhe prokurorisë përmes trajnimit gjyqësor. Poashtu, Akademia ka mundësuar pjesëmarrjen e gjyqtarëve dhe prokurorëve në aktivitete të cilat për qëllim kishin zhvillimin profesional të tyre. Në raport janë të përfshira edhe aktivitetet me donatorë dhe partnerë tjerë të cilët në mënyrë aktive i kanë kontribuar implementimit të programit për vitin 2020. Gjithashtu në raport janë përfshirë edhe aktivitetet nga veprimtaria administrative dhe financiare, të cilat me gjithë potencialin e tyre kanë qenë të fokusuar në menaxhimin dhe ekzekutimin adekuat të buxhetit të Akademisë së Drejtësisë.

Përkundër vështirësive të paraqitura gjatë vitit 2020, Akademia e Drejtësisës me sukses ka arritur që të tejkalojë të gjitha sfidat dhe të përmbushë mandatin e saj ligjor duke përditësuar metodologjinë e të mësuarit dhe duke përdorur me efikasitet teknologjinë e avancuar informative në realizimin e trajnimeve.

#### IV. Mandati i Akademisë së Drejtësisë

Akademia e Drejtësisë është institucion publik, i pavarur i cili është në funksion të zhvillimit të kapaciteteve profesionale dhe interdiciplinare të gjyqtarëve, prokurorëve, stafit administrativ gjyqësor dhe prokurorial si dhe sipas kërkesave dhe mundësive edhe për profesionistët e tjerë ligjor. Pra, veprimtaria e saj është e orientuar në përmirësimin dhe ngritjen e kapaciteteve të profesionistëve ligjor në sistemin e drejtësisë përkatësisht sistemin gjyqësor dhe prokurorial me qëllim që funksionin e tyre t'a ushtrojnë në mënyrë profesionale, efikase, të pavarur, dhe që e gëzojnë besimin e publikut. Akademia e Drejtësisë këtë funksion e realizon përmes hartimit dhe zbatimit të programeve trajnuese dhe ofrimit të burimeve ligjore në përputhje me nevojat reale për trajnime, të cilat identifikohen nga procesi i vlerësimit të nevojave, në të cilin përfshihen të gjithë përfituesit, institucionet relevante si dhe mekanizma tjerë të nevojshëm. Akademia e Drejtësisë kryen edhe analiza, hulumtime si dhe kryen veprimtari botuese për nevojat e sistemit gjyqësor dhe prokurorial si dhe profesioneve tjera të lira.

- **Misioni**

Pra, misioni i Akademisë së Drejtësisë është të ofrojë trajnim cilësor gjyqësor për gjyqtarë, prokurorë dhe staf administrativ gjyqësor dhe prokurorial, si dhe për profesionistë të tjerë në gjyqësor, analiza, hulumtime dhe veprimtari botuese, në përputhje me kornizën ligjore dhe standardet më të mira të njohura ndërkombëtarisht.

- **Vizioni**

Andaj, vizionin i Akademisë së Drejtësisë është që të shërbejë si institucion modern i të mësuarit, i përshtatur ndaj dinamikës së përgjithshme të zhvillimit, kontribues kryesor për një gjyqësor të paanshëm, të pavarur dhe profesional që gëzon besimin e publikut.

##### 2.1 Korniza ligjore dhe fuqizimi i Akademisë së Drejtësisë

Akademia e Drejtësisë veprimtarinë e saj e ushtron duke u bazuar në Ligjin Nr. 05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë si dhe aktet nënligjore të përcaktuara me këtë ligj, dhe atë si në vijim:



- Rregullore Nr. 01/2017, për Procedurën e Emërimit dhe Shkarkimit të Drejtorit Ekzekutiv të Akademisë së Drejtësisë;
- Rregullore Nr. 02/2017, për Punën e Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë;
- Rregullore Nr. 03/2017, për Trajnimin Fillestar;
- Rregullore Nr. 04/2017, për Punën e Këshillit Programor të Akademisë së Drejtësisë;
- Rregullore Nr. 05/2017, për Tarifat e Trajnimeve për Avokat Shtetëror, Avokatë dhe Profesionet e Tjera të Lira;
- Rregullore Nr. 06/2017, për Trajnuesit dhe Mentorët e Akademisë së Drejtësisë;
- Rregullore Nr. 07/2017, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 03/2017 për Trajnimin Fillestar;
- Rregullorja Nr. 08/2017, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 06/2017 për Trajnuesit dhe Mentorët e Akademisë së Drejtësisë;
- Rregullorja Nr.01/2018, për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Akademinë e Drejtësisë.

Procesi i adoptimit të legjislacionit sekondar me Ligjin për Akademinë e Drejtësisë<sup>1</sup> ka përfunduar, megjithatë vazhdon të ketë pengesa në përmbushjen e plotë të mandatit dhe kompetencave të saj konform praktikave më të mira dhe standardeve ndërkombëtare. Me qenë se ligji aktual ka kufizuar nxjerrjen e akteve tjera nënligjore të domsdoshme, e që mungesa e akteve të tilla nënligjore vazhdon të ndikojë drejtëpërdrejtë në zbatimin e plotë të funksioneve dhe në arritjen e plotë të priturve të institucionit. Akademia e Drejtësisë së fundmi ka inicuar procesin e rishikimit të Ligjit për Akademinë e Drejtësisë, me synim fuqizimin dhe kompletimin e infrastrukturës së domsdoshme ligjore që do të mundësonte ngritjen e cilësisë së trajnimeve, qartësimin e kompetencave dhe autorizimeve ligjore në ofrimin e shërbimeve për përfituesit në përputhje me misionin dhe vizionin e saj.

Andaj në këtë kontekst, Akademia e Drejtësisë gjatë periudhës raportuese ka qenë pjesë e nëngrupeve punuese në procesin e rishikimit funksional të sundimit të ligjit si të udhëhequr nga Minsitria e Drejtësisë. Lidhur me këtë, Akademia e Drejtësisë ka bashkëpunuar me grupin punues duke ofruar komentet e saj, të cilat synojnë qëndrueshmërinë institucionale, pavarësinë edhe funksionalitetin më të mirë të këtij institucioni. Çdo riorganizim ndryshe i cili do të cenonte këto vlera nuk fuqizon përpjekjet për ndërtimin e një sistemi të pavarur të drejtësisë, të paanshëm dhe profesional. Përkundër procesit për rishikimin funksional, Akademia e Drejtësisë ka vazhduar aktivitetet dhe angazhimet e saj në ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe interdisciplinare të gjyqtarëve, prokurorëve dhe komunitetit tjetër ligjor në çështjet më sfiduese të sistemit gjyqësor dhe prokurorial duke ofruar praktikatat më të mira dhe standardet evropiane.

<sup>1</sup> Në vitin 2017 hynë në fuqi Ligji 05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë sipas të cilit Akademia e Drejtësisë është institucion publik i pavarur me cilësinë e personit juridik.

## 2.2 Funkcionet dhe kompetencat e Akademisë së Drejtësisë


Bazuar në kompetencat që përcakton Ligji, Akademia e Drejtësisë kryen funksionet e parapara si në vijim:

- a. harton programet e trajnimit dhe organizon trajnimet për gjyqtarë dhe prokurorë të shtetit në pajtim me legjislacionin në fuqi;
- b. zhvillon procesin e vlerësimit të nevojave për trajnime përmes mekanizmave të përcaktuara nga Akademia, dhe në bazë të kërkesave të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (më tej: KGJK), Këshillit Prokurorial të Kosovës (më tej: KPK).
- c. organizon trajnime për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial, pas koordinimit paraprak të nevojave për trajnime me KGJK-në dhe KPK-në, në pajtim me legjislacionin në fuqi;
- d. mund të organizojë trajnime të vazhdueshme profesionale për avokat shtetëror, avokat, noter, përmbartues privat, ndërmjetësues, administratorët falimentues, si dhe profesione tjera në bazë të vlerësimeve të Akademisë, sipas kërkesave të institucioneve kompetente;
- e. zhvillon dhe realizon programet e trajnimeve në bashkëpunim me KGJK-në dhe KPK-në, Odat e profesioneve të lira apo institucionet përkatëse;
- f. mbanë të dhëna për trajnime dhe programe që realizohen në Akademi në pajtim me legjislacionin në fuqi;
- g. vendosë dhe mbanë bashkëpunim me institucionet vendore dhe institucionet e huaja të ngjashme lidhur me punët të cilat i kryen, duke përfshirë praktikat profesionale dhe programet e shkëmbimit;
- h. kryen analiza, hulumtime dhe bashkëpunon me institucionet shkencore;
- i. kryen veprimtari botuese në përmbushje të mandatit për nevojat e sistemit gjyqësor dhe prokurorial dhe profesioneve të lira;
- j. kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me ligj dhe me akte tjera të Akademisë.

## 2.3 Organet e Akademisë së Drejtësisë

Bazura në Ligjin Nr. 05/L-095 „Akademia e Drejtësisë kompetencën dhe funksionin e saj e kryen nëpërmes organeve kryesore të saj, të cilat janë paraqitur si më poshtë në grafikonin 1 :

- Këshilli Drejtues
- Këshilli Programor dhe
- Drejtori Ekzekutiv



Grafikoni nr. 1

### 2.3.1 Këshilli Drejtues -Përbërja, kompetencat dhe aktivitetet e ndërmarra

Këshilli Drejtues i Akademisë përbëhet nga nëntë (9) anëtarë, nga të cilët dy (2) janë anëtarë ex officio, ndërsa shtatë (7) anëtarë nga institucionet e mëposhtme:

Anëtarë ex officio janë Kryetari i Gjykatës Supreme dhe Kryeprokurori i Shtetit. Anëtarët tjerë janë:

- a. 3 (tre) anëtar të emëruar nga KGJK dhe atë, një (1) gjyqtar nga Gjykata Themelore, një (1) nga Gjykata e Apelit dhe një (1) nga Sekretariati i KGJK-së;
- b. 3 (tre) anëtar të emëruar nga KPK dhe atë, një (1) prokuror nga Prokuroria Themelore, një (1) nga Prokuroria e Apelit dhe një (1) nga Sekretariati i KPK-së;
- c. 1 (një) anëtarë i emëruar nga Ministria e Drejtësisë;

Anëtarët e Këshillit Drejtues emërohen në kohëzgjatje prej katër (4) vite, pa mundësi rizgjedhje edhe për një mandat.

Sipas ligjit, Këshilli Drejtues i Akademisë ka kompetencë për:

- a. Miratimin e akteve nënligjore të përcaktuara me këtë ligj;
- b. Miratimin e projektbuxhetit të Akademisë;
- c. Miratimin e strategjisë zhvillimore, planit të punës së Akademisë dhe programit të trajnimeve;
- d. Miratimin e listës së trajnerëve dhe mentorëve;
- e. Mbikëqyrjen e punës së Akademisë;
- f. Përcaktimin e prioriteteve në ofrimin e trajnimeve në bashkëpunim me KGJK-në dhe KPK-në;
- g. Zgjedhjen dhe shkarkimin e Drejtorit Ekzekutiv;
- h. Emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të Këshillit Programor;
- i. Kryerjen e punëve tjera të përcaktuara me ligj dhe akte nënligjore;

### Aktivitetet e Këshillit Drejtues

Gjatë vitit 2020, Këshilli Drejtues ka mbajtur katër (4) takime të rregullta, dy prej takimeve janë realizuar në formën virtuale përmes platformës ZOOM. Në këto takime ka debatuar dhe vendosur për çështje të ndryshme që ndërlidhen me punën dhe aktivitetet e AD-së.

Në mbledhjet e rregullta gjatë vitit 2020, Këshilli Drejtues ka marrë vendime dhe ka miratuar aktet si më poshtë:

1. Miratimi i Kërkesës Buxhetore 2021-2023;
2. Miratimi i Programit të Trajnimit Fillestar për gjyqtarët e sapo emëruar 2020-2021;
3. Autorizimi për Drejtorin Ekzekutiv të AD-së, për përdorim të platformës Zoom në vazhdimin e trajnimeve virtuale në PTF dhe PTV;
4. Miratimi i propozimit për Rishikimin e vendimit për themelimin e Këshillit të Redaksisë të AD-së;
5. Aprovimi i kërkesës për dorëheqje të anëtarit të KD Driton Muharremi, dhe njëkohësisht kërkesa për emërimin e anëtarit të ri nga radhët e KGJK-së;
6. Miratimi i propozimit të Drejtorit Ekzekutiv të AD-së për formimin e një grupi punues për rishikimin dhe harmonizimin e akteve nënligjore të AD-së me ndryshimet e fundit legislative dhe autorizimi për Drejtorin Ekzekutiv që të themelojë grupin punues me anëtarët e KÇN, KPK, KGJK,MD dhe partnerët ndërkombëtar;
7. Miratimi i propozimit për shfuqizimin e vendimit për emërimin dhe përgjegjësitë e Këshillit të Redaksisë së revistave të AD-së,
8. Miratimi i propozimit që të themelohet Komisioni për veprimtari botuese me kriteret dhe standardet bazë për botim, si dhe të autorizohet Drejtori Ekzekutiv i Akademisë së Drejtësisë që në bashkëpunim me Komisionin për Çështje Normative të përcaktojnë kriteret për Komisionin për veprimtari botuese si dhe standardet bazë për botim;

9. Autorizohet Drejtori Ekzekutiv i Akademisë së Drejtësisë që në bashkëpunim me Institucionin e Avokatit të Popullit, të paraqesë pranë Kuvendit të Republikës së Kosovës Kërkesën për plotësimin e Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik, që ka të bëjë edhe me gjetjet e Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese;
10. Miratimi i kërkesës së z. Aleksandër Lumezi për dorëheqje nga detyra e Kryesuesit të Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë;
11. Zgjedhja e z. Enver Peci Kryesues të ri të Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë;
12. Zgjedhja e znj. Javorica Prlinćević zv. Kryesuese të Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë;
13. Miratimi i Programin Trajnues Kornizë 2021-2022, me aprovimin e rekomandimeve nga Këshilli Programor
14. Miratimi i propozimit për ndryshim/plotësimin e vendimit të Këshillit Drejtues për anëtarët e Komisionit për Çështje Normative të Akademisë së Drejtësisë, duke e shtuar në pesë (5) numrin e anëtarëve të KÇN dhe të emërohet anëtar i Komisionit për Çështje Normative të AD-së, z. Labinot Gashi, Udhëheqës i Divizionit për Jurisprudencë, Ndërmjetësim dhe Administratorë të Falimentimit në Ministrinë e Drejtësisë;
15. Miratimi i propozimit për shpallje publike për zgjedhjen e trajnuesve të përkohshëm të AD-së;
16. Miratimi për mundësinë e lejit të Bashkëpunëtorëve Profesional dhe stafit tjetër profesional, për aplikim të drejtpërdrejtë për pjesëmarrje në trajnimet e vazhdueshme për gjyqtarë dhe prokuror si dhe
17. Diskutim në lidhje me statusin e të punësuarve në AD përshtatshëmrisht me statusin e të punësuarve në Sistemin Gjyqësorë dhe Prokurorial të Kosovës.

### 2.3.2 Këshilli Programor - Përbërja, kompetencat dhe aktivitetet e ndërmarra

Këshilli Programor është organ ndihmës profesional i cili angazhohet për hartimin e Programit të Trajnimeve dhe për të siguruar cilësi për trajnimet e ofruara nga Akademia e Drejtësisë. Funkcionet kryesore të Këshillit Programor janë:

- Hartimi i propozim programit të trajnimeve të Akademisë në bashkëpunim me KGJK-në dhe KPK-në;
- Përcjellja e realizimit të programeve dhe sukseseve të tyre;
- Të jap orientime për avancimin e metodave dhe teknikave trajnuese, pavarësisht dhe në bashkëpunim me trajnuesit dhe mentorët;
- Të jap mendim për listën e trajnuesve dhe mentorëve;
- Të jap këshilla propozime dhe sygjerime, organeve të Akademisë për përmirësimin e kualitetit të trajnimeve;
- Kryejnë edhe punë tjera të përcaktuara me këtë ligj dhe akte nënligjore të Akademisë.

Këshilli Programor përbëhet prej shtatë (7) anëtarëve, të cilët i emëron Këshilli Drejtues, nga radhët e gjyqtarëve, prokurorëve të shtetit dhe ekspertëve tjerë. Mandati i anëtarëve të Këshillit Programor, me përjashtim të Drejtorit Ekzekutiv, është katër (4) vite me të drejtë rizgjedhjeje edhe për një mandat. Kryesuesi i Këshillit Programor është ex officio Drejtori Ekzekutiv i Akademisë.

### **Aktivitetet e Këshillit Programor**

Gjatë vitit 2020 Këshilli Programor ka mbajtur dy (2) takime. Në takimin e parë si pikë kryesore ishte diskutimi dhe shqyrtimi i draft Programit të Trajnimit Fillestar për gjyqtarët e rinj 2020/2021, të cilët janë në proces të rekrutimit nga ana e Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Në takimin e dytë ishte diskutimi dhe shqyrtimi i draft Programit Trajnues Kornizë 2021/2022. Gjatë takimeve, anëtarët e Këshillit Programor kanë shqyrtuar përmbajtjen, strukturën, temat e përfshira në këto programe, metodologjinë e realizimit të trajnimeve, kohëzgjatjen e sesioneve të trajnimit, si dhe për çështje tjera të rëndësishme në funksion të zbatimit më të mirë të tyre. Këshilli Programor më pastaj kanë dhënë edhe rekomandimet e tyre, për përfshirjen e disa temave shtesë, njëkohësisht largimin e atyre që janë konsideruar si më pak të nevojshme, rekomandime këto të cilat i kanë trajtuar më pas dhe ka vendosur Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë.

#### **2.3.4 Organizimi i brendshëm dhe udhëheqja e Akademisë së Drejtësisë**

Akademia e Drejtësië aktualisht ka të punësuar 27 zyrtarë, duke përfshirë Drejtorin Ekzekutiv, edhe përkundër që me buxhetin e vitit 2020 numri i i përgjithshëm i aprovuar i stafit ka qenë 32 pozita. Marrë parasyshë ndryshimet legjislative të ndodhura gjatë vitit 2020 respektivisht me ligjin për zyrtarët publik, gjatë kësaj periudhe raportuese nuk është zhvilluar asnjë procedurë e rekrutimit për pozitat e lira. Organizimi i brendshëm është i rregulluar me Rregulloren Nr.01/2018, për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Akademinë e Drejtësisë, ku sipas kësaj rregulloreje, Akademia e Drejtësisë është e ndarë në katër departamente dhe zyrën e programeve trajnuese.

Bazuar në aktin për organizimin e brendshëm<sup>2</sup>, Akademia e Drejtësisë funksionon dhe është e organizuar me këtë strukturë:

- Zyra e Drejtorit Ekzekutiv;
- Zyra e Programeve Trajnuese;

<sup>2</sup> Rregullorja nr. 01/2018 për Organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Akademi të Drejtësisë.

- Departamenti për Trajnim Fillestar, Departamenti për Trajnim të Vazhdueshëm, Departamenti për Hulumtime dhe Publikime si dhe Departamenti për Administratë dhe Financa

- **Drejtori Ekzekutiv – Mandati dhe aktivitetet e ndërmarra**

Drejtori i Akademisë bën pjesë në kategorinë e Zyrtarëve të Lartë Drejtues dhe sipas Ligjit për Akademinë e Drejtësisë gjatë vitit 2020 ka kryer funksionet si në vijim:

- a. Përfaqësimin e Akademisë para institucioneve vendore dhe ndërkombëtare;
- b. Menaxhimin, administrimin e përgjithshëm dhe ligjshmërinë e punës së Akademisë;
- c. Zbatimin e vendimeve të Këshillit Drejtues;
- d. Propozimin e projektbuxhetit vjetor të Akademisë;
- e. Propozimin e Programit të Punës së Akademisë;
- f. Propozimin e Planit të Punës dhe Programin e Trajnimeve;
- g. Propozimin e listës së trajnuesve për miratim nga Këshilli Drejtues;
- h. Menaxhimin me mjetet financiare dhe pronën e Akademisë;
- i. Përgatitjen e raporteve të rregullta vjetore dhe raporteve tjera sipas kërkesave të Këshillit Drejtues.

Në periudhën raportuese, me qëllim të funksionimit më të mirë të Akademisë së Drejtësisë, zyra e Drejtorit ka realizuar aktivitete të shumta koordinuese qoftë me kërkerët e institucioneve të sistemit të drejtësisë ashtu edhe me përfaqësues të donatoreve të ndryshëm. Në këtë drejtim janë mbajtur takime të vazhdueshme me KGJK dhe KPK, kryetarë të gjykatave, kryeprokurorë të prokurorive si dhe me trajnues të cilët kanë qenë pjesë e zbatimit të programeve trajnuese në pajtim me kërkesat dhe nevojat për trajnim.

Andaj, me qëllim të avancimit të bashkëpunimit dhe koordinimit më të mirë të asistencës dhe mbështetjes së donatorëve dhe projekteve që ndihmojnë Akademinë e Drejtësisë në arritjet dhe përmbushjen e mandatit të saj, përkundër gjendjes pandemike dhe masave të ndërmarra, gjatë periudhës raportuese një numër i konsiderueshëm i takimeve janë zhvilluar që kanë rezultuar në avancimin e moduleve trajnuese dhe ofrimin e trajnimeve për gjyqtarë, prokurorë dhe profesionistët e tjerë ligjorë. Takime të vazhdueshme janë zhvilluar me përfaqësues të shumicës së Ambasadave në Kosovë, Zyrës së BE-së në Kosovë, Zyrës së Këshillit të Evropës në Kosovë, si dhe projekteve të shumta që vazhdojnë të mbështesin Akademinë e Drejtësisë në ofrimin e trajnimeve. Ndër takimet më të rëndësishme dhe të rregullta përgjatë gjithë vitit 2020, e që është me rëndësi të theksohet janë: takimet e rregullta me zyrën e OPDAT pranë Ambasadës së SHBA-së në Kosovë, me projektet e USAID-it sikurse Projekti për Drejtësi Komerciale dhe Projekti për Forcimin e Sistemit të Drejtësisë, me Ambasadën Britanike, respektivisht me projektin “Forcimi i Sistemit të Drejtësisë në Kosovë”, me përfaqësues të projektit të BE / EUKOJUST dhe me “Projektin për Kodin Civil”, me projektet e KE “JUFREX” projektin “Parandalimin e dhunës

në familje dhe dhunës ndaj grave” me projektin “Programi Evropian për Arsimimin e Profesionistëve Ligjor për të drejtat e Njeriut (HELP)” me projektin e “KOSEJ 2” si dhe projektet e tjera të mbështetura nga OSBE, UNDP, IFC, UNODC, GIZ, IRZ, Organizatën Joqeveritare INJECT Kosova, dhe me odat e profesioneve të lira në Kosovë. Në këto takime janë diskutuar nevojat dhe sfidat e AD-së në përmbushjen e mandatit ligjor, mundësitë e mbështetjes së projekteve, aktivitetet e realizuara dhe aktivitetet në proces si dhe çështje tjera të përbashkëta.

Andaj si rezultat i bashkëpunimit ndërinstitucional, në periudhën raportuese, Akademia e Drejtësisë ka nënshkruar Memorandume të Bashkëpunimit me Akademinë e Kosovës për Siguri Publike, memorandum bashkëpunimi me projektin e USAID, Aktivitete për Drejtësi Komerçiale, Oda e Përmbartuesve të Kosovës, Shoqatën e Sigurimeve, Qendrën e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim (ATRC), Universitetin e Mitrovicës “Isa Boletini” përkatësisht– Fakulteti Juridik, si dhe me organizatën joqeveritare Incativa për drejtësisë dhe barazi (INJECT), dhe Koorporata Financiare Ndërkombëtare. Këto memorandume kanë fuqizuar edhe më tutje bashkëpunimin ndërinstitucional në sferën e trajnimeve me fokus trajtimin e kërkesave për kompensimin e dëmeve që rrjedhin nga kontratat e sigurimeve në krimet e urrejtjes, dhunë në familje si dhe shkëmbimi i informacioneve dhe materialeve profesionale dhe akademike.

- *Zyra e Programeve Trajnuese dhe Departamentet e AD-së*

Akademia funksionon bazuar në punën e Zyrës së Programeve trajnuese, në kuadër të së cilës funksionojnë Departamenti i Programit të Trajnimit të Vazhdueshëm, Departamenti i Programit të Trajnimit Fillestar dhe Departamenti i Programit për Hulumtime dhe Publikime, si dhe Departamenti për Administratë dhe Financa. Përgjegjësia e zyrës së programeve trajnuese janë:

- Hartimi, mbikëqyrja e zbatimit dhe vlerësimi i ndikimit të programeve trajnuese;
- Koordinimi i hartimit të politikave, strategjive, objektivave dhe planeve për trajnime;
- Koordinimi i punës së departamenteve në funksion të zbatimit të trajnimeve.

Secili Departament udhëhiqet nga Udhëheqësit e Programit të cilët po ashtu bëjnë pjesë në kategorinë e nivelit drejtues. Në kuadër të secilit program ka edhe nënkategori tjera të aktiviteteve të cilat janë në përshtatshmëri me funksionet themelore të secilit nga këto programe.

Departamenti i Administratës dhe Financave udhëhiqet nga Drejtori për Administratë dhe Financa, i cili po ashtu është nivel drejtues dhe përfshinë sektorë të cilët janë përgjegjës për sigurimin e shërbimeve të përgjithshme si: financiare, të prokurimit, teknologjisë informative, personelit dhe logjistikes, në funksion të realizimit të objektivave programore të Akademisë.



## V. Të arriturat dhe sfidat në zbatimin e planit të punës dhe programin trajnues gjatë vitit 2020

Në vitin 2019 Këshilli Drejtues i AD-së, ka miratuar Planin e Punës dhe Programin Trajnues për vitin 2020. Plani ka përfshirë aktivitetet që do të realizohen gjatë vitit 2020, në funksion të ngritjes së kapaciteteve profesionale dhe interdisciplinare të sistemit gjyqësor dhe prokurorial, përmes programeve të ndryshme trajnuese në të cilat janë përfshirë gjyqtarë, prokurorë, staf administrativ gjyqësor dhe prokurorial si dhe profesionistë tjerë ligjor. Komponentet kryesore të Planit të Punës janë:

- Trajnimet e Vazhdueshme ;
- Trajnimet Fillestare;
- Trajnimet për Avancim;
- Hulumtimet dhe Publikimet;
- Trajnimet për Trajnues;
- Trajnimet për Menaxhimin e Gjykatave dhe Prokurorive;
- Trajnimet për stafin administrativ të gjykatave dhe prokurorive si dhe profesionistë tjerë nga fusha e gjyqësisë;
- Mesimi ne distancë nëpërmes platformës E-Learning.

Programi trajnues për vitin 2020 ka ofruar trajnimet nga fushat kryesore të punës së gjyqtarëve, prokurorëve dhe profesionistëve të tjerë në kuadër të sistemit gjyqësor, në bazë të cilit ka rezultuar hartimi i kurrikulave dhe organizimi i trajnimeve. Pra, Programi trajnues ka pasur këtë përmbajtje:

- Drejtësinë penale;
- Programet e specializuara;
- Drejtësinë civile;
- Drejtësia për fëmijë, aspekti civil dhe penal;
- Drejtësinë ekonomike;
- Drejtësinë administrative;
- Fusha e kundërvajtjeve;
- E drejta kushtetuese;
- Trajnimet për DHPGJS;
- Trajnimet për KEDNJ dhe të Drejtën e BE-së;
- Kompetenca interdisciplinare;
- Trajnimet kundërdiskriminimit;
- Programi i Trajnimit Fillestar për gjyqtarët dhe prokurorët e sapo emëruar;
- Programi për Hulumtime dhe Publikime;
- Trajnimi i stafit administrativ të gjykatave dhe prokurorive;
- Trajnimet për zyrtarët e Agjencisë për ndihmë juridike Falas;

- Trajnimin për përmbuesit privat;
- Trajnimet e Trajnuesve;
- Trajnimet nga distanca;
- Trajnimet me donatorë.

### 3.1 Sfidat në zbatimin e programeve trajnuese gjatë vitit 2020

Ndër sfidat më të mëdha me të cilat është përballur Akademia e Drejtësisë gjatë vitit 2020 janë:

- Riorganizimi i të gjitha aktiviteteve trajnuese në pajtim me masat dhe rrethanat e krijuara nga pandemia COVID-19;
- Trajnimi i stafit dhe përfituesve të AD-së me përdorimin e platformës virtuale ZOOM për vijueshmërinë në trajnime;
- Puna me kapacitete të reduktuara për shkak të pandemisë COVID-19;
- Pjesmarrja në takime dhe konferenca regjionale virtuale dhe mungesa e përkthimit adekuat.
- Lëvizja dhe largimi i stafit të lartë profesional (brenda 9 viteve janë larguar 11 zyrtarë të lartë profesional dhe drejtues), e cila vë në rrezik përmbushjen e objektivave;
- Mos kompletimi i legjislacionit primar dhe sekondar nderlidhur me mandatin, funksionin dhe kompetencën sipas nevojave reale të AD-së.
- Zhvillimet në gjyqësor dhe ndryshimet legjislative kanë ndikim drejtpërdrejt në punën e Akademisë, dhe paraqesin sfidë të vazhdueshme në realizimin me sukses të objektivave;
- Mungesa dhe koordinimi jo i mjaftueshëm ndërinstitucional me institucionet përgjegjëse të sistemit të drejtësisë në vendin tonë;
- Ndërtimi i sistemit të monitorimit të trajnimeve dhe efektit të tyre në punë;
- Mungesa e literaturës dhe burimeve tjera për trajnime në gjuhën shqipe;
- Zbatimi i metodologjisë bashkëkohore të trajnimit veçanërisht të metodologjisë së trajnimit të bazuar në raste praktike, respektivisht në lidhje me praktiken e GJEDNJ.
- Mungesa e stafit profesional të nevojshëm dhe të domsdoshëm.
- Mungesa e hapësirave adekuate për trajnime.

Pjesa dërmuese e këtyre sfidave përmes formave të ndryshme janë adresuar dhe janë tejkaluar. Kontribut të veçantë në tejkalimin e tyre kanë përkushtimi maksimal i organeve drejtuese, stafit të Akademisë si dhe mbështetja e shumë partnerëve vendorë dhe ndërkombëtarë të cilët edhe në rrethanat e krijuara nga pandemia COVID 19 janë angazhuar maksimalisht duke përmbushur me sukses aktivitetet e përcaktuara me planin e punës. Për vitin 2021, aktivitetet e Akademisë që do të realizohen janë të përcaktuara në Programin Kornizë 2021-2022, përkatësisht Programin trajnues 2021 si dhe në Planin e Punës për vitin 2021. Këto aktivitete synojnë trajtimin e infrastrukturës ligjore në të gjitha lëmitë me fokus në çështjet më sfiduese në procesin e bërjes së

drejtësisë të cilat kanë qëllim tejkalimin e tyre dhe ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe interdisiplinare të përfituesve të saj siq janë të përcaktuar me ligj.

### 3.2 Të arriturat në zbatimin e programit trajnues 2020

Në Planin punës për vitin 2020 janë parapare dhe 58 trajnime ku të gjitha janë realizuar, ndërsa në bashkëpunim me projektet ndërkombetare janë realizuar edhe 26 trajnime tjera apo 45% më shumë se që kanë qenë të planifikuara. Pra, mund të nxjerrim përfundimin se jo vetëm që trajnimet e planifikura janë realizuar 100%, por janë shtuar dhe realizuar edhe 45% më shumë.

Gjatë periudhës raportuese, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme vetëm për nevoja të gjyqtarëve dhe prokurorëve pa përfshi përfitesit tjerë ka trajnuar në total 499 gjyqtarë dhe prokurorë në kuadër të sistemit gjyqësorë dhe prokurorial të Republikës së Kosovës. Pra, janë trajnuar 329 gjyqtarë nga totali i përgjithshëm i 413 gjyqtarëve që kanë ushtruar pozitën e gjyqtarit në sistemin gjyqësor, apo 79% e të gjithë gjyqtarëve. Ndërsa, në sistemin prokurorial nga totali i 190 prokurorëve të cilët kanë qenë në pozitë të prokurorëve, 170 janë trajnuar në programet trajnuese të AD- së, apo më shumë se 89% e të gjithë prokurorëve. Për më shumë në total janë realizuar 109 trajnime me gjithsej 173 ditë, ndërsa në kuadër të Programit për Trajnimin Fillestar janë realizuar 198 ditë trajnimi, prej tyre 73 ditë për gjyqtarë dhe 125 ditë për prokuror.

Programi për Trajnim të Vazhdueshëm					
Përfituesit	Numri i përgjithshëm i gjyqtarëve/ prokurorëve	Numri i të trajnuarve nga numri i përgjithshëm	Pjesmarrja në trajnime sipas përqindjes	Numri i trajnimeve	Numri i trajnimeve në ditë
Gjyqtar	413	329	79%	109	173
Prokuror	190	170	89%		
Programi për Trajnim Fillestar 2019 -2020					
Gjyqtar	37			70 sesione	73
Prokuror	12			68 sesione	125

Tabela Nr.1 Aktivitetet e realizuara në trajnimin e vazhdueshëm dhe fillestar

#### 3.2.1 Arritja e objektivave në kuadër të Programeve të Akademisë së Drejtësisë

Objektivat e punës për vitin 2020, në përgjithësi janë realizuar me sukses. Situata e shkaktuar nga pandemia COVID 19, ka qenë sfiduese për procesin e punës për të gjitha institucionet e vendit duke përfshirë edhe Akademinë e Drejtësisë. Përkundër planifikimit për përmbushjen e aktiviteteve sipas planit është dashur të ridizajnohen sërish, në përputhje me rrethanat e krijuara nga pandemia COVID 19. Aktivitetet në kuadër të PTV, PTF, Stafit administrativ gjyqësor dhe prokurorial si dhe profesioneve të tjera të lira janë realizuar kryesisht në formë virtuale përmes plaformave të mësimin në distancë ZOOM dhe E-learning. Përveq aspektit të trajnimeve, në kuadër

të PHP, janë kryer analiza, hulumtime si dhe veprimtari botuese për nevojat e sistemit gjyqësor dhe prokurorial si dhe profesioneve tjera të lira. Bazuar në Planin e Punës 2020 dhe Planin Strategjik të Akademisë së Drejtësisë 2019-2021 gjatë vitit 2020 janë realizuar edhe aktivitete të tjera si: procesi i identifikimit dhe vlersimit të nevojave trajnuese, hartimi i Programit Fillestar për gjyqtarët e sapoemëruar – gjenerata VIII dhe Programi Trajnues Kornizë 2021-2022.

Programi i Akademisë së Drejtësisë ka qenë i fokusuar në trajtimin e çështjeve më sfiduese dhe vështirësive që gjyqtarët dhe prokurorët duke përfshirë edhe profesionistët tjerë ligjor i hasin gjatë punës praktike. Poashtu në planet dhe programin e trajnimit të Akademisë së Drejtësisë kanë pasur impakt edhe zhvillimet e reja në gjyqësor, ndryshimet legjislativë, rekrutimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve të rinj si dhe kërkesat e dokumenteve strategjike të vendit dhe veçanërisht Raporti i BE-së për Kosovën.

### **3.2.2 Ngritja e cilësisë së trajnimeve dhe avancimi i metodologjisë trajnuese në programet e Akademisë së Drejtësisë**

Akademia e Drejtësisë në vazhdimësi është angazhuar dhe përkushtuar në ngritjen e cilësisë së programeve trajnuese, përkatësisht në ngritjen e cilësisë së trajnimeve.

Në këtë drejtim të gjitha trajnimet, tryezat dhe format tjera të organizmit është kujdesur të orientohen në praktikën gjyqësore dhe përmes rasteve studimore. Trajnimet e zhvilluara përmes rasteve praktike dhe rasteve studimore duke përfshirë edhe punën në grupe kanë qenë forma më e mirë dhe adekuate për zbërthimin dhe interpretimin e dispozitave ligjore dhe veçanërisht çështjeve që janë më sfiduese për gjyqësorin aktualisht. Gjithashtu, në funksion të ngritjes së cilësisë së trajnimeve ka marrë në konsideratë edhe mekanizmat tjerë si: vlerësimin e trajnuesve nga pjesëmarrësit, rekomandimet e tyre sa i përket metodologjisë, ofrimin e ekspertizës ndërkombëtare për fushat për të cilat sistemi ynë gjyqësor dhe prokurorial nuk e ka përvojën e duhur etj. Me rastin e hartimit dhe zbatimit të trajnimeve ka bashkëpunuar ngushtë me KGJK dhe KPK duke përfshirë edhe gjyqtarë, prokurorë si dhe trajnues me përvojë me qëllim të zbatimit të praktikave më të mira të trajnimit gjyqësor.

Nga muaji prill si rezultat i rrethanave të krijuara nga pandemia COVID 19 të gjitha trajnimet janë realizur në formë virtuale përmes platformës ZOOM. Kjo platformë e ka përkrahë metodologjinë trajnuese bazuar në raste studimore duke përfshirë edhe përkthimin. Stafit i Akademisë ka qenë i përkushtuar në ofrimin e udhëzimeve për përdorim nga ana e përfituesve të trajnimeve dhe në vazhdimësi ka siguruar asistencë për vijimin e trajnimeve për të gjithë të interesuarit.

### 3.2.3 Procesi i vlerësimit të nevojave për trajnime dhe përditësimi i programeve trajnuese

Vlerësimi i nevojave trajnuese është një proces i cili ka rëndësi të jashtëzakonshme meqë i paraprin programit trajnues dhe përcaktimit të kurrikulës trajnuese bazuar në rezultatet dhe të gjeturat nga ky proces. Si i tillë kërkon angazhim dhe përkushtim nga stafi i Akademisë gjatë gjithë vitit meqenëse fillimisht nga formularët e vlerësimit evidentohen dhe futen në bazën e të dhënave të gjitha propozimet, vërejtjet dhe më pas shqyrtohen dhe analizohen me rastin e hartimit të programit trajnues. Në vijim mblidhen edhe propozimet nga pyetëtorët e dizajnuar për gjyqtarë dhe prokurorë dhe realizohen konsultime me gjithë akterët e gjyqësorit dhe prokurorisë duke përfshirë edhe zhvillimet e reja në gjyqësor. Në këtë proces rëndësi të veçantë kanë edhe kërkesat që dalin nga strategjitë shtetërore që janë relevante për gjyqësorin.

Procesi për vlerësimin e nevojave trajnuese për vitin 2021 pra, ka filluar që nga zbatimi i Programit të Trajnimeve për vitin 2020, fillimisht me analizën dhe nxjerrjen e propozimeve nga formularët e vlerësimit pas secilit sesion trajnues. Në gjysmëvjetorin e dytë të këtij viti janë dërguar pyetëtorët në gjykata dhe prokurori rezultatet e të cilave do të merren për bazë gjithashtu.

Në procesin për vlerësimin e nevojave trajnuese rëndësi të veçantë kishin takimet me kryetar të gjykatave, gjyqtarë dhe udhëheqës të departamenteve dhe kryeprokuror të prokurorisë të cilat janë realizuar në muajin gusht, shtator dhe tetor. Në vazhdim gjatë këtij viti janë përcjellë raportimet nga mediat për gjyqësorin, janë analizuar raportet dhe rekomandimet e organizatave vendore dhe ndërkombëtare, strategjitë dhe dokumentet e miratuara nga institucionet të cilat përmbajnë rekomandime për gjyqësorin dhe sundimin e ligjit, raportet e punës të gjykatave dhe prokurorisë si dhe agjenda legislative në Kuvendin e Kosovës. Përveç mekanizmave të lartpërmendur për çështje krahasimore në këtë proces janë përfshirë edhe analiza dhe hulumtimi i programeve të institucioneve trajnuese regjionale dhe ndërkombëtare. Të gjeturat nga formularët e vlerësimit, pyetëtorët, takimet me kryetar të gjykatave, gjyqtarë, kryeprokurorë dhe mekanizmat tjerë do të prezantohen në vijim të këtij raporti.

#### Më poshtë janë të pasqyruar mekanizmat për vlerësim (burimet e informacionit) dhe të gjeturat:

- |   |  |
|---|--|
| 1. Formularët për vlerësim pas sesioneve trajnuese 2020;  | 5. Raporti për vitin 2020 i Këshillit Gjyqësor të Kosovës    |
| 2. Pyetëtori për vlerësimin e nevojave trajnuese;   | 6. Raportet nga Gjykata Supreme e Kosovës                    |
| 3. Propozimet e trajnuesve të përhershëm të Akademisë së Drejtësisë;  | 7. Raportet nga Gjykata e Apelit                             |
| 4. Takimet me Gjykatat dhe Prokuroritë (Kryetar të Gjykatave, Udhëheqës të Departamenteve dhe Divizioneve, Kryeprokuror të Prokurorisë, prokurorë si dhe trajnues të AD-së) | 8. Raportet nga Gjykatat Themelore                           |
|   | 9. Raportin e Punës së Këshillit Prokurorial të Kosovës      |
|   | 10. Raportin e Punës për vitin 2019 të Prokurorit të Shtetit |

11. Raporti i Deperatamenti Amerikan të Shtetit	formale, Pastrimin e Parave, Financimin e Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2019-2023
12. Raporti i BE-së për Kosovën	
13. Plani Strategjik për Gjyqësorin e Kosovës 2020-2022	19. Draft Programi për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut (2021-2025 si dhe Plani i Veprimit (2021-2023)
14. Plani strategjik i Sistemit Prokurorial 2019-2021	20. Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për mbrojtje nga dhuna në familje 2016-2020 dhe Plani i veprimit
15. Strategjia e krimeve të luftës e KPK-së për vitin 2019	21. Raporti vjetor i Avokatit të Popullit
16. Strategjia shtetërore në luftën kundër krimit të organizuar 2018-2022	22. Monitorimi i mediave të shkruara dhe elektronike
17. Strategjia kundër korrupsionit 2019-2023	23. Agjenda legislative e kuvendit të Kosovës
18. Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Jo-	24. Analiza dhe hulumtimi i programeve të institucioneve regjionale dhe ndërkombëtare

Konsumimi i mekanizmave të lartpërmendur në këtë raport me rastin e vlerësimit të nevojave trajnuese ka qenë jashtëzakonisht sfidues. Si fillim është dashur inkurajimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve pjesëmarrës në trajnime për t'iu përgjigje kërkesave të Akademisë në plotësimin e formularëve për vlerësim i cili i'u ofrohet pas çdo sesioni të mbajtur. Megjithatë u pa që jo të gjithë e plotësojnë dhe i kushtojnë vëmendje këtij mekanizmi. E njëjta vlenë edhe për pyetësonin për vlerësim të nevojave trajnuese, i cili për çdo vit me radhë i'u dërgohet të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve megjithatë mbetet për të dëshiruar meqenëse një përqindje e vogël e gjyqtarëve dhe prokurorëve e kanë plotësuar atë. Këto burime të informacionit janë shumë të rëndësishme për Akademinë e Drejtësisë dhe me gjithë përpjekjet e Akademisë që të ketë më shumë rezultate është vetëm ajo çfarë është prezantuar në këtë raport.

Më tej sigurimi i prezencës së kryetarëve të gjykatave dhe kryeprokurorëve të prokurorive, gjyqtarëve dhe prokurorëve, trajnuesve nga këto radhë si dhe përfaqësuesve të KGJK-së dhe KPK-së në takimet që i ka organizuar Akademia po ashtu i vështirë duke pas në konsideratë edhe angazhimet e tyre në gjykata dhe prokurori. Në vijim mbledhja dhe përpunimi i të gjitha të dhënave, hulumtimi dhe gjetja e shumë dokumenteve të cilat kanë impakt për gjyqësorin, e më pas edhe shqyrtimi i tyre, data bazave të institucioneve të sistemit të drejtësisë, po ashtu padyshim kanë kërkuar kohë dhe përkushtim. Megjithatë si rezultat i angazhimit të stafit përgjegjës në vlerësimin e nevojave trajnuese për gjyqtarë dhe prokurorë janë mbledhur dhe grumbulluar propozimet nga mekanizmat e lartpërmendur.

Në vazhden e këtij procesi janë marrë propozime nga gjitha palët dhe nga shqyrtimi i tyre është vërejtur se janë preokupimet e njëjta dhe të përbashkëta. Nga të gjeturat shihet se janë një mori çështjesh ligjore të cilat Akademia e Drejtësisë duhet pasur në konsideratë për t'i adresuar përmes trajnimeve në vitet në vijim dhe sipas prioriteteve të përcaktoj tematikën për kurrikulën trajnuese 2021.

### 3.2.3.1 Punëtorja për rishikimin/hartimin e Programit të Trajnimit Fillestar për gjeneratën e tetë të gjyqtarëve të sapo emëruar 2020/2021

Në periudhën raportuese, Akademia e Drejtësisë, ka bërë rishikimin/hartimin e programit për gjyqtarët e ardhshëm, njëherit gjeneratën e tetë të gjyqtarëve 2020/2021. Për hartimin e këtij programi janë zhvilluar disa mekanizma me qëllim të vlerësimit të nevojave të gjyqtarëve të sapo emëruar. Në kuadër të vlerësimit të nevojave trajnuese dhe rishikimit/hartimit të këtij programi janë ndërmarrë aktivitetet si në vijim:

- Konsultime me kryetarin e Gjykatës Supreme;

Konsultime me Kryesuesin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës,

- Takimi me kryetarët e gjykatave;
- Diskutime me trajnuesit e PTF;
- Pyetësorët e shpërndarë gjyqtarëve të cilët kanë ndjekur trajnimin fillestar të gjenratës së shtatë si dhe
- Punëtori me ekspert.

Në kuadër të kësaj punëtorie është zhvilluar përmbajtja e Programit të Trajnimit Fillestar si dhe është përcaktuar për metodologjinë e realizimit të trajnimeve qoftë teorike ashtu edhe trajnimin praktik në gjykata dhe institucione tjera të sistemit të drejtësisë. Pjesëmarrës të kësaj punëtorie ishin: Trajnues dhe stafi i Akademisë së Drejtësisë dhe përfaqësues nga OSBE. Ky program është miratuar nga Këshilli Drejtues me 23 qershor të viti 2020. Kjo punëtori është mbështetur nga OSBE.

### 3.2.3.2 Punëtoritë për hartimin e Programit Trajnues për vitin 2021-2022

Gjatë vitit 2020, Akademia e Drejtësisë ka realizuar dy (2) punëtori për hartimin e Programit Trajnues për vitin 2021- 2022. Qëllimi i punëtorive ishte hartimi i Programit Trajnues për vitin 2021-2022, adekuat me nevojat reale të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe në përgjithësi me sistemin gjyqësor dhe prokurorial të Kosovës, si dhe përcaktimi i prioritetëve për çështjet ligjore që duhet trajtuar në vitin 2021. Me rastin e këtyre janë prezantuar të gjeturat nga procesi i vlerësimit të nevojave trajnuese, temat e propozuara nga mekanizmat e ndryshëm si dhe angazhimet e Akademisë për ngritjen e kapaciteteve profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve në përmbushjen e kërkesave që dalin nga proceset euro integruese. Nevoja për trajtimin me prioritet të disa nga institutet e ndryshme të së drejtës të cilat në praktikën gjyqësore nuk po zbatohen drejtë, e gjithashtu edhe luftimi i kriminalitetit për forma të ndryshme të veprave penale për të cilat Kosova nuk po e merr vlerësimin e mirë për sundimin e ligjit, kanë qenë përcaktuese për kurrikulën trajnuese për vitin 2021. Më tej, gjatë këtyre punëtorive ekspertët e angazhuar për hartimin e programit të ndarë në grupe varësisht prej fushave: civile, penale, administrative, ekonomike duke përfshirë edhe të drejtat e njeriut, kompetencën ndërpersonale dhe interdisciplinare kanë zhvilluar konceptet e trajnimit duke u mbështetur në kërkesat e Akademisë së Drejtësisë për strukturën dhe elementet që duhet të përmbajnë konceptet e trajnimit. Pjesëmarrës në këtë punëtori ishin trajnuesit e përhershëm dhe trajnuesit e Akademisë së Drejtësisë nga radhët e gjyqtarëve dhe prokurorëve nga gjitha nivelet.

## VI. Përshkrim i aktiviteteve të realizuara sipas programeve të Akademisë së Drejtësisë


Gjatë viti 2020 në kuadër të programeve trajnuese, janë realizuar trajnime si nga aspekti material ashtu edhe ai procedural. Gjatë realizimit të këtyre trajnimeve, Akademia e Drejtësisë ka hasur në sfida dhe vështirësi, që ka shkakuar pandemia COVID-19. Duke u bazuar në rekomandimet e OBSH-së dhe institucioneve tjera relevante të Kosovës, të gjitha aktivitete trajnuese të planifikuara sipas programit trajnues janë pezulluar me qëllim të respektimit të masave anti – Covid. Brenda një periudhe shumë të shkurtë falë angazhimit dhe përkushtimit maksimal të stafit të Akademisë dhe zhvillimit të teknologjisë informative, është arritur të përmbushet në tërësi programi trajnues për vitin 2020.

Raporti përmban aktivitetet e realizuara gjatë vitit 2020 sipas strukturës si në vijim:

- Programi i Trajnimit Fillestar;
- Programi i Trajnimit të Vazhdueshëm;


- Programi për Hulumtime dhe Publikime;
- Mësimi në distancë;
- Trajnimet për stafin administrativ të gjykatave dhe prokurorive;
- Trajnimet për profesionet e lira
- Trajtime për Trajnues;
- Punëtori, tryeza pune, konferenca dhe aktivitete tjera;
- Bashkëpunimi me donatorë;
- Bashkëpunimi ndërkombëtarë;
- Programi për praktikant-student;
- Administrata dhe Financa.

Në grafikonet nr. 2,3,4 dhe 5 si mëposhtë janë paraqitur trajnimet dhe aktivitetet tjera të realizuara nga Akademia gjatë vitit 2020, duke përfshirë trajnimet e realizuara në të gjitha programet trajnuese, punëtoritë, programet e internshiptit si dhe aktivitetet ndërkombëtare.




Grafikoni nr.2: Numri i trajnimeve të realizuara 2020






Grafikoni nr.3: Punëtori dhe aktivitete tjera 2020



Grafikoni nr.4: Takime dhe tryeza në nivel rajonal 2020



Grafikoni nr. 5: Bashkëpunimi ndërkombëtarë 2020

#### 4.1 Programi i Trajnimit Fillestar

Programi i Trajnimit Fillestar (PTF) është program trajnues i cili organizohet për gjyqtarët dhe prokurorët e shtetit pas përfundimit të rekrutimit dhe dekretimit të tyre. Sipas legjislacionit në fuqi trajnimi fillestar zgjatë 12 (muaj) dhe është i ndarë në dy pjesë: Pjesa e parë përfshinë trajnimin teorik të kombinuar me shqyrtime të rasteve praktike dhe simulime. Pjesa e dytë përmban trajnimin praktik në gjykata dhe prokurori i shoqëruar edhe me trajnime në institucionet jo gjyqësore por që kanë lidhshmëri me punën e gjyqtarit dhe prokurorit.

Synimi kryesor i Programit të Trajnimit Fillestar (PTF), mbetet ngritja e kapaciteteve profesionale dhe shkathtësive praktike të gjyqtarëve dhe prokurorëve pas dekretimit dhe emërimit të tyre në gjykatat dhe prokuroritë gjegjëse.

Programi për Trajnim Fillestar 2019 -2020 <sup>3</sup>											
Gjyqtarë/Prokurorë të sapoemëruar	Gjinia		Përkatësia etnike			Ditë trajnimi teorik	Ditë trajnimi praktike	Sesionet trajnuese	Orë trajnimi	Trajner gjyqësorë	Mentor
	M	F	SH	SR	TJ						
37 Gjyqtarë	18	20	30	7		35	38	70	210	18	23
12 Prokurorë	9	3	12			34	91	68	204	21	12
Totali i diteve të trajnimit/numri i trajnuesve dhe mentorëve të angazhuar						73	125			35	

Tabela nr. 2. Aktivitete në kuadër të trajnimit fillestar

<sup>3</sup> Trajnimi fillestar ka filluar në vitin 2019 dhe një pjesë e programit trajnues është mbajtur në vitin 2020

#### 4.1.1 Të arriturat dhe sfidat sipas objektivave të parapara në Programin e Trajnimit Fillestar për vitin 2020

Me gjithë situatën e krijuar për shkak të pandemisë COVID-19 gjatë vitit 2020, realizimi i programit trajnues është përmblyllë me suksese, përkundër sfidave të parqitura në lidhje me metodologjinë trajnuese.

Në përputhje me masat e ndërmarra për parandalimin e pandemisë, respektivisht bazuar në vendimin e qeverisë për karantinim të tërësishëm të vendit, nga data 13 mars 2020, ishin pezulluar të gjitha aktivitetet. Andaj në përputhje me masat e ndalimit për qarkullim, gjatë kësaj periudhe, Akademia e Drejtësisë ndërmori gjitha masat për të rifilluar aktivitetet trajnuese me dt. 08 prill 2020 në formë virtuale përmes platformave elektronike, për të vazhduar me përmbushjen e këtij programi sipas moduleve të radhës. Përkundër ballafaqimit me pandeminë, aktivitetet e parapara në programin e trajnimit fillestar për gjyqtarë dhe prokurorë, janë realizuar në tërësi në total 198 aktivitete trajnuese ashtu siç kanë qenë të planifikuara dhe janë arritur të përmbushen objektivat e përcaktuara në trajnimin fillestar. Akademia e Drejtësisë me sukses ka përmbushur programin si dhe objektivat e saj të cilat janë drejtuar në ngritjen e kapaciteteve në legjislacionin vendor dhe ndërkombëtar, hartimi i vendimeve gjyqësore dhe akteve akuzuese bazuar në analizën e fakteve, aplikimi i rregullave të etikës, zhvillimi i shkathtësive gjyqësore, zhvillimi i shkathtësive sociale, shkëmbimi i praktikave me institucionet e ndërlidhura me punën e gjyqësorit, zhvillimi i kapaciteteve hulumtuese dhe menaxhuese si dhe zhvillimi i shkathtësive inerdisciplinare.

#### 4.1.2 Vazhdimi i trajnimit fillestar për gjyqtarët e sapoemëruar, gjenerata e VII (2019-2020)

Trajnimi i gjyqtarëve të sapo emëruar, gjenerata e shtatë, në kuadër të cilit kanë vijuar 39 gjyqtarë ka filluar me 11 mars 2019 dhe sipas planprogramit do të duhej të përfundojë me dt. 10 prill 2020. Për shkak të situatës së krijuar nga virusi COVID-19, në bazë të vendimit të qeverisë nga data 13 mars 2020 është pezulluar puna në gjykata (vetëm rastet urgjente) e rrjedhimisht edhe aktivitetet trajnuese në Akademi të Drejtësisë. Me ridizajnimin e aktiviteteve përshtatshmërisht me masat e caktuara për parandalim, ka rifilluar trajnimi për këtë gjeneratë me 02 qershor 2020 duke u realizuar në mënyrë intensive përmes platformës elektronike ZOOM dhe ka përfunduar me 24 qershor 2020.

Në vitin 2019, kjo gjeneratë ka ndjekur në total 185 ditë trajnimi, ndërkaq në periudhën raportuese, përkatësisht gjatë vitit 2020 në total janë realizuar 73 ditë trajnimi. Prej tyre 35 ditë të trajnimit teorik dhe 38 ditë trajnimi praktik.

Trajnimi teorik është zhvilluar në mënyrë të kombinuar me raste nga praktika gjyqësore, bazuar në module trajnuese ku përfshihen trajnime nga të gjitha degët e së drejtës dhe ligjet pozitive, Konventa Evropiane për të Drejta të Njeriut dhe akteve të tjera ndërkombëtare. Sipas programit trajnues fillestar për gjyqtarët janë realizuar shtatë (7) module trajnuese (të cilat përbëhen nga 50 nën module). Në trajnimin teorik për gjyqtarët në total janë realizuar 35 ditë trajnimi, 70 sesione trajnuese apo 210 orë trajnimi.

Modulet trajnuese të cilat kanë ndjekur gjyqtarët e sapo emëruar gjatë vitit 2020 janë:

- Kodi Penal i Republikës së Kosovës – Në kuadër të këtij moduli janë realizuar 13 sesionet trajnuese apo 39 orë dhe janë trajtuar: Kodi Penal- pjesa e përgjithshme, Kodi Penal-pjesa e veçantë dhe parashkrimi.
- Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës – Nga ky modul janë realizuar 57 sesione trajnuese apo 156 orë në të cilat janë trajtuar: Masat për sigurinë e pranisë së të pandehurit, kontrolli dhe konfiskimi, procedurat e veçanta sipas KPPK, shpenzimet e procedurës, mjetet juridike, shqyrtimi fillestar i dytë dhe shqyrtimi gjyqësor, provat në procedurën penale, dëshmitarët dhe të dëmtuarit, si dhe të pandehurit në procedurën penale.

Akademia e Drejtësisë, ka organizuar edhe një webinar lidhur me bazat e së drejtës dhe politikës së Bashkimit Evropian. Ndër çështjet që janë trajtuar gjatë këtij aktiviteti ishin strukturat bazë të Bashkimit Evropian, dhe Bashkimi Evropian si bashkësi e së drejtës si dhe tregu i brendshëm evropian – ndalimi i diskriminimit dhe liritë themelore, gjyqtari i brendshëm si gjyqtar evropian, dhe sistemi evropian i mbrojtjes juridike. Në realizimin e trajnimit kanë qenë të angazhuar 18 trajnues.

Në kuadër të trajnimit praktik, pra janë realizuar 38 ditë trajnimi praktik në gjykatat ku kanë qenë të emëruar. Në realizimin e kësaj pjese të programit kanë qenë të angazhuar 21 mentorë (gjyqtarë) në lëmin penale të cilët kanë mbikqyrë trajnimin praktik të gjyqtarëve të sapo emëruar të kësaj gjenerate.

#### 4.1.3 Vazhdimi i trajnimit fillestar i prokurorëve - gjenerata e tetë (2019-2020)

Prokurorët e sapo emëruar, gjenerata e tetë (2019-2020), kanë filluar trajnimin me 10 qershor 2019 dhe sipas planprogramit do të duhej të përfundonin trajnimin fillestar me 02 korrik të vitit 2020. Në vitin 2019 kjo gjeneratë në total ka realizuar në total 127 ditë trajnimi, ndërkaq në periudhën raportuese, përkatësisht gjatë vitit 2020 janë realizuar në total 125 ditë trajnimi. Prej tyre 34 ditë trajnimi teorik dhe 91 ditë trajnimi praktik në prokuroritë themelore ku kanë qenë të emëruar. Për shkak të situatës së krijuar nga pandemia COVID-19 dhe vendimit të qeverisë për karantinim të tërësishëm të vendit, nga data 13 mars 2020 është ndërprerë trajnimi teorik dhe praktik. Trajnimi më tej ka rifilluar përshtatshmërisht me masat për parandalim me 08 prill 2020 në formë virtuale përmes platformës ZOOM dhe ka përfunduar me 31 gusht 2020, duke përmbyshur programin trajnues në tërësi.

Në kuadër të trajnimit teorik, gjatë vitit 2020, prokurorët kanë realizuar 34 ditë trajnimi teorik, 68 sesione trajnuese apo 204 orë trajnimi. Modulet trajnuese të cilat kanë ndjekur prokurorët e sapo emëruar gjatë vitit 2020 janë:

- *Kodi Penal* - janë realizuar dy (2) sesione trajnuese apo 6 orë trajnimi, dhe janë trajtuar çështjen e parashkrimit me fokus tek mos zbatueshmëria e parashkrimit për veprat penale kundër të drejtës ndërkombëtare dhe vrasjes së rëndë, si dhe parashkrimi i ekzekutimit të dënimit
- *Kodi i Procedurës Penale* - janë realizuar 15 sesione trajnuese apo 45 orë trajnimi. Në kuadër të këtyre nën moduleve janë trajtuar: Vendi i ngjarjes dhe forenzika, negociimi i marrëveshjes për pranimin e fajësisë, procedurat e veçanta sipas KPPK, dhe shpenzimet e procedurës.
- *Shkathtësitë personale dhe ndër personale*- janë realizuar 26 sesione trajnuese apo 78 orë trajnimi. Në kuadër të këtij moduli janë trajtuar: Arsyetimi i vendimeve gjyqësore, ngritja e shkathtësive personale, menaxhimi i stresit, rregullat e komunikimit, menaxhimi i rasteve, dhe etika profesionale.
- *Rendi juridik kombëtar dhe ndërkombëtarë* - janë realizuar 17 sesione trajnuese apo 51 orë trajnimi ku është trajtuar Konventa evropiane për lirinë dhe të drejtat e njeriut, e drejta e bashkimit evropian, dhe organizimi i sistemit prokurorial.
- *Legjislacioni dhe shkathtësitë plotësuese* - janë realizuar 8 sesione trajnuese apo 24 orë trajnimi dhe janë trajtuar ndërmjetësimi, Kodi i drejtësisë për të mitur, hetimi i krimit ndërkufitar
- Mësimi në distancë - përmes platformës e-learning prokurorët e sapo emëruar kanë realizuar dy (2) module: Anglishtja ligjore dhe teknologjia informative.

Në kuadër të trajnimit praktik janë realizuar 91 ditë trajnimi në prokuroritë përkatëse ku janë të emëruar nën mbikëqyrjen e mentorëve (prokuror). Për realizimin e programit ishin të angazhuar 23 trajnues dhe 12 mentor.

#### 4.1.4 Metodologjia trajnuese

Në periudhën raportuese, vëmendje të veçantë i është kushtuar edhe metodologjisë trajnuese. Në programin e trajnimit fillestar janë përdorur këto metoda trajnuese:

- Trajnim i bazuar në kompetenën profesionale dhe interdisiplinare;
- Metodologji e bazuar në raste - që nënkupton se gjithçka është strukturuar rreth rasteve praktike;
- Simulim i gjykimeve;
- Teknikat e zhvillimit të përfaqesimit në gjykim dhe
- Trajnime të realizuara në plaformën e mësimit në distancë (e- learning)

#### 4.1.5 Testi përfundimtar

Akademia e Drejtësisë ka realizuar dy (2) punëtori për hartimin e testit përfundimtar, për gjyqtarët dhe prokurorët e sapoemëruar (gjenerata e shtatë dhe e tetë). Në kuadër të këtyre punëtorive grupet punuese nga radhët e trajnuesve të AD-së kanë hartuar pyetjet dhe rastet praktike për testin përfundimtar, duke u bazuar në strukturën e testit, të cilën e përcakton Rregullorja për Trajnimin Fillestar. Këto grupe punuese më tej kanë qenë të përfshirë në realizimin e moduleve trajnuese.

Më dt. 15,16 dhe 17 qershor 2020, është organizuar testi përfundimtar për gjyqtarët, ndërkaq, me dt. 27 dhe 28 korrik 2020 është realizuar testi përfundimtar për prokurorët. Vlerësimi i testit është bërë brenda afatit të përcaktuar me Rregullore për Trajnimin Fillestar.

## 4.2 Programi për Trajnime të Vazhdueshme

Përditësimi dhe shkëmbimi i njohurive, përvojave dhe unifikimi i praktikës, janë qëllimet parësore të Programit të Trajnimit të Vazhdueshëm (PTV), përmes së cilit kontribuohet në një sistem gjyqësor dhe prokurorial etik, profesional, bashkëkohor dhe të gatshëm të ballafaqohet me risitë dhe sfidat që sjellë profesioni. Përfitues të PTV-së janë gjyqtarët dhe prokurorët në detyrë, stafi administrativ gjyqësor dhe prokurorial, si dhe përfituesit tjerët sipas ligjit të Akademisë së Drejtësisë, puna e të cilëve ndërlidhet me punën e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Në Programin e Trajnimeve të Vazhdueshme, janë realizuar trajnime si nga aspekti material ashtu edhe ai procedural. Temat që trajtohen në kuadër të PTV janë tema të karakterit profesional-ligjor dhe tema të karakterit interdisiplinar. Struktura e PTV është e përbërë nga lëmitë e së drejtës penale, civile, drejtësia për fëmijë - aspekti civil dhe penal, e drejta ekonomike, e drejta administrative, kundërvajtjet, e drejta kushtetuese, trajnimet për gjyqtarët e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, trajnimet për Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut - KEDNJ, kompetenca interdisciplinare si dhe trajnimet për mosdiskriminim. Situata e shkaktuar nga pandemia COVID 19 ka qenë sfiduese edhe për Akademinë e Drejtësisë në realizimin dhe zbatimin e Programit Trajnues 2020. Duke u bazuar në rekomandimet e OBSH-së dhe institucioneve tjetra relevante të Kosovës, të gjitha aktivitetet trajnuese të planifikuar

sipas kalendarit trajnues janë realizuar përmes platformave të ndryshme elektronike qofshin ato drejtpërdrejtë apo dhe përmes platformës së mësimi në distancë E-learning.

Edhe gjatë vitit 2020 nuk ka munguar mbështetja e partnerëve ndërkombëtarë në programet e Akademisë së Drejtësisë. Një numër i konsiderueshëm i trajnimeve janë realizuar në bashkëpunim me partnerë ndërkombëtarë duke kombinuar kështu ekspertizën vendore me atë ndërkombëtare me ç' rast është kontribuar edhe më tej në fuqizimin e kapaciteteve profesionale të përfituesve të këtij programi.

#### 4.2.1 Objektivat e Programit për Trajnim të Vazhdueshëm për vitin 2020

Gjatë periudhës raportuese, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnim të Vazhduesh me ka realizuar 58 trajnime sipas planifikimit të Programit trajnues 2020. Në periudhën raportuese përveç aktiviteteve të planifikuara janë realizuar edhe 3 aktivitete shtesë për Etikën profesionale si rezultat i kërkesës së KPK-së si dhe 23 aktivitete të cilat kanë rezultuar me kërkesën e partnerëve të Akademisë së Drejtësisë, gjë që ka tejkaluar objektivat e planifikuara. Përmes realizimit të këtyre trajnimeve janë përmbushur objektivat e përcaktuara si në vijim:

- Ngritja e vazhdueshme e aftësive profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve;
- Zhvillimi i kompetencës ndërdisiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve;
- Unifikimi i praktikës gjyqësore;
- Zhvillimi i shkathtësive të gjyqtarëve dhe prokurorëve për pozitat drejtuese, si dhe promovimi i kulturës rreth menaxhimit të mirë të rasteve si dhe
- Zhvillimi i trajnimeve të nevojshme për stafin e gjykatave dhe prokurorive si dhe profesionistëve tjerë.

#### 4.2.2 Aktivitetet trajnuese të zhvilluara në PTV


Gjatë periudhës janar – dhjetor 2020, në kuadër të këtij programi janë realizuar 110 trajnime të cilat përfshijnë gjyqtarë, prokurorë, staf administrativ gjyqësor dhe prokurorial si dhe profesionistë të ndryshëm ligjor. Për më në detaje shih tabelën si në vijim:

Programi për Trajnim të Vazhdueshme 2020 – 109 Aktivitete trajnuese				
Përfituesit	Aktivitetet trajnuese	Ditë trajnimi	Pjesëmarrës	Mesatarja e pjesëmarrjes së gjyqtarit/prokurorit në trajnim
328 Gjyqtarë	90	138	1946	5.9
168 Prokurorë			612	3.6
Bashkëpunëtor profesional, Zyrtar Ligjor dhe Avokat Shtetëror			105	1.2
Stafi Administrativ gjyqësor dhe prokurorial <sup>4</sup>	9	15	132	/
Profesionet e lira dhe profesionistë të tjerë ligjor <sup>5</sup>	4	4	53	/
Trajnimet për Trajnuet	6	15	65	/
<b>Totali</b>	<b>109</b>	<b>173</b>	<b>2913</b>	<b>/</b>


Tabela nr. 3 Aktivitete trajnuese në kuadër të trajnimit të vazhdueshëm

<sup>4</sup> Përshkruani kategoritë në bazë të pozitave - Zyrtarët për Mbrojtje të Viktimave, Zyrtarë Ligjorë, referent, Administratorë, Zyrtarë për Informim.


Raporti në vijim përfshinë aktivitetet e realizuara sipas fushave, trajnimet e realizuara në baza mujore, numrit të pjesëmarrjes, kohëzgjatjes së trajnimeve dhe detaje të rëndësishme për aspektin e trajnimeve.



Grafikoni nr. 6: Numri i trajnimeve të realizuara në PTV sipas fushave në vitin 2020



Grafikoni nr.7 dhe nr. 8 Numri i trajnimeve të realizuara në baza mujore dhe pjesëmarrësve në PTV




Grafikoni nr.9 Trajnime sipas kohëzgjatjes në PTV

#### 4.2.3 Pjesëmarrja në Programin e Trajnimit të Vazhdueshëm

Gjatë periudhës raportuese janar-dhjetor 2020, në kuadër të PTV-së janë realizuar 109 trajnime. Numri i përgjithshëm i pjesëmarrësve në trajnime të vazhdueshme ishte 3251. Prej tyre 1968<sup>6</sup> gjyqtarë, 634<sup>7</sup> prokuror, 649 te tjersi si: bashkëpunëtorë profesional, zyrtarë ligjor, avokatë shtetëror, stafi administrativ gjyqësor dhe prokurorial, pjestarë nga profesionet e lira duke përfshirë edhe ngritjen e kapaciteteve të trajnuesve.

Nga këta pjesëmarrës, 2973 ishin shqiptarë, 248 serb, 6 boshnjak, 23 pakica të tjera dhe 1 ndërkombëtar, ndërsa në baza gjinore, 1913 pjesëmarrës ishin meshkuj dhe 1338 femra.



Grafikoni nr. 10: Numri i pjesëmarrësve në trajnimet e realizuara në PTV


Në grafikonin në vijim gjyqtarët e trajnuar gjatë vitit sipas niveleve të gjykatave dhe degëve.

<sup>6</sup> Gjyqtarë që kanë marrë pjesë në më shumë trajnime se njëherë.

<sup>7</sup> Prokurorë që kanë marrë pjesë në më shumë se njëherë në trajnime.




**Numri i gjyqtarëve të trajnuar sipas niveleve të gjykatave dhe degëve 2020**



Grafikoni nr. 11: Gjyqtarët e trajnuar në PTV 2020

Në grafikoni në vijim prokurorët e trajnuar sipas niveleve dhe prokurorive:

**Numri i prokurorëve të trajnuar sipas prokurorive 2020**



Grafikoni nr. 12: Prokurorët e trajnuar në PTV 2020

Nga departamenti special janë trajnuar gjithësejt 9 gjyqtarë, 3 nga Gjykata e Apelit dhe 6 nga Gjykata Themelore ndërkaq nga Prokuroria Speciale gjithësejt 14 prokurorë.

#### 4.2.4 Trajnimet e vazhdueshme sipas fushave

Sfidat dhe problemet që paraqiten tek drejtësia penale në Kosovë, Akademia e Drejtësisë i ka adresuar përmes trajtimit të çështjeve problematike si korrupsionin dhe krimin të organizuar, infrastrukturën ligjore në sferën e ekzekutimit të sanksioneve penale, konfiskimin e pasurisë, krimin ekonomik, pastrimin e parave, prokurimin publik, krimet e luftës, terrorizmin, ndërmjetësimin, dhe trafikimi me qenie njerëzore. Vëmendje të veçantë i ka kushtuar, edhe dispozitave të reja të Kodit Penal të rishikuar, përfshirë dhunën në familje dhe ngacmimin seksual si dhe mos referimin e rasteve të praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut. Në kuadër të fushës civile janë trajtuar problemet në zbatimin e normave të ndryshme juridike, të cilat e vështirësojnë punën e gjyqtarëve po ashtu edhe problemet pronësore, familjare, marrëdhëniet pasurore të bashkëshortëve, të drejtat trashëgimore, kontratat sipas LMD-së. Rendësi të veçantë kjo fushë i ka kushtuar Kodit Civil i cili pritet të hyjë në fuqi.

##### 4.2.4.1 Fusha penale (materiale dhe procedurale)

Gjatë vitit 2020, në kuadër të PTV nga fusha penale janë realizuar 32 aktivitete trajnuese. Në kuadër të këtyre aktiviteteve, janë përfshirë trajnime nga pjesa materiale, procedurale, e drejta ndërkombëtare penale, bashkëpunimi juridik ndërkombëtarë, si dhe programe të specializuara nëpërmjet të cilave janë trajtuar krimi kibernetik, veprat penale përmes prokurimit publik, krimi i organizuar, shpëlarja e parave dhe hetimi financiar.

- **E drejta penale materiale**

Nga e drejta materiale penale janë realizuar trajnimet si: veprat penale të narkotikëve, dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje, trafikimi i qenieve njerëzore dhe kontrabandimi më migrantë, mbrojtja e nevojshme, nevoja ekstreme dhe rrethanat e tjera që e përjashtojnë kundërligjshmërinë e veprës penale, krimet e luftës, trafikimi i fëmijëve dhe të rriturve për qëllime seksuale - sesioni 2 dhe 3, bashkëpunimi juridik ndërkombëtar.

Këto tema janë trajtuar me qëllim që të:

- Zbatohen në mënyrë të drejtë dispozitat ligjore të kapitullit të veprave penale të narkotikëve, dhunën në familje dhe trafikimin me njerëz;
- Përvetësojnë njohuritë për tu marrë me rastet e krimeve të luftës;
- Avancojnë njohuritë rreth bashkëpunimit juridik ndërkombëtar për çështjet penale;
- Zbatojnë drejt dispozitat ligjore lidhur me vepra të kryera në rrethanat që përjashtojnë kundërligjshmërinë;
- Avancojnë njohuritë profesionale lidhur me shkathtësitë e përfaqësimit në gjykim,
- Zbatojnë drejtë legjislacionin lidhur me Trafikimin përmes internetit/online;

- **E drejta penale procedurale**

Nga e drejta procedurale penale janë realizuar trajnimet si: masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit, hetimet financiare, procedura penale ku përfshihen kryerësit me çrregullime mendore, sekuestrimi dhe konfiskimi, faza e procedurës paraprake – hetimet proaktive dhe sigurimi i provave, avancimi i konfiskimit të pasurisë së paligjshme" dy (2) trajnime, zbatimi i udhëzuesit për politikën ndëshkimore, intervistimi forenzik i fëmijëve si dhe shkathtësitë e përfaqësimit në gjykim.

Qëllimi kryesor i trajnimeve nga fusha penale procedurale ishte, ngritja e shkathtësive të gjyqtarëve dhe prokurorëve lidhur me:

- Vlerësimin e drejtë të elementeve për përcaktimin e masave për sigurimin e pranisë së të pandehurit;

- Zbatimin e kushteve ligjore për hetimet financiare;
- Tejkalimin e sfidave në procedurën penale kur përfshihen kryerësit me çrregullime mendore;
- Zbatimin e drejtë në legjislacionin ekzistues në lidhje me gjurmimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e të ardhurave nga vepra penale;
- Identifikojnë kushtet dhe mundësitë ligjore për zbatimin hetimit paraprak, sigurimin e provave dhe hetimet proaktive;
- Vlerësojnë drejtë rrethanat lehtësuese dhe rënduese gjatë caktimit të dënimit si dhe të zbatojnë rrethanat e zbutjes dhe ashpërsimit të dënimit;
- Zbatimi i drejtë i dispozitave ligjore nga pjesa materiale dhe procedurale në lidhje me procedurën penale për të mitur.

#### 4.2.4.2 Programet e specializuara të trajnimit

Gjatë vitit 2020, në kuadër të Programeve të Specializuar janë realizuar këto tema:

- Program i specializuar trajnimi për zhvillimin e kapaciteteve në luftën kundër korrupsionit;
- Program i specializuar trajnimi në forcimin e kapaciteteve profesionale në luftimin e shpëlarjes së parave;
- Program i specializuar trajnimi për prokurimin publik;
- Program i specializuar trajnimi në forcimin e kapaciteteve profesionale në luftimin e krimit kibernetik.

#### **Program i specializuar trajnimi për zhvillimin e kapaciteteve në luftën kundër korrupsionit**

Programi ka synuar që në mënyrë të detajuar dhe gjithëpërfshirëse t'i adresojë nevojat për zhvillim profesional të gjyqtarëve dhe prokurorëve që merren me luftimin e veprave penale korruptive. Në kuadër të këtij programi janë trajtuar sfidat rreth zbatimit të legjislacionit vendor në luftimin efikas të korrupsionit duke u fokusuar në aspekte specifike që paraqiten si problematike në praktikë. Krahas tyre, u trajtuan legjislacioni ndërkombëtar në këtë fushë me fokus në atë të BE-së, përfshirë standardet dhe praktikat e suksesshme të vendeve që kanë arritur sukses në luftimin e kësaj dukurie. Praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për Liritë dhe të Drejtat e Njeriut ka qenë në kuadër të këtij programi. Në fokus kanë qenë aspektet e avancimit të hartimit të akteve ligjore. Format e bashkëpunimit dhe koordinimit ndërinstitucional të institucioneve të mandatuara për luftën kundër korrupsionit. Programi është realizuar në tri (3) sesione trajnuese, me gjithsej gjashtë (6) ditë trajnimi.

#### **Program i specializuar trajnimi në forcimin e kapaciteteve profesionale në luftimin e shpëlarjes së parave**

Përmes zhvillimit të këtyre trajnimeve janë avancuar njohurit profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve në identifikimin dhe klasifikimin e veprave penale të shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit, në njohjen dhe analizimin e punës së institucioneve financiare dhe obligimet që i kanë këto institucione në drejtim të forcimit të kapaciteteve për luftimin e dukurive të kësaj natyre. Në fokus të këtij trajnimi ishin veprat penale të shpëlarjes së parave, financimin e terrorizmit dhe sanksionet, dobësitë e institucioneve financiare tek pastrimi i parave, luftimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në praktikë, kompetencat e NJIF, teknikat e ekzaminimit të

mashtimeve tek pastrimi i parave, mbledhjen e informatave dhe përgatitjen e profilit personal, gjurmimin e fondeve nga ana e marrësit dhe nga ana e pagesit, bashkëpunimin ndërkufitar dhe ndërkombëtar për luftimin e pastrimit të parave, paraqitjen e rastit në gjykatë, zgjidhjet e mundshme alternative si dhe masat për parandalimin e pastrimit të parave.

Programi është realizuar në tri (3) sesione trajnuese, me gjithsej gjashtë (6) ditë trajnimi.

#### **Program i specializuar trajnimi për prokurimin publik**

Në kuadër të programeve të specializuar janë edhe trajnimet për prokurimin publik si një ndër sferat më problematike në vend. Këto trajnime kishin për qëllim avancimin e njohurive të gjyqtarëve dhe prokurorëve rreth legjislacionit pozitiv, procedurave dhe fazave të prokurimit publik, si dhe identifikimin e indikatorëve të korrupsionit që lidhen me prokurimin publik. Në fokus të këtij programi ishte edhe faza e zbatimit të kontratës dhe po ashtu hetimi dhe gjykimi i veprave penale të kësaj natyre.

Programi është realizuar në dy (2) sesione trajnuese, me gjithsej katër (4) ditë trajnimi.


#### **Program i specializuar trajnimi në forcimin e kapaciteteve profesionale në luftimin e krimit kibernetik**

Vend të rëndësishëm në programin trajnues kanë zënë edhe sesionet e trajnimit për luftimin e krimit kibernetik. Qëllimi i këtyre trajnimeve ishte avancimi i njohurive në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtarë dhe mundësisë së ndjekjes së suksesshme të krimit kibernetikë, për provat elektronike, rëndësinë dhe veçoritë e tyre, si dhe të identifikojnë dhe vlerësojnë provat elektronike në përcaktimin e veprës penale. Programi trajtoi krimin e kryer përmes teknologjisë, sfidat e krimit kibernetik, vlerësimin dhe menaxhimin e rrezikut, luftimin e rreziqeve të sigurisë virtuale, roli i forenzikes në zbulimin e krimit kibernetik, provat elektronike – procedura dhe praktika, bashkëpunimi ndërkufitar dhe ndërkombëtarë në luftën kundër krimit kibernetikë.

Programi është realizuar në tri (3) sesione trajnuese, me gjithsej gjashtë (6) ditë trajnimi.

#### **Pjesëmarrja në trajnimet e specializuara**

Gjatë periudhës raportuese janar-dhjetor 2020, në kuadër të PTV-së janë realizuar 4 trajnime të specializuara, me 11 sesione trajnimi, dhe me 22 dite trajnimi. Numri i pjesëmarrësve në këto trajnime ishte 297. Prej tyre 172 gjyqtarë, 115 prokuror, si dhe pjesëmarrës tjerë 10, prej tyre avokatë shtetëror, stafi administrativ gjyqësor dhe prokurorial dhe ekspert të tjerë. Nga këta pjesëmarrës, 288 ishin shqiptarë, 7 serb, 1 nga pakica të tjera edhe 1 ndërkombëtar, ndërsa në baza gjinore, 182 pjesëmarrës ishin meshkuj dhe 115 femra.




Grafikoni nr. 13: Numri i trajnimeve të specializuara të realizuara

### Trajnimet për mbrojtjen nga dhuna në familje

Në periudhën raportuese, Akademia e Drejtësisë ka ofruar trajnime edhe në luftimin dhe parandalimin e dhunës në familje. Gjatë vitit 2020 janë realizuar 4 sesione trajnuese duke trajtuar mbrojtjen nga dhuna në familje si në aspektin civil ashtu edhe në aspektin penal.

Qëllimi i këtyre trajnimeve ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrëseve rreth përdorimit të procedurave standarde të veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje, zbatimit në mënyrë efikase dhe të drejtë të dispozitave lidhur me procedurën dhe afatet e vendosjes sipas kërkesave për urdhër mbrojtje si dhe të krahasojnë specifikat e dhunës në familje në procedurë civile dhe penale. Gjithashtu avancimi i njohurive profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve edhe sa i përket zbatimit konsekuentë të të gjitha akteve juridike me theks të veçantë edhe të Konventës së Stambollit.

Këto trajnime janë shoqëruar me akte të brendshme juridike si Kushtetuta, Kodi Penal, Ligjin për mbrojtjen nga dhuna në familje, po ashtu edhe Konventën e Stambollit, duke përfshirë strategji dhe broshura të ndryshme të cilat kanë trajtuar dhunën në familje dhe dhunën ndaj grave. Vëmendje gjatë këtyre sesioneve i'u është kushtuar trajtimit të dhunës në familje dhe implikimet e saj në të drejtat e njeriut duke bërë vështrime krahasimore edhe me aktgjykimet e Gjykatës Evropiane të Drejtave dhe të Lirive të Njeriut, të cilat kanë vënë bazat se si ndëshkohet një shtet nëse nuk ndërmerr masat e nevojshme për mbrojtjen e viktimës së dhunës në familje. Përfitues të këtyre trajnimeve ishin gjyqtarë dhe prokurorë, mbrojtës të viktimave, avokat dhe zyrtar tjerë.



Grafikoni nr. 14 Numri i pjesëmarrësve në trajnimet për dhunë në familje

#### 4.2.4.3 Trajnimet nga fusha Civile (materiale dhe procedurale)

Akademia e Drejtësisë vëmendje të veçantë iu ka kushtuar edhe trajnimeve nga fushën civile, me ç' rast gjatë vitit janë realizuar 22 trajnime duke përfshirë tema nga pjesa materiale dhe procedurale.

Temat kryesore të cilat u trajtuan në kuadër të këtyre trajnimeve janë:

- Shqyrtimi paraprak i padisë dhe seanca përgatitore;
- Procedura gjyqësore në rastet e mbrojtjes nga dhuna në familje;
- Mbrojtja gjyqësore në rastet e së drejtës së pronësisë, servituteve dhe pengimit të posedimit;
- Bashkëpunimi juridik ndërkombëtar-në lëmine civile;
- Shqyrtimi kryesor dhe mjetet provuese;
- Procedura gjyqësore në rastet e kompensimit të dëmit dhe kriteret e vlerësimit;
- Burimet e së drejtës, analogjia dhe interpretimi i zotësisë juridike dhe zotësisë së veprimit, së personave fizik dhe juridik si dhe punët juridike;
- Procedura gjyqësore në rastet e shpronësimit;
- Mjetet e përmbarimit;
- Mbrojtja gjyqësore në kontestet nga marrëdhënia e punës sipas Ligjit të Punës;
- Pavlefshmëria absolute dhe relative e kontratave si dhe bazat e përgjegjësisë për kompensimin e dëmit;
- Vendimet gjyqësore në Procedurë Kontestimore;
- Lejimi i përmbarimit dhe procedura sipas prapësimit, ankesës dhe mjeteve të jashtëzakonshme juridike në Procedurën Përmbarimore;
- Mjetet juridike të rregullta dhe të jashtëzakonshme sipas ligjit për procedurën kontestimore;
- Fitimi i pronësisë në mënyrë orgjinere/ Komentimi i rasteve-vendimeve të gjykatave;
- Regjimi pasuror martesor sipas Kodit Civil/ Komentim i Rasteve të gjykatave;
- E drejta e ndërtimit dhe qiraja afatgjate në tokë;
- Ndërmjetësimi;
- Tryezë me gjyqtarë dhe avokatë Harmonizimi i vendimeve të gjykatave në çështje civile;
- Mbikëqyrja e ligjshmërisë së punës dhe inspektimin e përmbaruesve;
- Harmonizimi i vendimeve të gjykatave në çështjet trashëgimore dhe në çështjet detyrimore.

Çështjet e trajtuara nga fusha civile kishin për synim ngritja e kapaciteteve profesionale të gjyqtarëve me qëllim që të:

- Zbatojnë drejtë dispozitat e LPK-së, lidhur me shqyrtimin paraprak të padisë;
- Aplikojnë procedura standarde të veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje;
- Avancojnë njohuritë rreth bashkëpunimit juridik ndërkombëtarë për çështjet civile;
- Njohin specifikat e rasteve të shkaktimit të demit ndaj subjekteve të së drejtës;
- Vlerësojnë kushtet ligjore të cilat duhet të plotësohen për shpronësim;
- Avancimit të njohurive profesionale lidhur me burimet e së drejtës dhe analogjinë;
- Dallojnë kontestet për shërbyesit civil dhe kontestet e tjera nga marrëdhënia e punës sipas ligjit të punës;
- Identifikojnë rrethanat që shkaktojnë pavlefshmërinë absolute dhe relative të kontratave;
- Zgjerojnë njohuritë në lidhje me titujt përmbarrimor në procedurën përmbarrimore;
- Analizojnë kushtet ligjore për paraqitjen dhe vendosjen sipas këtyre mjeteve juridike;
- Zbatojnë dispozitat e Ligjit për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore lidhur me fitimin dhe humbjen e pronësisë;
- Avancimi i njohurive profesionale lidhur me zbatimin e legjislacionit për pasurinë e përbashkët bashkëshortore;
- Kuptojnë rolin e autoriteteve përgjegjëse për mbikëqyrjen e ligjshmërisë së punës së përmbarruesve privat dhe autorizimet e tyre;
- Avancojnë njohuritë rreth harmonizimit të vendimeve të gjykatave në çështjet trashëgimore dhe çështjet detyrimore.

#### 4.2.4.4 Trajnimet nga Drejtësia për fëmijë – aspekti civil dhe penal

Gjatë vitit 2020, Akademia e Drejtësisë në kuadër të fushës së drejtësisë për fëmijë, ka realizuar pesë (5) trajnime, prej tyre dy (3) nga aspekti penal dhe dy (2) nga aspekti civil.

Drejtësia për Fëmijë – aspekti penal ka trajtuar tema si: Masat e diversitetit, Marrja në pyetje e të dëmtuarit në veprat penale kundër integritetit seksual si dhe Masat edukative dhe dënimet. Qëllimi i këtyre trajnimeve ishte avancimi i njohurive dhe shkathtësive të gjyqtarëve dhe prokurorëve lidhur me:

- Zbatimin e drejtë të dispozitave të Kodit të Drejtësisë për të Mitur;
- Analizimin e drejtë të veprimeve procedurale të cilat ndërmerren kur kemi të bëjmë me viktimën fëmijë dhe kushteve për shqiptimin e masave edukative si dhe të dënimeve.

Drejtësia për Fëmijë – aspekti civil ka trajtuar tema si: Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve pa kujdes prindëror dhe në rastet e ndryshimit të statusit të tyre dhe Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve në rastet e shkurorëzimit dhe në rastet e dhunës në familje. Këto trajnime kishin për qëllim ngritjen e aftësive dhe shkathtësive të gjyqtarëve lidhur me:

- Vlerësimin e rasteve për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve pa kujdes prindëror;
- Zbatimin e mbrojtjes efikase të drejtave të fëmijëve gjatë procedurës së shkurorëzimit.

#### 4.2.4.5 Trajnimet nga fusha Ekonomike

Vend të rëndësishëm në programin trajnues për vitin 2019, kanë zënë edhe trajnimet për gjyqtarët që trajtojnë lëndët nga fusha ekonomike. Në kuadër të këtij programi, Akademia ka realizuar tetë (8) trajnime, ku janë trajtuar çështjet si: Kontratat në ekonomi, Të drejtat e pronësisë industriale – Markat tregtare, Trajtimi praktik i kontratës për kredinë, Kontrata e sigurimit, Ligji për shoqëritë tregtare, Kontrata e ndërtimit, Shkëputja e kontratës dhe efektet e shkëputjes, Procedura e falimentimit të shoqërive tregtare dhe Pronësia intelektuale në aspektin civil dhe penal.

Trajnimet nga lëmia ekonomike synuan ngritjen e kapaciteteve profesionale të gjyqtarëve në:

- Kuptimin e kontratës së franshizës, asignacionit, lizingut, know-how, licencën, etj., dhe specifikat e tyre;
- Kuptimin e markës tregtare dhe nevojën për mbrojtje juridike;
- Rritjen e ekspertizës profesionale të gjyqtarëve për ta trajtuar Kontratën e kredisë, specifikat e saj, klauzolat e posaçme dhe karakteristikat tjera;
- Rritja e ekspertizës profesionale të gjyqtarëve në fushën e sigurimeve, specifikat e saj, klauzolat e posaçme dhe karakteristikat tjera;
- Identifikimin e Shoqërive tregtare, specifikat e tyre, dhe karakteristikat tjera;
- Rritja e ekspertizës profesionale të gjyqtarëve në sferën kontraktuale;
- Vlerësimin e kushteve që duhet t'i plotësojë një markë tregtare për t'u regjistruar dhe llojet e markave tregtare sipas legjislacionit të BE-së dhe Praktikës së Zyrës për Pronësi Intelektuale të BE-së.

#### 4.2.4.5 Trajnimet nga fusha Administrative

Gjatë vitit 2020, programi trajnues ka trajtuar edhe çështje të ngritura nga gjyqtarët e Departamentit për Çështje Administrative. Nga kjo lëmi, janë realizuar pesë (5) trajnime si: Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative - Udhëzuesi praktik, Fillimi dhe zhvillimi i konflikteve administrative, Procedura Administrative dhe Procedura e Konfliktit Administrativ në fushën e Skemave Pensionale, Kontestet e Shërbimit Civil, Tatimi dhe Dogana dhe Agjencisë Kadastrale, Zbatimi i Ligjit për Zyrtarët Publik, E Drejta e Azilit dhe legjislacioni në fuqi.

Si rezultat i këtyre trajnimeve është synuar ngritja e kapaciteteve profesionale të gjyqtarëve që të:

- Interpretojnë drejtë dispozitat ligjore për procedurën administrative dhe procedurën e konfliktit administrativ;
- Zbërthejnë drejtë procedurat para organit administrativ me rastin e nxjerrjes së akt-emërimit për zyrtarët publik;
- Analizojnë të drejtën e azilit komform legjislacionit në fuqi.



#### 4.2.4.6 Trajnimet nga E Drejta Kushtetuese

Gjatë periudhës raportuese, Akademia e Drejtësisë në kuadër të PTV, ka realizuar një (1) trajnim nga lëmia e së drejtës kushtetuese me temë: Vendimet e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, efektet juridike dhe mënyra e përmbartimit të tyre. Qëllimi i realizimit të këtij trajnimi ishte ngritja e aftësive profesionale rreth njohjes së rolit të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese dhe efekteve juridike të cilat i prodhojnë vendimet e Gjykatës Kushtetuese.

#### 4.2.4.7 Trajnimet për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme

Në kuadër të trajnimeve për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme janë realizuar dy (2) trajnimet të cilat kanë përfshirë çështjet si në vijim: Risitë në Ligjin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, Mjetet e rrëzimit të vendimeve pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme.

Qëllimi i këtyre trajnimeve ishte ngritja e kapaciteteve profesionale të gjyqtarëve lidhur me:

- Risitë e Ligjit të Dhomës së Posaçme dhe të identifikojnë se në çfarë mase është zgjeruar juridiksioni ekskluziv i Dhomës së Posaçme;
- Njohjen e mjeteve për rrëzimin e vendimeve apo veprimeve të AKP-së;
- Zbatimin drejtë të dispozitave ligjore lidhur me kufijtë e ekzaminimit të ankesës apo Kundërshtimit.

#### 4.2.4.8 Trajnimet nga fusha e kundërvajtjeve

Në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme, janë trajtuar tri (3) trajnimet nga fusha e kundërvajtjeve si: personat juridik në procedurën e kundërvajtjes, procedura kundërvajtëse sipas kërkesave të inspektorateve si dhe ligji për pyjet e Kosovës, mbrojtjen e natyrës dhe mbrojtjen e ambientit.

Temat e trajtuara kanë synuar ngritjen e kapaciteteve profesionale të gjyqtarëve që të:

- Përkufizojnë qartë dhe drejtë subjektet afariste si persona juridik dhe personin përgjegjës të personit juridik;
- Përpilojnë qartë dhe drejtë kërkesën për fillimin e procedurës kundërvajtëse, me përshkrim faktik dhe kualifikim juridik adekuat;
- Zbatojnë drejtë dispozitat e Ligjit për Pyjet e Kosovës.

#### 4.2.4.9 Trajnimet për Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Me qëllim të garantimit dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut gjatë zhvillimit të procedurave ligjore duke potencuar edhe garantimin e tyre edhe Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Akademia e Drejtësisë, në kuadër të KEDNJ, gjatë vitit 2020 ka realizuar katër (4) trajnimet, ku janë trajtuar tema si: E Drejta në Gjykim të Drejtë – neni 6 i KEDNJ, E drejta për liri dhe siguri-neni 5 i KEDNJ, E drejta në Pronë - Jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Liria e shprehjes dhe mbrojtja nga shpifja - neni 10 i KEDNJ.

Fokusi kryesor i këtyre trajnimeve ishte ngritja e aftësive dhe shkathtësive profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve në:

- Avancimin e njohurive lidhur me zbatimin e nenit 1,5,6 dhe nenit 10 të KEDNJ;

- Analizimin e efektit të KEDNJ në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

#### 4.2.4.10 Trajnimet për mosdiskriminimin

Akademia e Drejtësisë rëndësi të veçantë në programin trajnues i ka kushtuar edhe adresimit të sfidave gjatë zbatimit të legjislacionit për mosdiskriminim e poashtu edhe rekomandimeve të BE-së, ku ka realizuar dy (2) aktivitete trajnuese lidhur me barazinë gjinore dhe mosdiskriminimin. Temat e trajtuara nga kjo lëmi ishin: Avancim mbi të drejtat e personave LGBTI në Kosovë.

Fokusi kryesor i këtyre trajnimeve ishte në ngritjen e aftësive dhe shkathtësive profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve lidhur me të drejtat e komunitetit LGBTI sipas kornizës ligjore në Kosovë si dhe identifikimin e shkeljeve të të drejtave të njeriut nga raste konkrete.

#### 4.2.4.11 Trajnimet nga fusha e ndërmjetësimit

Gjatë vitit 2020, Akademia e Drejtësisë, në kuadër të kësaj fushe ka realizuar gjashtë (6) trajnime regjionale për Ndërmjetësimin. Këto trajnime kanë prekur ndërmjetësimin në aspektin penal, civil dhe ekonomik. Fokusi kryesor i këtyre trajnimeve ishte në ngritjen e aftësive dhe shkathtësive profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve lidhur me ndërmjetësimin, specifikat dhe karakteristikat e tij.

#### 4.2.4.12 Trajnimet nga kompetenca ndërdisiplinare

Në kuadër të kësaj kompetence janë realizuar disa trajnime, ku janë trajtuar: Hartimi dhe arsyetimi i vendimeve gjyqësore dhe Etika profesionale.

Fokusi kryesor i këtyre trajnimeve ishte në ngritjen e aftësive dhe shkathtësive rreth:

- Avancimit në zbatimin e metodologjisë së shkrimit të vendimeve, akteve akuzuese dhe shkresave tjera ligjore;
- Avancimit të njohurive lidhur me rregullat bazë të etikës ashtu siç parashikohen ato në Kodin e etikës profesionale për prokurorë.


#### 4.2.4.13 Trajnimet e obligueshme

Me qëllim të zbatimit të kërkesave të KGJK-se dhe KPK-së, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnimet të Vazhdueshme, gjatë vitit 2020 ka realizuar trajnimet e obligueshme “Etika profesionale” për gjyqtarë dhe prokurorë.


Qëllimi i realizimit të këtyre trajnimeve ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve për Kodin e Etikës profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve në përgjithësi, parimet bazë të etikës, përgjegjësit që rrjedhin nga zbatimi i ligjit për përgjegjësinë, shkeljet dhe masat disiplinore, konkretisht njohjes së kufirit dhe dallimit në mes shkeljes disiplinore dhe shkeljes procedurale.

Për shkak të përmbajtjes, këto trajnime janë realizuar ndaras. Trajnimi i obligueshme për Etiken Profesionale për gjyqtarë është realizuar përmes platformës së mësimi në distancë E-learning, ndërsa tri (3) trajnimet e obligueshme për Etiken Profesionale për prokurorë janë realizuar përmes platformës elektronike Zoom.

Numri i gjyqtarëve që e kanë përfunduar trajnimin për Etiken profesionale gjatë 2020 është 301 ndërsa numri i prokurorëve është 156.



Grafikoni nr.15: Numri i gjyqtarëve që kanë ndjek trajnimin për Etiken Profesionale




Grafikoni nr.16: Numri i prokurorëve që kanë ndjek trajnimin për Etiken Profesionale

#### 4.2.5 Bashkpunimi dhe mbështetja e donatorëve në ofrimin e Trajnimeve të Vazhdueshme

Në periudhën raportuese në kuadër të këtij programi janë realizuar aktivitete të shumta si rezultat i bashkëpunimit me partnerë dhe donatorë të ndryshëm të cilët e mbështesin sistemin e drejtësisë.

Zbatimi këtyre projekteve, por edhe projekteve tjera me donatorë, kanë qenë mbështetje për Akademinë dhe vlerë e shtuar e programit të trajnimeve, prandaj si të tilla kanë marrë mbështetje për realizim, duke e vlerësuar në radhë të parë interesin e sistemit gjyqësor dhe prokurorial dhe bartësve të funksioneve gjyqësore.



Grafikoni nr. 17: Numri i trajnimeve në bazë të financuesit

### 4.3 Mësimi në distancë nëpërmes platformës E-learning

Përveç trajnimeve klasike, Akademia e Drejtësisë ka zhvilluar platformën e mësimi në distancë E-learning me qëllim të lehtësimit të marrjes së informacionit dhe çasjes më të lehtë për tema të ndryshme për përfituesit e saj (Gjyqtarë, Prokurorë, staf administrativ i gjykatave dhe prokurorive)etj. Mësimi në Distancë është një formë e re e të mësuarit e cila gjithnjë e më shumë është duke u zhvilluar dhe duke gjetur hapësirë nëpër institucione të ndryshme arsimore, edukative dhe akademike. Përmes platformës E-learning krijohet një ambient më efektiv i të mësuarit, për arsye se edhe mënyra e dhënies së informacionit është më atraktive për lexuesin, përmes audio incizimeve, teksteve apo testimeve të ndryshme online. Qëllimi afatgjatë është që platforma E-learning të bëhet një burim i rëndësishëm i informacionit duke përmbajtur kurse të zhvilluara në mënyrë sa më profesionale dhe me informata të sakta, gjithmonë duke qenë e përditësuar me ndryshimet dhe risitë ligjore. Në periudhën raportuese në platformën e mësimi në distancë janë zhvilluar online 19 kurse trajnuese, 11 prej të cilave kanë qenë të qasshme edhe në gjuhën serbe. Nga muaji prill, për shkak të pndemisë COVID 19, të gjitha kurset trajnuese kanë qenë të hapura pa limit kohor.

Për në detaje kurset trajnuese si në vijim:

1. Komunikimi dhe marrëdhëniet me publikun për zyrtarët për informim;
2. Dhuna në Familje;
3. Mbajtja e shënimeve për Interpret Gjyqësor;
4. Menaxhimi Efektiv;
5. Etika Profesionale;
6. Drejtësia për fëmijë – Aspekti Civil;
7. Drejtësia për fëmijë – Aspekti Penal;
8. E drejta e autorit dhe mbrojtja juridike;
9. Faza e aktakuzës dhe deklarimit për fajësinë;
10. Hetimi dhe zbulimi i korrupsionit;
11. Teknologjia Informative;


- 12. Korrupsioni sipas legjislacionit vendor dhe ndërkombëtar;
- 13. Masat e Diversitetit;
- 14. Menaxhimi i Gjykatës;
- 15. Menaxhimi i Stresit;
- 16. Shkathësitë e komunikimit social;

- 17. Trajnimi për implementimin e Legjislacionit Tatimor në Kosovë;
- 18. Udhëheqësia - Lidershipi;
- 19. Anglishtja Ligjore.

Si kurse të reja, gjatë vitit 2020 janë zhvilluar këto kurse:

- 1. Etika Profesionale;
- 2. Mbajtja e shënimeve për Interpret Gjyqësor;
- 3. Komunikimi dhe marrëdhëniet me publikun për zyrtarët për informim;
- 4. Masat e Diversitetit;
- 5. Menaxhimi Efektiv;
- 6. Dhuna në Familje.

Platforma e mësimit në distancë E-learning		
Përfituesit	Kurse trajnuese 19	Pjesëmarrës
Gjyqtarë	309	869
Prokurorë	5	
Bashkëpunëtor Profesional	2	
Staf administrativ	9	



Grafikoni nr.18 me Kurset në platformën E-learning dhe numrin e Pjesëmarrësve në vitin 2020

#### 4.4 Trajnimet për Trajnues

Akademia e Drejtësisë, përveç trajnimeve për Gjyqtarë, Prokurorë, staf administrativ të gjykatave dhe Prokurorive, gjithmonë ka pasur për qëllim edhe ngritjen e shkathtësive dhe metodologjive trajnuese për trajnuesit e saj.

Trajnimi i Trajnuesve në Akademi ka zënë vend të rëndësishëm në Programet e saj Trajnuese, duke bërë që çdo vit në fokus të jenë edhe trajnuesit dhe zhvillimet e tyre profesionale, aftësimi i tyre në fusha të caktuara me theks të veçantë përshtatja e teknikave trajnuese me mjetet teknologjike, ndryshimi i metodologjive trajnuese si dhe metodat e ligjërimit.


Akademia e Drejtësisë zhvillon trajnimet e trajnuesve si rrjedhojë e vlerësimit të nevojave dhe të dalurat nga trajnimet me gjyqtarë, prokurorë, staf administrativ i gjykatave dhe prokurorive. Për shkak të natyrës dhe kompleksitetit të trajnimit, trajnimet TiT zhvillohen zakonisht me ekspert të fushave të caktuara, e shumë shpesh edhe me ekspert ndërkombëtarë, me qëllim të mbajtjes së hapit me metodat më të avansuara në fushën e trajnimeve.

Në vitin 2020 janë realizuar këto Trajnime për Trajnues:

- 4.4.1 Trajnim për Trajnues rreth udhëzuesit për përdorimin e HUDOC** – Trajnimi është realizuar më 22 Janar 2020, në bashkëpunim me UNDP. Pjesëmarrës ishin 11 Gjyqtarë dhe 3 Prokurorë dhe 2 trajnues nga AD që shërbejnë edhe si Trajnues në Akademinë e Drejtësisë. Trajnimi kishte për qëllim sjelljen e risive tek pjesëmarrësit rreth zhvillimit të udhëzuesit HUDOC dhe përdorimit të tij në mënyrë sa më efektive në zgjidhjen e lëndëve.
- 4.4.2 Bazat e përkthimit Konsekutiv (marrja e shënimeve për Interpret Gjyqësor)** – Trajnimi u realizua më 23 Janar 2020, në bashkëpunim me JSSP (programin për forcimin e sistemit të Drejtësisë në Kosovë).
- 4.4.3 Hartimi Avansuar i Aktakuzave** – Trajnimi u realizua me 31 Gusht 2020 deri më 04 Shtator 2020, në bashkëpunim me OSCE. Pjesëmarrës ishin 14 Prokurorë nga nivele të ndryshme brenda prokurorive, shumica prej të cilëve ishin të rinjë që aspirojnë të jenë trajnues në të ardhmen. Qëllimi i trajnimit ishte që prokurorët të njihen me metodat e fundit të hartimit të aktakuzave, shkrimin ligjor, llojet e aktakuzave, përfaqësimin e aktakuzës etj.
- 4.4.4 Analizë Praktike e rasteve dhe Avokimit në Gjykim** – Trajnimi u realizua më 07 dhe 09 Tetor 2020, në bashkëpunim me AXIOM International (Ambasada Britaneze në Kosovë). Pjesëmarrës ishin 2 Gjyqtarë dhe 3 Prokurorë. Qëllimi i Trajnimit ishte zhvillimi i njohurive rreth mënyrës së marrjes së drejtpërdrejtë dhe të tërthortë në pyetje, fjalës hyrëse, fjalës përfundimtare etj.
- 4.4.5 Liria e Shprehjes – Neni 10 i KEDNJ** – Trajnimi u realizua më 09 Tetor 2020, në bashkëpunim me JUFREX, në vazhden e konferencës rajonale të trajnuesve të çertifikuar nga JUFREX e cila u zhvillua më 08 Tetor 2020. Pjesëmarrës ishin 3 Gjyqtarë dhe 2 Prokurorë dhe 1 trajnues i përhershëm i AD-së të cilët janë edhe Trajnues në Akademinë e Drejtësisë. Qëllimi i trajnimit ishte rifreskimi i njohurive rreth Nenit

10 të KEDNJ, Doracaku i ri i përditësuar për trajner rreth Lirisë së Shprehjes, zhvillime t e fundit në Jurisprudencën e GJEDNJ etj.

**4.4.6 Drejtësia Komerciale** – Trajnimi u realizua me 24 Nëntor deri më 27 Nëntor 2020, në bashkëpunim me Checchi&Company Consulting Inc., si implementuese e Programit për Drejtësi Komerciale brenda Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Pjesëmarrës ishin 18 Kandidat të rekrutuar nga Akademia e Drejtësisë të cilët më vonë do të përdoren si trajnues në fushën Komerciale. Qëllimi i trajnimit ishte që të krijohet një kuadër i kualifikuar dhe i profesionalizuar i trajnuesve në fushën Komerciale, të hartohet një kurrikulë gjithëpërfshirëse e trajnimit në fushën komerciale, përmirësimi dhe harmonizimi i legjislacionit vendor dhe ndërkombëtar në aspektin tregtar etj.



Grafikoni nr.19- Trajnimet për Trajnues në periudhën Janar – Dhjetor 2020

#### 4.5 Trajnimet për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial si dhe për profesionet e lira


Bazuar në Ligjin për Akademinë e Drejtësisë, stafi administrativ gjyqësor dhe prokurorial janë kategori e re përfituese të trajnimeve. Duke pasur parasysh rolin dhe rëndësinë e tyre në përmirësimin e efikasitetit të punës së gjykatave dhe prokurorive, Akademia e Drejtësisë ka zhvilluar program të veçante të trajnimit për këtë kategori. Përmes Programit Trajnues është synuar ngritja e performancës së stafit administrativ gjyqësor dhe prokurorial, ngritja e aftësive dhe kapaciteteve të tyre profesionale, njoftimi me informacion të përgjithshëm në lidhje me strukturën dhe administrimin e sistemit gjyqësor/prokurorial, parimet dhe detyrat kryesore në kryerjen e detyrave administrative në kuadër të sistemit, nxitjen e cilësisë së shërbimeve të ofruara nga pjesëtarët e administratës që kontribuojnë në zhvillimin e një administrate moderne, profesionale, efektive dhe transparente. Përfitues të këtij programi janë: bashkëpunëtor profesional, zyrtarët ligjor, administratorët, ndihmës administrator, shefat e ZML, zyrtarët për informim, zyrtar të statistikave, sekretar juridik.

#### 4.5.1 Trajnimi për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial

Akademia e Drejtësisë, në mandatin e saj ka edhe organizimin e trajnimeve për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial. Në periudhën raportuese janë realizuar dhjetë (10) aktivitete trajnuese sipas kurrikulës trajnuese të hartuar veçanërisht për këtë kategori përfituese. Në kuadër të këtyre janë trajtuar temat si në vijim:

- Bazat e përkthimit konsektiv (marrja e shënimeve) për përkthyes gjyqësor-Gr.III;
- Trajnim për protokoll;
- Sistemi gjyqësor dhe prokurorial, struktura dhe kompetencat;
- Menaxhimi i punës në administratën e sistemit gjyqësor dhe prokurorial;
- Shkrimi dhe arsyetimi ligjor;
- Menaxhimi i dosjes dhe lëndës në sistemin gjyqësor dhe prokurorial;
- Integriteti dhe sjelljet etike;
- Menaxhimi i TIK-(sistemi SMIL);
- Menaxhimi i kohës dhe stresit;
- Të drejtat e njeriut dhe garancitë juridike dhe procedurale për mbrojtjen e tyre.

Në grafikonin në vijim pasqyrohet stafi administrativ pjesëmarrës në trajnime:




Grafikoni nr. 20: stafi administrativ i trajnuar

Stafi administrativ i gjykatave dhe prokurorive, përkatësisht bashkëpunëtorët profesional, zyrtarët ligjor, mbrojtësit e viktimave si dhe stafi tjetër gjyqësor përveç trajnimeve që i janë dedikuar këtyre kategorive kanë marrë pjesë edhe në trajnimet e vazhdueshme së bashku me gjyqtarët dhe prokurorët.

Në grafikonin në vijim pasqyrohet stafi administrativ pjesëmarrës në trajnime:





Grafikoni nr. 21: stafi administrativ i trajnuar

#### 4.6 Trajnimi për profesionet e lira

Akademia e Drejtësisë në pajtim me Ligjin për Akademinë e Drejtësisë, sipas mundësisë mund të ofrojë trajnime edhe për profesionet e lira. Në periudhën raportuese, Akademia e Drejtësisë ka pasur kërkesa nga Ministria e Drejtësisë për të ofruar trajnime për Avokatët shtetëror. Gjithashtu ka pasur kërkesa edhe nga Agjencioni për Ndihmë Juridike Falas (ANJF) si dhe nga Oda e përmbauesve privat (OPP).

##### 4.6.1 Trajnimi për Avokatët shtetëror

Gjatë vitit 2020 Avokatët Shtetëror kanë marrë pjesë në këto trajnime :

- Program i Specializuar Trajnimi për Prokurimin Publik të Kosovës - Sesioni I, pjesëmarrës 1 Avokat Shtetëror;
- Program i Specializuar Trajnimi-Krimi kibernetik, provat elektronike - Sesioni I, pjesëmarrës 2 Avokatë Shtetëror;
- Program i Specializuar Trajnimi - Krimi i organizuar dhe korrupsioni - Sesioni II, pjesëmarrës 1 Avokat Shtetëror;
- Program i Specializuar Trajnimi- Shpërlarja e Parave-Sesioni II, pjesëmarrës 2 Avokatë Shtetëror;
- Faza e procedurës paraprake – hetimet proaktive dhe sigurimi i provave, pjesëmarrës 1 Avokat Shtetëror;
- Mbrojtja gjyqësore në kontestet nga marrëdhënia e punës sipas Ligjit të Punës, pjesëmarrës 7 Avokatë Shtetëror;
- Vendimet e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, efektet juridike dhe mënyra e përmbaimit të tyre, pjesëmarrës 1 Avokat Shtetëror;
- Lejimi i përmbaimit dhe procedura sipas prapësimit, ankesës dhe mjeteve të jashtëzakonshme juridike në Procedurën Përmbaimore, pjesëmarrës 4 Avokatë Shtetëror;
- Procedura kundërvajtëse sipas kërkesave të inspektorateve, pjesëmarrës 1 Avokat Shtetëror.

##### 4.6.2 Trajnimi për zyrtarët e Agjencionit për ndihmë juridike falas

Në kuadër të trajnimeve për zyrtarët e ANJF në mbështetje të GIZ-it, janë realizuar katër (4) sesione trajnuese të cilat kanë përfshirë çështje të ndryshme ligjore nga fusha civile. Këto sesione trajnuese i kanë ndjekur 22 zyrtarë nga Agjencia për Ndihmë Juridike Falas,

#### 4.6.3 Trajnimi për përmbauesit privat

Në kuadër të trajnimeve për përmbauesit privat është realizuar një (1) sesion trajnues me temë: Mbikëqyrjen e ligjshmërisë së punës së përmbauesve privat. Këtë sesion trajnues e kanë vijuar 30 përmbaues privat.

#### 4.7 Programi për Hulumtime dhe Publikime (PHP)

Bazuar në Ligjin për Akademinë e Drejtësisë, Programi për Hulumtime dhe Publikime ka për qëllim zhvillimin e kapaciteteve profesionale dhe interdisciplinare të gjyqtarëve, prokurorëve si dhe stafit administrativ gjyqësor dhe prokurorial përmes ofrimit të burimeve të nevojshme juridike si dhe zhvillimin e programeve trajnuese të AD-së përmes aktiviteteve kërkimore.

Përmes këtij programi kryen edhe analiza, hulumtime dhe veprimtari botuese për nevojat e sistemit gjyqësor dhe prokurorial.

##### 4.7.1 Aktivitetet në PHP

Gjatë vitit 2020 në kuadër të PHP-së janë zhvilluar aktivitete të cilat kanë qenë të orientuara në drejtim të:

- Zbatimit të procesit për vlerësim të nevojave trajnuese dhe përpunimit të dhënave për draftimin e Programit Trajnues për vitin 2021;
- Veprimtarisë botuese me fokus te revista Justicia, module trajnuese, buletini dhe format tjera të botimeve;
- Ofritit të burimeve ligjore sipas kërkesave të përfituesve të AD-së;
- Aktiviteteve në procesin e planifikimeve institucionale në zbatim të masave dhe politikave euro integruese si dhe
- Menaxhimit të koleksioneve të bibliotekës dhe abonimit në data baza elektronike.

##### 4.7.2 Zbatimi i procesit për vlerësim të nevojave trajnuese

Procesi për vlerësimin e nevojave trajnuese është realizuar duke i zbatuar me efikasitet mekanizmat për vlerësim i cili ka kërkuar angazhim dhe përkushtim gjatë gjithë vitit. Lidhur me këtë janë analizuar gjitha burimet e informacionit dhe janë përcjellë zhvillimet e reja në gjyqësor. Pra, në funksion të vlerësimit të nevojave trajnuese në periudhën raportuese janë zhvilluar këto aktivitete:

- Janë mbledhë dhe përpunuar të dhënat nga analiza e formularëve të vlerësimit pas secilit sesion trajnues deri në fund të vitit 2020;
- Janë mbledhë dhe përpunuar të dhënat nga pyetësorët për gjyqtarë dhe prokurorë<sup>8</sup>
- Janë përfshirë diskutimet nga takimet me trajnues të AD-së, kryetarë të gjykatave, gjyqtarë mbikëqyrës si dhe përfaqësues nga KGJK dhe KPK

<sup>8</sup> Akademia përveq formularit në kopje fizike ka krijuar pyetësorin online për gjyqtarë dhe prokurorë, linçet e të cilëve iu kanë dërguar të gjitha gjykatave dhe prokurorive të Kosovës,

- Janë kërkuar dhe marrë për bazë edhe propozimet nga trajnuesit e përhershëm të AD-së;
- Janë analizuar gjitha dokumentet strategjike të cilat përmbajnë rekomandime për gjyqësorin duke përfshirë edhe raportin e BE-së për Kosovën;
- Janë analizuar edhe kërkesat e MSA-së veçanërisht ato që kanë impakt për gjyqësorin e Kosovës;
- Janë shqyrtuar portalet e gjykatave dhe prokurorive duke marrë për bazë edhe raportet e punës së tyre;
- Për çështje krahasimore janë shqyrtuar edhe programet trajnuese të institucioneve trajnuese rajonale si dhe
- Në vazhdimësi është përcjellë agjenda legislative në kuvend si dhe mediat dhe portalet të cilat kanë pasur në fokus gjyqësorin e Kosovës.

Në vazhden e identifikimit të nevojave trajnuese për vitin 2021, Akademia e Drejtësisë në periudhën raportuese ka realizuar takime me Gjykatat dhe Prokuroritë nga gjitha instancat duke përfshirë Kryetar të Gjykatave dhe Kryeprokuror të Prokurorive, kryesuesin e KGJK-së dhe KPK-së, gjyqtarë mbikëqyrës të departamenteve e gjithashtu edhe trajnues të Akademisë së Drejtësisë nga radhët e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Me rastin e këtyre takimeve janë diskutuar vështirësitë dhe sfidat me të cilat ballafaqohet praktika gjyqësore dhe mundësia e adresimit të tyre përmes Programit Trajnues të Akademisë së Drejtësisë. Përmbyllja e këtij procesi është finalizuar me raportin analizë nga vlerësimi i nevojave trajnuese për vitin 2021 duke i kontribuar draftimit dhe hartimit të Programit Kornizë 2021-2022 dhe Programit trajnues për vitin 2021.

Në procesin për vlerësimin e nevojave trajnuese, Akademia e Drejtësisë për fusha specifike me theks të veçantë për drejtësinë komerciale ka gëzuar përkrahje nga projekti i Checchi&Company Consulting, si implementuese e Programit për Drejtësi Komerciale brenda Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) si dhe për mbrojtjen nga diskriminimi nga projekti i UNDP-së.

Si rezultat i punës së përbashkët mes AD-së dhe projekteve të lartpërmendura janë zhvilluar aktivitete për vlerësim të nevojave trajnuese në këto fusha dhe janë zhvilluar kurrikulat përkatëse të cilat përfshijnë çështjet që janë me interes në drejtësinë komerciale dhe për mos diskriminimin.

#### 4.7.3 Veprimtaria botuese e Akademisë së Drejtësisë

Në periudhën raportuese, Akademia e drejtësisë është angazhuar në procesin e nxjerrjes dhe shtypjes së botimeve duke qenë në kontakt dhe monitoruar procesin deri në finalizimin e tyre. Kjo komponentë, veçanërisht publikimet që kanë karakter udhëzues për gjyqtarët dhe prokurorët është mbështetur edhe nga projektet me donatorë si GIZ.

Gjatë vitit 2020 për nevoja të funksionimit dhe zhvillimit të veprimtarisë së AD-së janë realizuar publikimet si në vijim:

- Plani i punës për vitin 2020 i AD-së;
- Raporti vjetor i AD-së për vitin 2019;
- Programi Kornizë 2021-2022 dhe Programi i Trajnimit për vitin 2021;
- Programi i Trajnimit Fillestar për gjyqtarët që priten të dekretohen në të ardhmen;
- Buletini në baza mujore për vitin 2020.

Duke marrë parasysh kërkesat dhe nevojat për zhvillimin e kapaciteteve në gjyqësor Akademia e Drejtësisë në mbështetje të GIZ ka hartuar dhe publikuar botimin si në vijim:

► Udhëzuesi për procedurën e Konfliktit administrativ

Përmes këtij udhëzuesi, Akademia e Drejtësisë ka dhënë kontributin e saj në plotësimin e punës praktike lidhur me vendimmarrjen, hartimin dhe arsyetimin e vendimeve dhe në lehtësimin e bërjes drejtë të drejtësisë në procedurën e konfliktit administrativ. Udhëzuesi i është shpërndarë gjyqtarëve në departamentin administrativ si dhe formati elektronik i tij është publikuar në databazën e bibliotekës elektronike.

#### 4.7.4 Aktivitete në dobi të nxjerrjes së revistës juridike “Justicia” të gjyqtarëve dhe prokurorëve të sapo emëruar

Në funksion të nxjerrjes së kësaj reviste gjatë vitit 2020 janë realizuar 3 takime me Këshillin e Redaksisë së Akademisë së Drejtësisë. Në kuadër të këtyre takimeve janë diskutuar çështje në kuadër të kompetencave të këtij organi si dhe janë shqyrtuar dhe janë lejuar për publikim vetëm ato që janë vlerësuar nga ky organ dhe njëkohësisht kanë qenë në pajtim me standardet dhe kriteret për publikim. Revista ofron punimet hulumtuese më të mira të gjyqtarëve të sapo emëruar të gjeneratës së VI-të dhe prokurorëve të sapo emëruar të gjeneratës së VII-të, të cilët kanë vijuar Programin e Trajnimit Fillestar në Akademi të Drejtësisë. Këto punime, Redaksia e Akademisë ka vendosë t'i publikojë pasi mënyra e trajtimit dhe tematika e përzgjedhur ishte sipas prioriteteve dhe kriterëve në bazë të standardeve të kërkuara për publikim për këtë revistë. Në periudhën raportuese kjo revistë pasi është finalizuar është dërguar në kompaninë kontraktuese për dizajn dhe shtyp dhe pritet të publikohet së shpejti.

#### 4.7.5 Aktivitete në mbështetje të mekanizmave euro integruar

Akademia e Drejtësisë është institucion i cili vepron dhe kontribuon në zbatimin e strategjive në nivel kombëtar të cilat kanë synim zbatimin e MSA-së dhe kërkesave që dalin nga raportet e organizatave që monitorojnë sistemin e drejtësisë dhe veçanërisht nga Raporti i BE-së për Kosovën. Në periudhën raportuese në mbështetje të Programit Kombëtar për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Njeriut të Zyrës për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit, është bërë planifikimi dhe masat e AD-së në zbatim të këtij programi për periudhën 2021-2023. Gjithashtu, në përmbushje të kërkesave për Agjendën Evropiane ERA dhe Planin Kombëtarë për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit (PKZMSA) janë planifikuar masat të cilat kanë synim përmirësimin e fushave që këto mekanizma i kanë detektuar si mangësi në sektorin e sundimit të ligjit.

Përveç mekanizmave euro integruar, Akademia e Drejtësisë në vazhdimësi ka bashkëpunuar me KGJK dhe KPK dhe Njësitë për shqyrtimin e performancës së gjyqtarëve dhe prokurorëve që veprojnë në kuadër të dy këshillave duke i ofruar të dhëna mbi vijueshmërinë e gjyqtarëve dhe prokurorëve në trajnime. Gjithashtu për nevoja të raportimit ose edhe të prezantimit institucional në konferenca, takime dhe forma tjera janë nxjerrë të dhëna statistikore për aktivitetet trajnuese dhe detajet tjera që tregojnë angazhimin e Akademisë në ngritje të kapaciteteve të gjyqtarëve, prokurorëve dhe përfituesve tjerë sipas ligjit

#### 4.7.6 Aktivitetet e bibliotekës së AD-së

##### Menaxhimi i koleksioneve të bibliotekës

Biblioteka e Akademisë është një burim kryesor i materialit hulumtues ligjor e cila është konsoliduar në mbështetje të zhvillimit profesional të gjyqtarëve dhe prokurorëve si dhe komunitetit tjetër ligjor, përfitues sipas Ligjit për Akademinë e Drejtësisë. Në periudhën raportuese, platformat përmes të cilave operon kjo bibliotekë ligjore si sistemi KOHA ashtu edhe biblioteka elektronike ka qenë në funksion të përfituesve të saj sipas ligjit duke përfshirë edhe studentë të Fakultetit Juridik si dhe praktikantë. Në funksion të ofrimit të shërbimeve dhe përmbushjes së kërkesave edhe menaxhimi i koleksioneve të kësaj biblioteke ka qenë prioritet gjatë gjithë kohës. Në këtë drejtim është përditësuar dhe monitoruar në vazhdimësi qarkullimi i resurseve të saj, është vazhduar me rexhistrimin e materialeve të reja ligjore dhe varësisht prej kërkesave qoftë kopjeve fizike ashtu edhe ato elektronike janë ofruar shërbime për përfituesit e saj.

##### Qasja në burime ligjore në data bazat ndërkombëtare

Me qëllim që përfituesve të saj t'iu ofrojë resurse dhe burime ligjore edhe nga rrafshi ndërkombëtarë, Akademia e Drejtësisë ka vazhduar anëtarësimin në Asociacionin e Bibliotekave Elektronike të Kosovës. Përmes këtij anëtarësimi, Akademia siguron qasjen në disa databaza që konzorciumi i EIFL-as i siguron për vendet në tranzicion. Në këtë mënyrë ka krijuar qasje në databazat vijuese të natyrës ligjore dhe të përgjithshme. Qasja në këto databaza ndryshon nga viti në vit. Prandaj gjatë këtij viti kemi qenë të abonuar në këto databaza:

1. <a href="#">ASTM Compass</a>	<a href="#">ASTM International</a>
2. <a href="#">Cambridge Journals Online</a>	<a href="#">Cambridge University Press</a>
3. <a href="#">e-Duke Journals Scholarly Collection</a>	<a href="#">Duke University Press</a>
4. <a href="#">Edward Elgar Publishing Journals and Development Studies e-books</a>	<a href="#">Edward Elgar Publishing</a>
5. <a href="#">IMF eLibrary</a>	<a href="#">IMF Publications</a>
6. <a href="#">IOPscience</a>	<a href="#">IOP Publishing</a>
7. <a href="#">OpenEdition Journals</a>	<a href="#">OpenEdition</a>

#### VII. Bashkëpunimi me donatorë dhe projekte ndërkombëtare - punëtori, tryeza pune dhe aktivitete tjera

Pvarësisht rrethanave të reja të shkaktuara nga pandemia COVID 19, Akademia e Drejtësisë nuk i ka mundur asistencën dhe mbështetjen nga donatorët duke përfshirë edhe bashkëpunimi ndërkombëtar. Në periudhën raportuese janë realizuar aktivitete të shumta në saje të këtij bashkëpunimi të cilët kanë ofruar mbështetje në realizim të trajnimeve, punëtorive dhe tryezave të shumta si dhe pjesëmarrje në konferenca dhe forume të ndryshme ndërkombëtare. Të gjitha këto aktivitete kishin në fokus ngritjen e kapaciteteve profesionale në luftimin dhe parandalimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit, pastrimit të parave, fuqizimit të drejtësisë komerciale, mbrojtjes së të drejtave të njeiut si dhe nga dhuna në familje. Nga këto aktivitete kanë përfituar gjyqtarë, prokurorë, staf administrativ i gjykatave dhe prokurorive si dhe profesionistë tjerë ligjor. Këto aktivitete janë

mbështetur nga Këshilli i Evropës, OPDAT-Ambasada Amerikane, zyra e BE-së në Prishtinë si dhe nga organizata të ndryshme ndërkombëtare që kanë në fokus mbështetjen e trajnimit gjyqësor.

### 5.1 Aktivitetet e realizuara me Departamentin e Drejtësisë së SHBA-së OPDAT - Ambasadën Amerikane

**Punëtori: Avansimi i konfiskimit të pasurisë së paligjshme** - Në peiudhën raportuese, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me Departamentin Amerikan të Drejtësisë/OPDAT, ka realizuar punëtorinë virtuale përmes platformës ZOOM me temë “Avansimi i konfiskimit të pasurisë së paligjshme”. Qëllimi i kësaj punëtorie ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve që përmes diskutimeve dhe prezantimit të praktikave më të mira, si dhe elaborimit të këtyre rasteve, të ngriten kapacitetet profesionale të hetuesve policor, të prokurorëve dhe gjyqtarëve në konfiskimin e pasurisë së paligjshme. Me rastin e kësaj punëtorie janë trajtuar aspektet procedurale me fokus te identifikimi i asetëve dhe të provuarit për qëllime konfiskimi. Të gjitha këto çështje janë trajtuar përmes rasteve praktike dhe punës në grupe me ç ‘rast prokurorët pjesëmarrës të ndihmuar nga hetuesit policor kanë identifikuar asetet me potencial për konfiskim. Pjesëmarrës në këtë punëtori ishin gjyqtarët, prokurorët e emëruar koordinator për konfiskim, prokurorët e Prokurorisë Themelore si dhe hetuesit policor.

### 5.2 Aktivitetet e realizuara me Programet e USAID

**Punëtori - Zgjidhja Alternative e Kontesteve – Ndërmjetësimi** - Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me Programin e USAID – Drejtësia Komerciale ka realizuar punëtorinë “Zgjidhja Alternative e Kontesteve-Ndërmjetësimi”. Punëtorinë kishte qëllim kryesor avancimin e njohurive të gjyqtarëve, bashkëpunëtorëve profesional dhe avokatëve lidhur me mënyrat e zgjidhjes alternative të kontesteve me fokus ndërmjetësimin. Në pjesën e parë të punëtorisë janë trajtuar: Roli dhe përgjegjësitë e gjyqtarëve, bashkëpunëtorëve profesional dhe avokatëve lidhur me referimin e rasteve në ndërmjetësim dhe përgjegjësitë që ka ndërmjetësuesi në raport me palët e përfshira në kontest gjatë mbajtjes së seancës së ndërmjetësimit. Në pjesën e dytë janë trajtuar: marrëveshjet për ndërmjetësim dhe përmbartimi i këtyre marrëveshjeve të arritura në procedurën e ndërmjetësimit.

**Takimi me trajnuesit nga radhët e përkthyesve dhe interpretëve gjyqësor** - Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me Programin e USAID për Fuqizimin e Sektorit të Drejtësisë në Kosovë – JSSP, ka realizuar takimin me trajnuesit e përzgjedhur nga radhët e përkthyesve dhe interpretëve gjyqësor. Qëllimi i këtij takimi ishte që përkthyesit dhe interpretët gjyqësor të përgatiten në cilësinë e trajnuesve, dhe të ndihmojnë në bartjen e njohurive në të ardhmen tek përkthyesit tjerë me qëllim të përmirësimit të përkthimit në procedurat gjyqësore si dhe sigurimit që palët të kenë qasje dhe përfaqësim të barabartë në gjuhët zyrtare të Kosovës. Një ndër pikat kryesore të këtij takimi ishte metodologjia e shpjegimit dhe mënyrat e përdorimit të Softuerëve të Përkthimit apo përdorimin e Tradosit.

**Takimi për vlerësimin e Nevojave të Trajnimit për Drejtësinë Komerciale** - Akademisa e Drejtësisë vëmendje të veçantë i ka kushtuar nevojave trajnuese në fushën komerciale meqenëse zhvillimet në këtë drejtim ishin të fokusuara në drejtim të krijimit të Gjykatës Komerciale. Në prezencën e gjyqtarëve nga departamenti ekonomik dhe divizioni fiskal i departamentit administrativ është elaboruar analiza e nevojave për trajnime në të drejtën komerciale për gjyqtarë dhe stafin administrativ nga Programi i USAID – Drejtësia Komerciale implementuar nga Checchi and Company Consulting. Qëllimi i këtij prezantimi ishte analiza dhe gjetjet kryesore mbi nevojat për trajnime si dhe konfirmimi i gjetjeve dhe dakordimi për programin e trajnimit nga ana e gjyqtarëve të

departamentit ekonomik dhe divizionit fiskal të departamentit administrativ si dhe stafit administrativ të gjykatës nga departamenti ekonomik. Me rastin e prezantimit u vu në pah që programi i USAID-it është në mbështetje të krijimit të Gjykatës Ekonomike dhe fuqizimit të gjyqtarëve dhe stafit të saj me theks të veçantë përmes zbatimit të programeve të trajnimit në kuadër të Akademisë së Drejtësisë. Më tej u prezantuan gjetjet kryesore duke vënë në pah trajnimet e bazuara në kompetenca, programet gjithëpërfshirëse me strukturë modulare, trajnimet e specializuara, metodologjinë e bazuar në raste si dhe trajnimi i trajnuesve.

### 5.3 Aktivitetet e realizuara me Këshillin e Evropës, zyra në Prishtinë

**Punëtori: Zhvillimi i kurrikulës së trajnimit të Trajnerëve (ToT) për gjyqtarë dhe prokurorë mbi dhunën në familje dhe dhunën ndaj grave** - Qëllimi i kësaj punëtorie ishte që të sigurohet që kurrikula e ToT të adresojë sfidat specifike me të cilat përballen gjyqtarët dhe prokurorët në zbatimin e ligjeve penale në Kosovë, sigurimin që metodologjia e propozuar e trajnimit të jetë efektive dhe të konceptohet drafti final lidhur me trajnimet në këtë fushë. Gjatë punëtorisë janë diskutuar çështje si: Raste nga Konventa e Stambollit, sfidat e trajnimit të rasteve me dhunë në familje, identifikimi i nevojave për trajnim në fushën kundër dhunës në familje/dhunës ndaj gruas, martesat e dhunshme, krimet e ashtuquajtura “Krimet të nderit” etj. Poashtu janë zhvilluar edhe punë praktike të ndara në grupe nga pjesëmarrësit. Pjesëmarrës në punëtori ishin gjyqtarë, prokurorë nga gjitha nivelet, përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë, zyrtarë ligjor nga gjykatat dhe prokuroritë si dhe nga zyra për mbrojtjen e viktimave.

**Punëtori - Dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje** - Në periudhën raportuese, në kuadër të kursit të vazhdueshëm HELP është realizuar punëtorja në platformën Zoom me temë “Dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje”. Qëllimi i punëtorisë ishte avancimi i njohurive profesionale të gjyqtarëve, prokurorëve, mbrojtësve të viktimave, avokatëve dhe zyrtarëve tjerë me çështjet që kanë të bëjnë me dhunën në familje dhe dhunën ndaj grave me qëllim të zbatimit konsekuentë të të gjitha akteve juridike të brendshme me theks të veçantë Konventës së Stambollit. Gjatë kësaj punëtorie janë diskutuar realizimi i Kursit online i cili është ndjekur nga gjyqtarë, prokurorë, mbrojtës të viktimave, zyrtar policor si dhe pjesëmarrës tjerë nga të gjitha regjionet e Kosovës. Ky kurs ka përfshirë 7 module të cilat në përmbajtje kanë trajtuar dhunën në familje dhe dhunën ndaj grave. Gjithashtu në fokus ishte dhuna në familje dhe implikimet e saj në të drejtat e njeriut duke bërë vështrime krahasimore edhe me aktgjykimet e Gjykatës Evropiane të Drejtave dhe të Lirive të Njeriut, të cilat kanë vënë bazat se si ndëshkohet një shtet nëse nuk ndërmerr masat e nevojshme për mbrojtjen e viktimës së dhunës në familje.

**Ceremonia e certifikimit të pjesëmarrësve në kursin HELP** - Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me zyrën e Këshillit të Evropës në Prishtinë kanë organizuar ceremoninë e certifikimit të pjesëmarrësve të cilët kanë përfunduar kursin me temë: Dhuna kundër grave, dhuna në familje përmes platformës së mësimin në distancë HELP. Për shkak të situatës me COVID-19, ceremonia e certifikimit u organizua vetëm me një numër të vogël të pjesëmarrësve nga Gjykata, Prokuroria dhe Shërbimi Policor i Kosovës duke i respektuar masat e parapara.

**Tryezë - Gazetarët dhe rreziqet e dhunës ndaj grave** - Tryeza e diskutimit është organizuar në kuadër të Projektit të Përbashkët të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës “Liria e shprehjes dhe liria e mediave (JUFREX 2)” dhe projektit “Përforcimi i luftës kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje - Faza II”. Një tematikë që u veçua ishte edhe Roli i Prokurorisë në hetimin e rasteve të sulmeve ndaj gazetarëve, masat e ndërmarra për krijimin e një sistemi për trajtimin e rasteve të sulmeve fizike dhe verbale kundër gazetarëve, dhe numri i rasteve me të cilat Prokuroria ka hetuar dhe është duke i hetuar aktualisht/sfidat në hetimin e rasteve.

Pjesëmarrës në këtë tryezë ishin gjyqtarë, prokurorë, gazetarë dhe përfaqësues tjerë nga mediat, zyrtarë të lartë nga Këshilli i Evropës zyra në Prishtinë, zyrtarë nga Projekti JUFREX, Avokat i Popullit, zëvendës ambasadorja nga, Ambasada Mbretërore Norvegjeze në Prishtinë. Në këtë tryezë , përfaqësuesi nga Akademia ishte nga radhët e trajnuesve gjyqësor të përhershëm.

**Konferenca e HELP – (Rrjeti E- KONFERENCA 2020), për shënimin e 70 vjetorit të KEDNJ-së në kohëra kritike, ne Strasburg të Francës -** Akademia e Drejtësisë me datën 08-09 korrik 2020 ka marrë pjesë në Konferencën e HELP që është organizuar si E- KONFERENCA 2020, për shënimin e “70 vjetorit të KEDNJ-së në kohëra kritike”, në të cilën kanë marr pjesë prokurorë dhe trajnues gjyqësor të Akademisë së Drejtësisë. Kjo konferencë është organizuar përmes programit të Këshillit të Evropës për arsimimin e të drejtave të njeriut për profesionistë ligjore – ne Strasbourg.

**Konferenca Rajonale online për trajnerë të certifikuar nga JUFREX në mesin e gjyqtarëve, prokurorëve dhe avokatëve -** Akademia e Drejtësisë me datën 08 tetor 2020 ka marr pjesë në Konferencën Rajonale online për trajnerë të certifikuar nga Projekti JUFREX – Kosovë, që janë gjyqtarë, prokurorë dhe avokatë – me temën boshte: Liria e shprehjes - zhvillimet më të fundit. Kjo konferencë kishte për qëllim të avancojë nivelin e njohurive dhe shkathësisë të këtij grupi ekzistues të trajnerëve të certifikuar për Lirinë e Shprehjes. Gjatë kësaj konference u diskutuan mjetet aktuale të trajnimit që janë zhvilluar nga JUFREX, Manuali për Lirinë e Shprehjes për Trajnerët, kurset online të arsimit për të drejtat e njeriut për profesionistët e juridikut (HELP) për temën Liria e Shprehjes dhe Siguria e Gazetarëve, dhe e fundit, por jo nga rëndësia, zhvillimet e fundit në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut për lirinë e shprehjes.

**Konferenca rajonale online "Mbrojtja e pronës-GJEDNJ dhe jurisprudenca kombëtare në Ballkanin Perëndimor" -** Akademia e Drejtësisë me datën 09 dhjetor 2020 ka marrë pjesë në Konferencën rajonale në internet me temë: "Mbrojtja e pronës-GJEDNJ dhe praktika gjyqësore kombëtare në Ballkanin Perëndimor". Qëllimi i kësaj konference ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve lidhur me të drejtën e respektimit të pronës dhe mbrojtjes së saj konform standardeve që përmban Neni 1 i Protokollit 1. të KEDNJ dhe roli i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) në Strasburg si dhe jurisprudenca kombëtare në Ballkanin Perëndimor. Kjo konferencë u organizua me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës në kuadrin e Programit të Përbashkët “Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë 2019-2022”.

#### 5.4 Aktivitetet e realizuara me zyrën e Bashkimit Evropian dhe projektet e saj

**Punëtori - Ndihma e ndërsjellë juridike e Kosovës me vendet jo njohëse -** Në bashkëpunim me Zyrën e Bashkimit Evropian në Kosovë / EUO in Kosovo / EUSR, është realizuar punëtorja me temë “Ndihma e ndërsjellë juridike e Kosovës me vendet jo-njohëse”. Qëllimi i kësaj punëtorie ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve në fushën e ndihmës së ndërsjellë juridike me vendet jo njohëse si dhe rolin e Bashkimit Evropian në ndihmën e ndërsjellë juridike, mënyrën e hartimit të kërkesave për ndihmë juridike si dhe procedurat nëpër të cilat kalon ajo kërkesë gjatë analizimit të saj. Në këtë punëtori është diskutuar për rolin e BE-së në ndihmën e ndërsjellë juridike me vendet që nuk e njohin Kosovën, sistemin e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar me vendet jo-njohëse, bazën ligjore që EUO/EUSR ka në mënyrë që të jetë urë lidhëse për bashkëpunim juridike ndërkombëtar me vendet jo-njohëse. Njëkohësisht u diskutuan edhe sfidat nëpër të cilat kalojnë institucionet gjegjëse sa i përket ndihmës së



ndërsjellë juridike me vendet që nuk e kanë njohur Republikën e Kosovës. Poashtu, gjithanshëm u trajtuan dhe u analizuan problemet aktuale në praktikë, duke njohur dhe kuptuar më mirë rolin e Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë. Përfitues të kësaj punëtorie ishin gjyqtarë, prokurorë, zyrtar nga Ministria e Punëve të Jashtme si dhe zyrtar nga Ministria e Drejtësisë.

**Projekti Kodit Civil-faza e II e mbeshetur nga zyra e BE - Takimi me ekspertët e angazhuar nga projekti-** Në periudhën raportuese, Akademia e Drejtësisë ka realizuar takim me ekspertët e angazhuar nga projekti i financuar nga BE - Mbështetje e Kodit Civil-faza II, z. Haxhi Gashi, njëkohësisht Dekan i Fakultetit Juridik në Universitetin e Prishtinës dhe z. Bashkim Preteni, profesor në këtë Universitet në të cilin janë diskutuar përfshirja e një pako të trajnimeve të cilat përfshijnë ndryshimet legjislative të Kodit Civil të Republikës së Kosovës. Me rastin e këtij takimi është pajtuar që në kurrikulën trajnuese të trajnimeve të vazhdueshme të përfshihen 6 sesione trajnuese me 8 ditë trajnimi në të cilat do të trajtohen institute të ndryshme me theks të veçantë tek çështjet pronësore, familjare, trashëgimore dhe detyrimore.

**Projekti Kodit Civil-faza e II e mbëshetur nga zyra e BE – Tryezë harmonizimi i vendimeve të gjykatave në çështje civile përkatësisht në çështje trashëgimore dhe detyrimore -** Në bashkëpunim me projektin e BE-së “Mbështetje Kodit Civil Faza 2” ka realizuar tri (3) tryeza me temë “Harmonizimi i vendimeve të gjykatave në çështje civile”. Qëllimi i këtyre tryezave ishte harmonizimi dhe unifikimi i vendimeve të gjykatave në çështje civile përkatësisht në çështje trashëgimore dhe detyrimore. Gjatë këtyre tryezave janë trajtuar risitë e Kodit Civil në librin e parë (pjesa e përgjithshme) si dhe Krijimi dhe harmonizimi i rregullave të përgjithshme në Kodin Civil. Gjyqtarët gjatë tryezave patën rastin e diskutimeve dhe komentimit të vendimeve gjyqësore të cilat janë paraqitur në praktikë dhe në këtë mënyrë të zbërthejnë dispozitat ligjore të cilat janë risi nga Kodi Civil i Republikës së Kosovës. Gjithashtu u komentuan vendime të shumta gjyqësore për rastet e trashëgimisë, për të cilat u vunë në pah çështjet më sfiduese në këto raste me theks të evidentimi i pasurisë trashëgimore sipas Kodit Civil, trashëgimtarët e domosdoshëm dhe ndarja e pasurisë së trashëgimisë në raste kontesti sipas Kodit Civil. Në çështjet detyrimore tryeza u fokusua në marrëdhëniet e detyrimeve, kontratat e pavlefshme dhe kompensimi i dëmit. Në këto tryeza morën pjesë gjyqtarë nga të gjitha regionet e Kosovës.

**Fillimi i projektit EUKOJUST/ Programi i Sektorit të Drejtësisë të Bashkimit Evropian/Kosovës “EUKOJUST”-** Në periudhën raportuese, Akademia e Drejtësisë, ka pritur në takim z. Volkmar Theobald, Drejtuesi i ekipit të projektit, z. Cristian Nicoara, Ekspert afatgjatë në fushën e Drejtësi Penale dhe z. Dragomir Yordanov, Ekspert afatgjatë për Trajnim dhe Ndërtim të Kapaciteteve Institucionale nga Programi i Sektorit të Drejtësisë të Bashkimit Evropian/Kosovës “EUKOJUST”. Përfaqësuesit e këtij projekti, njoftuan Akademinë e Drejtësisë rreth implementimit të Projektit nga i cili do të sigurojnë përfitim maksimal për të gjithë akterët në Kosovë, mënyrën e veprimit për tri vitet e ardhshme të zbatimit të projektit si dhe konfirmuan edhe njëherë, se do të kenë një bashkëkoordinim në mbarëvajtjen e aktiviteteve duke synuar reformimin e mëtejshëm të sistemit të drejtësisë së Kosovës në përputhje me standardet evropiane dhe ndërkombëtare.

**Projekti i Bankës Botërore – Punëtori - Angazhimi i fëmijëve në forma të rënda të punës dhe punë të detyruara-** Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me ILO - Organizatën Ndërkombëtare të Punës, ka realizuar dy (2) punëtori përmes platformës Zoom me temë “Angazhimi i fëmijëve në forma të rënda të punës dhe punë të detyruara”. Qëllimi i këtyre punëtorive ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve dhe prokurorëve për të mitur për angazhimin e fëmijëve në forma të rënda të punës dhe punë të detyruara dhe zbatimi i drejtë i dispozitave gjyqësore në rastet e tilla. Me rastin e këtyre punëtorive janë elaboruar format e ndryshme të angazhimit të punëve

të rënda

të fëmijëve dhe njëkohësisht korniza ligjore vendore dhe ndërkombëtare që i sanksionojnë veprat e tilla me theks të veçantë Konventa për të Drejtat e Fëmijëve e gjithashtu edhe sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës e cila i ka të integruara instrumentet ndërkombëtare që garantojnë mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Gjatë punëtorive u trajtuan çështjet si: Çfarë është puna e rëndë e fëmijëve?, a i ndalohet fëmijës që të punoj?, çka ndikon dhe sa është e përhapur keqpërdorimi i punës së fëmijës?, si përkufizohet puna e lehtë e fëmijëve? si dhe u analizuan raste nga praktika duke i adresuar gjitha çështjet më sfiduese në zgjidhjen e rasteve ligjore. Pjesëmarrës në këto punëtori ishin: Gjyqtarët dhe prokurorët nga Departamenti për të mitur.

### **5.6 Aktivitetet e realizuara me projektin “Forcimi i Sistemit të Drejtësisë në Kosovë” të financuar nga Ambasada Britaneze**

Në periudhën raportuese, Akademia e Drejtësisë ka realizuar aktivitete me projektin e Ambasadës Britaneze “Forcimi i Sistemit të Drejtësisë në Kosovë”. Këtyre aktiviteteve iu kanë parapri një varg takimesh me qëllim të koordinimit dhe bashkërendimit të trajnimit të trajnuesve me temë: “Analizë Praktike e rasteve dhe Avokimit në Gjykim”.

### **5.7 Aktivitetet e realizuara me Shkollën e Magjistraturës së Francës ENM të mbështetur nga Ambasada Franceze**

Në kuadër të Marrëveshjes së Bashkëpunimit në mes të Akademisë së Drejtësisë dhe Shkollës Kombëtare të Magjistraturës së Francës – ENM, prej datës 03 janar deri me 13 mars 2020, dy kandidatë të kësaj shkolle kanë qëndruar në Kosovë në një program praktik të trajnimit. Në kuadër të kësaj vizite, kandidatet e ENM-së ndoqën një seancë trajnimi në Programin Fillestar për prokurorët e sapoemëruar (gjenerata e VIII) më pastaj sipas agjendës kanë vazhduar me programin praktik në gjykatat dhe prokuroritë themelore të Prishtinës. Kjo është gjenerata e gjashtë me radhë e kandidatëve të Shkollës Kombëtare të Magjistraturës së Francës të cilët realizojnë këtë program. Për shkak të gjendjes së krijuar nga pandemia COVID 19, programi nuk është përbushë në tërësi sipas planifikimit.

### **5.8 Aktivitetet e realizuara me Akademinë e Drejtësisë së Republikës së Turqisë dhe KE**

Akademia e Drejtësisë së Kosovës me ftesë të Ambasadës së Turqisë ka marrë pjesë në punëtorinë për zhvillimin e Programit Fillestarë dhe Programit të Vazhdueshëm për gjyqtarë dhe prokurorë pas pandemisë COVID-19. Ky takim dy ditor, i cili është mbajtur në formë virtuale, u organizua nga Ambasada e Turqisë në bashkëpunim me projektin “Procesi i Bashkëpunimit të Evropës Jug-Lindore” (SEECF). Qëllimi i kësaj punëtorie ishte bashkëpunimi mes Institucioneve të trajnimit gjyqësor dhe diskutimi i temave të përbashkëta relevante në zhvillimin e mëtutjeshëm të programeve trajnuese pas situatës së krijuar nga pandemia Covid-19.

### **5.9 Aktivitetet e realizuara me UNDP**

Gjatë vitit 2020, Akademia e Drejtësisë ka realizuar 4 takime virtuale përmes platformës ZOOM me përfaqësues nga UNDP si dhe fokus grupet me gjyqtarë, prokurorë, zyrtarë për barazi gjnore, zyrtarë për të drejtat e njeriut nga institucione të ndryshme duke përfshirë edhe zyrtarë nga institucioni i Avokatit të Popullit. Qëllimi i këyre takimeve ishte vlerësimi i nevojave trajnuese në fushën e anti diskriminimit dhe zhvillimi i kuurikulës trajnuese, program ky që do të mbështetet nga projekti i UNDP-së. Me rastin e këtyre takimeve është trajtuar dokumenti i analizës dhe gjendjes aktuale sa i përket kornizës ligjore vendore që përfshinë anti diskriminimin duke filluar nga Kushtetuta e Kosovës, Gjykata kushtetuese, Ligji për diskriminimin, pastaj në aspektin ndërkombëtar

Direktivat e BE-së, Konventa Evropiane për Liritë dhe të Drejtat e Njeriut, pastaj edhe mekanizmat tjerë vendorë që janë krijuar në mbrojtje nga diskriminimi me theks të veçantë Ombudspersoni dhe Agjencia për Barazi Gjinore.

**Pastrimi i parave me ekspertë të sektorit publik dhe privat të Italisë** - Me 17 dhe 18 qershor 2020, Akademia e Drejtësisë dhe Zyra e UNDP-së në Kosovë përmes Projektit të SAEK II ka facilituar pjesëmarrjen e gjyqtarëve dhe prokurorëve të Kosovës në Webinarin mbi Pastrimin e parave me ekspertë të sektorit publik dhe privat të Italisë. Qëllimi i këtij aktiviteti ishte ngritja e kapaciteteve profesionale e gjyqtarëve dhe prokurorëve të Kosovës në hetimin dhe trajtimin e rasteve që kanë të bëjnë me pastrimin e parave.

#### 5.10. Aktivitetet e realizuara me TAIEX dhe EUROJUST

Akademia e drejtësisë mori pjesë në Videokonferencën e organizuar nga TAIEX në bashkëpunim me EUROJUST lidhur me themelimin e bashkëpunimit Eurojust-Kosovë. Qëllimi i kësaj videokonference ishte bashkëpunimi me Eurojust dhe themelimi i kontakteve fillestare mes EUMS, Eurojust dhe autoriteteve të Kosovës. Kosova në këtë Konferencë u prezantua nga spektër i gjerë i akterëve të sistemit të drejtësisë si dhe nga institucionet përgjegjëse për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar. Në kuadër të kësaj konference u trajtuan tema të ndryshme siç janë Bashkëpunimi Juridik ndërkombëtar, Shpëlarja e parave, Krimi kibernetik dhe Terrorizmi.

#### 5.11 Aktivitetet e realizuara me Rrjetinë e Institucioneve të Trajnimit Gjyqësor të Evropës Juglindore

Gjatë vitit 2020, Akademia e Drejtësisë së Kosovës ka marrë pjesë në takimin e katërt të Rrjetit të Institucioneve të Trajnimit Gjyqësor (SEE JTI). Fokusi specifik i takimit ishte shkëmbimi i përvojave nga shumë këndvështrime dhe zgjidhje të mësimin në distancë nga secili pjesëmarrës i rrjetit. Temat rreth të cilave u diskutua dhe u ndanë përvojat nga pjesëmarrësit ishin lidhur me praktikën më të mira të mësimin në distancë dhe mjetet në dispozicion për realizimin e mësimin në distancë nga të gjitha institucionet e trajnimit gjyqësor.

#### 5.12 Akademia e Drejtësisë merr pjesë në ndarjen e çmimeve për praktikën më të mirë në zbatimin e Ligjit për përdorimin e gjuhëve

Për periudhën raportuese, Akademia e Drejtësisë ka marrë pjesë në ceremoninë për ndarjen e çmimeve “Praktika më e mirë në zbatimin e Ligjit për përdorimin e gjuhëve”, që u organizua në formë të uebinarit nga Zyra e Komisionerit për gjuhët (ZKGJ) në bashkëpunim me Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Misioni në Kosovë (OSBE). Në mesin e institucioneve që kanë treguar performancë të mirë në zbatimin e ligjit për gjuhët zyrtare radhitet edhe Akademia e Drejtësisë. Ndarja e çmimit është bërë në bazë të monitorimit të përdorimit të gjuhëve zyrtare në ueb faqet zyrtare të ministrive, organeve ekzekutive dhe agjencive duke përfshirë edhe rrjetet sociale të institucioneve përkatëse.

#### 5.13 Programi për praktikantë

Në periudhën raportuese, Akademia e Drejtësisë nuk ka pasur praktikantë studentë nga institucionet e arsimit të lartë në Kosovë, program ky i cili zbatohet si vazhdimësi e bashkëpunimit me këto institucione. Kjo vjen si rezultat i pandemisë COVID 19 dhe pamundësisë së shtimit të numrit të stafit meqë edhe stafi i Akademisë, një pjesë e tyre ka punuar nga shtëpitë. Ndërkaq nga projektet me donatorë kanë vijuar programin e praktikës vetëm tre (3) praktikantë. Këta praktikantë janë mbështetur nga projektet si Checchi&Company consulting - Projekti i

USAID për Drejtësinë Komerciale, dy (2) praktikantë si dhe një (1) nga projekti i GIZ/ LARP. Dy nga këta praktikantë e kanë përfunduar me sukses programin e praktikës, ndërkaq një praktikantë meqë ka filluar nga muaji dhjetor 2020 do të përfundoj në qershor të vitit 2021. Gjatë periudhës së praktikës, praktikantët patën mundësi të mësojnë për së afërmi për veprimtarinë e Akademisë, funksionimin e sistemit gjyqësor dhe prokurorial me fokus në pjesën e arsimimit ligjor, të përfitojnë nga pjesëmarrja në trajnimet e Akademisë, si dhe të ndihmojnë në përgatitjen e trajnimeve të ndryshme si dhe hartimin e raporteve për aktivitetet e organizuara nga Akademia e Drejtësisë.

## VIII. Administrata dhe Financat

Departamenti për Administratë dhe Financa (më tej DAF) është në funksion të zbatimit të programeve trajnuese dhe ofrimit të burimeve dhe materialeve tjera ligjore për përfituesit e AD-së sipas ligjit. Në kuadër të këtij departamenti përfshihet teknologjia informative, burimet njerëzore, financat, prokurimi, përkthimi dhe logjistika. Përgjegjësit kryesore të këtij departamenti janë të përcaktuara me rregulloren për organizim të brendshëm dhe janë si në vijim:

- Përcaktimin e politikave dhe objektivave për zhvillimin dhe zbatimin e procedurave standarde në lidhje me buxhetin dhe financat, burimet njerëzore, prokurimin, teknologjinë informative, logjistikën dhe arkivin e Akademisë;
- Menaxhimin dhe koordinimin e procesit për ofrimin e shërbimeve administrative dhe financiare që kanë të bëjnë me funksionet dhe aktivitetet e Akademisë;
- Zhvillimin e një administrate profesionale, efikase, funksionale për ofrimin e shërbimeve administrative, në përputhje me nevojat dhe specifikat e Akademisë;
- Planifikimin, hartimin, raportimin, mbikëqyrjen dhe menaxhimin e buxhetit dhe financave të Akademisë;
- Zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve që rregullojnë kompetencat e departamentit;
- Planifikimin, koordinimin dhe menaxhimin e aktiviteteve të prokurimit në Akademi në pajtueshmëri të plotë me legjislacionin në fuqi;
- Propozimin e akteve normative për funksionimin e departamentit;
- Planifikimin, mbikëqyrjen dhe administrimin me pajisjet e teknologjisë informative, programet softuerike dhe sistemet e rrjetit telekomunikues, të cilat janë pronë e Akademisë;
- Planifikimin, mbikëqyrjen dhe menaxhimin me pasurinë e Akademisë;
- Ofrimin e shërbimeve logjistike ku përfshihet furnizimi me mallra, shërbimet e transportit, mirëmbajtja e objektit dhe arkivi i Akademisë;
- Bashkëpunim dhe koordinim me institucionet relevante për zbatimin e legjislacionit në kuadër të funksioneve të departamentit.

### 6.1 Burimet Njerëzore në Akademinë e Drejtësisë

Të punësuarit (27) në Akademinë e Drejtësisë janë shërbyes civil dhe i nënshtrohen ligjeve dhe rregullave për shërbimin civil në Kosovë. Në pajtim me këto rregulla të punësuarit janë në marrëdhënie pune me akt emërim prej kur ka filluar të zbatohet ky sistem. Stafit i Akademisë së Drejtësisë paraqesin resursin më të rëndësishëm të cilët janë të angazhuar në zbatimin e programeve trajnuese për gjyqtarë, prokurorë dhe profesionistë tjerë ligjor, në analiza hulumtime dhe veprimtari botuese si dhe me shërbime tjera të cilat janë në funksion të zbatimit të plotë të mandatit ligjor të Akademisë së Drejtësisë.

Numri i aprovuar i stafit me buxhetin e vitit 2020, ka qenë 32 pozita, ndërsa numri i stafit në fund të vitit ka qenë 27 zyrtarë. Gjatë vitit 2020 dy zyrtarë janë larguar nga AD. Në periudhën raportuese nuk është zhvilluar asnjë procedurë e rekrutimit për pozitat e lira për shkak të ndryshimeve ligjore që kanë ndodhur gjatë vitit 2020.

Në funksion të zhvillimit të kapaciteteve të stafit, gjatë vitit 2020, në kuadër të IKAP kanë marrë pjesë në trajnime stafi administrativ i Akademisë për të cilat është përgatitur plani i trajnimeve, plani individual i punës nga të gjithë nëpunësit si dhe vlerësimi vjetor për arritjen e objektivave të punës.

Mirëmbajtja e dosjeve fizike dhe elektronike e personelit ka qenë poashtu fokusi i Akademisë së Drejtësisë duke përfshirë edhe hartimin e dokumenteve dhe raporteve të ndryshme për burimet njerëzore.

### 6.2 Nevojat për staf shtesë dhe ngritja e kapaciteteve profesionale të stafit të Akademisë së Drejtësisë

Me qëllim të zbatimit të mandatit ligjor të Akademisë dhe zbatimit të legjislacionit në fuqi, gjatë planifikimit buxhetor për vitin 2021-2023 është bërë kërkesë për plotësimin e disa pozitave të nevojshme.

#### Njëmbëdhjetë (11) pozitat e kërkuara për vitin 2021 janë:

- **Zyrtar (1) për Marrëdhënie me Publikun:** Mungesa e stafit profesional në marrëdhënie me publikun, ka rezultuar me prezantim jo të mjaftueshëm të punës së Akademisë, si ne opinionin e brendshëm po ashtu edhe të jashtëm. Numri i madh i trajnimeve, asistencë dhe partneriteti me shumë organizata si vendore ashtu edhe ndërkombëtare, kërkesat e shumta nga komuniteti ligjor në vendin tone, por edhe bashkëpunimi i vazhdueshëm me Institucionet Ndërkombëtare të Trajnimeve, paraqesin Akademinë e Drejtësisë në një pozitë të vështirë në lidhje me plasimin informatave dhe mirëmbajtjen e komunikimit. Të kujtojmë se, komunikimi me opinionin e gjerë do të ndikojë jashtëzakonisht shumë në ngritjen e besimit të publikut në institucionet e drejtësisë, e posaçërisht për AD, si një institucion profesional dhe i pavarur i mandatur për ngritjen e kapaciteteve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të Kosovës.
- **Një (1) Udhëheqës për trajnime të stafit administrativ** - Programi për trajnimin e stafit administrativ të gjykatave dhe prokurorive është nevojë e shprehur e sistemit gjyqësor dhe prokurorial dhe obligim i përcaktuar me ligjin për Akademinë e Drejtësisë. Duke marr parasysh numrin e madh të stafit mbështetës dhe atyre administrativ të sistemit gjyqësor dhe prokurorial, që kalon numrin prej 1500 pjesëmarrësve potencial, Akademia e ka të pamundur zbatimin e këtij programi për gjithë stafin mbështetës dhe atyre administrativ pa nëpunës përgjegjës për realizimin e programit të kërkuar sipas ligjit.

- **Dy (2) Zyrtarë të trajnimeve** – AD ka disa programe trajnuese që ju dedikohen përfituesve të ndryshëm dhe këto programe kanë nevojë për personel shtesë profesional, për identifikim të nevojave dhe hartim të programeve adekuate, pasi që me ligjin për buxhetin e vitit 2020, AD-së i është zvogëluar stafi për dy pozita, një pozitë që ka qenë e përhershme dhe një pozitë që ka qenë e parashikuar në buxhetin e vitit 2020.
- **Tre (3) Zyrtarë për publikime dhe hulumtime** - në kuadër të funksioneve ligjore të Akademisë është edhe Programi për Hulumtime dhe Publikime i cili për dallim nga programet tjera ende nuk ka arritur plotësisht objektivat e caktuara në veçanti në pjesën e hulumtimeve ngase momentalisht është vetëm, me një zyrtar. Nevoja për hulumtime ngërthen në vete një mori të aktiviteteve, sikurse monitorimi i raporteve të ndryshme në lidhje me zbatueshmërinë e legjislacionit, përcjellja e vazhdueshme e risive legislative, monitorimi i praktikës gjyqësore si vendore ashtu edhe ndërkombëtare, zhvillimi dhe ndërmarrja e aktiviteteve në vlerësimin e nevojave për trajnime, duke u bazuar në praktikën më të mirë të Rrjetit Evropian të Institucioneve Trajnuese për gjyqtar dhe prokurorë dhe profesionist tjerë ligjore (EJTN, CIPOL, etj.), dhe duke shtuar edhe kompleksitetin e kuadrit ligjor të zbatueshëm në vendin tonë dhe lëmit që mbulojnë (Penale, Civile, Administrative, Kushtetuese, Kundërvajtje, Konventat e ndryshme ndërkombëtare), mbështetja edhe me 3 zyrtarë do të kishte ndikim të drejtpërdrejtë në ofrimin e burimeve ligjore dhe hulumtimeve për zhvillim të kapaciteteve jo vetëm të sistemit gjyqësorë dhe prokurorial, por edhe tek i gjithë sistemi i drejtësisë në Kosovë.
- **Një (1) Zyrtar për shpenzime** – mungesa e zyrtarit shpenzues vështirëson punën në kryerjen e shërbimeve financiare. Kjo pozitë është nga delegimi i shpenzime në organizatat buxhetore ushtrohet nga zyrtar të Akademisë si punë shtesë.
- **Një (1) zyrtar për mësim në distancë (e-learning)** – me qëllim të mbështetjes së realizimit të trajnimeve nga distanca (e-mësimi) si një ndër format më të reja të trajnimeve të zhvilluara nga Akademia, nevojitet staf me njohuri në teknologji informative dhe njohuri në fushën juridike.
- **Dy (2) zyrtar ligjor** – Akademia e Drejtësisë nuk ka asnjë zyrtar ligjor dhe për pasojë shumë çështje ligjore me të cilat ballafaqohet Akademia nuk ka kush t’i trajtojë gjë e cila mund të shpije edhe te marrja e situatave kur mund të vihet në pikëpyetje zbatimi i drejtë i legjislacionit në fuqi. Mbështetja e këshillit Drejtues, Këshillit Programore, e komisioneve të AD-së, si dhe zyrës së Drejtorit Ekzekutiv, me 2 zyrtarë ligjor është më shumë se vetëm një nevojë, pra një institucion sikurse AD pa zyrtar ligjorë është e pa imagjinueshme.

Trajnimet janë një aspekt i rëndësishëm për zhvillimin profesional të çdo zyrtari publik prandaj edhe për stafin e Akademisë së Drejtësisë janë të domosdoshme trajnimet adekuate me funksionin dhe detyrat e punës. Në funksion të kësaj, Akademia e Drejtësisë ka qenë bashkëpunuese me IKAP si dhe me institucione tjera megjithatë pandemia COVID 19 ka ndikuar që trajnimet të jenë më të pakta në krahasim me vitet paraprake.

Në vijim në formë tabelare janë paraqitur trajnimet dhe numri i tyre, në të cilat pjesëmarrës kanë qenë stafi administrativ i Akademisë për vitin 2020.

Lloji i trajnimit	Numri i trajnimit
Kodi Etik, të drejtat dhe përgjegjësitë në Shërbimin Civil	1
Planifikimi, menaxhimi dhe zhvillimi i Burimeve Njerëzore	1
Sjelljet etike dhe vështrimi i përgjithshëm sa i përket ligjit për mbrojtjen e sinjalizuesve	29
Trajnim për protokollin dhe diplomacinë	2

Tabela nr. 4. Trajnimet e stafit 2020

Bazuar në nevojat dhe kërkesat e drejtpërdrejta të nëpunësve dhe vlerësimit vjetor të punës së tyre është bërë plani i trajnimit edhe për vitin 2021. Realizimi i planit vjetor të trajnimit kryesisht varet nga programet trajnuese të IKAP-it dhe mundësive buxhetore të Akademisë për të siguruar pjesëmarrjen e stafit në trajnime sipas kërkesave për trajnim. Për vitin 2021, IKAP ka praktikuar aplikimin online për trajnime të shërbyesve civil andaj edhe varësisht nga aplikimet dhe nevojat e shfaqura të stafit do të ofrohet mundësa për vijimin e tyre në trajnime.

### 6.3 Asetet e Akademisë së Drejtësisë

Akademia mbanë në mënyrë të rregullt regjistrat e pasurisë. Regjistrimi i aseteve/pasurisë jo financiare përveç në sistemin E-pasuri dhe SIMFK-së, bëhet edhe në bazën e brendshme të të dhënave të AD-së varësisht nga blerjet e aseteve brenda vitit.

Në kuadër të regjistratit të aseteve përfshihen pasuritë mbi 1,000 euro dhe pasuritë nën 1,000 euro. Në kuadër të regjistratit të pasurive mbi 1,000 euro janë të regjistruara automjetet, fotokopjet, pajisjet e teknologjisë informative dhe pajisjet e zërimit në vlerën neto prej 14,136.31 Euro.

Ndërsa, pasuritë nën vlerën 1,000 euro kanë të bëjnë me pasuritë që kanë jetëgjatësi më shumë se një vit dhe përfshijnë kryesisht pajisje të teknologjisë informative, mobilie dhe inventar të ndryshëm, librat e bibliotekës etj. Pasuritë jo financiare të Akademisë janë të gjitha pasuritë jo kapitale të regjistruara në E-pasuri. Në vlerën totale të pajisjeve përfshihet vlera e pajisjeve që disponon Akademia me 31 dhjetor 2021, vlera neto e aseteve nën 1,000 euro është 82,533.69 euro, ndërsa në raport të e-pasurisë për shkak të problemeve teknike që ka ky sistem edhe pse janë të regjistruar në e-pasuri, nuk është e përfshirë vlera prej 5,900.80 euro e mobileve dhe pajisjeve që janë blerë gjatë vitit 2020.

#### 6.3.1 Planifikimi për asete të reja dhe ndërtesën e Akademisë

Një ndër kërkesat më me rëndësi për këtë vit është edhe ndërtesa e Akademisë. Akademia që nga Dhjetori i vitit 2006 është e vendosur në një ndërtesë për të cilin është detyruar të paguaj qira, në mënyrë që të vazhdojë realizimin e funksioneve ligjore.

Hapësirat e ndërtesës së Akademisë, ku është tani janë rreth 1,224.84 m<sup>2</sup>. Zbatimit i të gjitha programeve trajnuese, nevojat në rritje për trajnime të specializuara, nevojat për gjithëpërfshirje në trajnime, trajnimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve fillestar, trajnimi i profesionistëve tjerë të përcaktuar me ligj, krijimi i njësisë për hulumtime dhe bibliotekës, organizimi i konferencave dhe aktiviteteve tjera të ndryshme ka ndikuar që nevoja për hapësira të rritet.

Në viti

2019 Akademia e Drejtësisë ka nënshkruar memorandumin e mirëkuptimit me Ministrinë e Administratës Publike për ndërtimin e objektit të AD-së. Janë zhvilluar procedurat e tenderimit dhe ka filluar ndërtimi i objektit të Akademisë. Janë duke vazhduar punimet në ndërtimin e objektit të AD-së, ku është filluar në korrik të 2019 dhe siç parashihet në kontratë punimet duhet të përfundohen brenda 36 muajve (korrik 2022).

#### 6.4 Shërbimet e përgjithshme

Në kuadër të shërbimeve të përgjithshme bëjnë pjesë shërbimet administrative logjistike, të personelit, të teknologjisë informative dhe shërbimet tjera.

Në periudhën raportuese janë realizuar aktivitetet si në vijim:

- Në aspektin administrativ, teknik dhe të logjistikës janë mbështetur të gjitha aktivitetet e organizuar nga AD;
- Varësisht nga aktivitetet trajnuese është bërë arkivimi i materialit trajnues për qëllime studimi;
- Është përfunduar auditimi nga ZKA për vitin 2019 dhe është publikuar raporti i auditimit.
- Është përgatitur plani për zbatimin e rekomandimeve të dala nga raporti i auditimit të pasqyrave financiare 2020;
- Janë duke vazhduar punimet në ndërtimin e objektit të AD-së, ku është filluar në korrik të 2019 dhe siç parashihet në kontratë punimet duhet të përfundohen brenda 36 muajve (korrik 2022).

#### Teknologjia informative:

- Mirëmbajtja dhe administrim i vazhdueshëm i pajisjeve të teknologjisë informative si kompjuterë, llaptop, server dhe pajisje tjera;
- Mirëmbajtja dhe administrimi i vazhdueshëm për programet aplikative që AD ka në përdorim;
- Është mbështetur vazhdimisht stafi në procese të punës me çështjet që kanë të bëjnë me teknologji informative;
- Për shkak të gjendjes së pandemisë, këtë vit Akademia e Drejtësisë trajnimet i ka zhvilluar përmes platformave të mësimin online ILIAS dhe Zoom.
- Platforma e mësimin në distancë ILIAS është bërë update në versionin më të ri.

#### Prokurimi:

- Është hartuar plani final i prokurimit Janar - Dhjetor 2020;
- Gjatë kësaj periudhe janë ekzekutuar urdhërblertje për shërbime dhe furnizime të ndryshme;
- Sipas ndryshimeve ligjore në fushën e prokurimit, AD si institucion me më pak se 50 nëpunës nuk ka të drejtë të zhvilloj procedura të prokurimit, kompetencë kjo që është bartur tek AQP;

#### Aktivitetet e prokurimit të dërguara në AQP:

- Furnizim me ushqim të gatshëm dhe pije për pjesëmarrësit në trajnime në Akademinë e Drejtësisë;
- Shërbime të shtypit-botime dhe publikime;
- Akomodim, ushqim dhe pije për pjesëmarrësit në trajnime në Regjionin e Pejës;



- Akomodim, ushqim dhe pije për pjesëmarrësit në trajnime në Regjionin e Mitrovicës;
- Akomodim, ushqim dhe pije për pjesëmarrësit në trajnime në Regjionin e Prishtinës;
- Akomodim, ushqim dhe pije për pjesëmarrësit në trajnime në Regjionin e Prizrenit;
- Mirëmbajtje e ndërtesës dhe dezinfektim, dezinfektim dhe deratizim;
- Mirëmbajtja dhe servisimi i klimave;
- Shpallje e konkurseve në gazetata ditore;
- Servisimi i veturave;
- Larja e veturave;
- Servisimi dhe mirëmbajtja e gjeneratorit;
- Servisimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve të IT.
- Sigurimi fizik i objektit;
- Qasja dhe shfrytëzimi në platformën zoom për video komunikim;
- Furnizim me material higjenik-maskë, doreza, dezinfektues;
- Shërbime të përkthimit.

Aktivitetet të prokurimit të realizuara:

- Furnizim me ushqim të gatshëm dhe pije për pjesëmarrësit në trajnime në Akademinë e Drejtësisë;
- Shërbime të shtypit – botime dhe publikime;
- Akomodim, ushqim dhe pije për pjesëmarrësit në trajnime në Regjionin e Prizrenit;
- Mirëmbajtje e ndërtesës dhe dezinfektim, dezinfektim dhe deratizim;
- Mirëmbajtja dhe servisimi i klimave;
- Shpallje e konkurseve në gazetata ditore;
- Larja e veturave;
- Sigurimi fizik i objektit;
- Qasja dhe shfrytëzimi në platformën zoom për video komunikim;
- Furnizim me material higjenik-maskë, doreza, dezinfektues;
- Shërbime të përkthimit.

### 6.5 Financat, buxheti dhe shpenzimet në Akademinë e Drejtësisë

Në kuadër të financave gjatë viti 2020, janë realizuar punë si në vijim:

- Janë përgatitur pasqyrat vjetore financiare për vitin 2019;
- Është raportuar në Komisionin për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit të Kuvendit dhe në Komisionin për buxhet dhe Financa;
- Është përgatitur pyetësi për vetëvlerësim për vitin 2019;
- Është përgatitur rrjedha e parasë së gatshme për vitin 2020;
- Është përgatitur Korniza Afatmesme e Shpenzimeve dhe Buxheti për periudhën 2021-2023;
- Janë bërë barazimet periodike të shpenzimeve me thesar;
- Janë përgatitur raporte të ndryshme periodike financiare;

- Të gjitha shpenzimet e proceduara për këtë periudhë janë regjistruar në databazën e brendshme të financave dhe në SIMFK.

Shpenzimet e krijuara gjatë kësaj periudhe janë mbuluar nga Buxheti i Republikës së Kosovës si burim kryesor financiar si dhe nga mbështetja e granteve të donatorëve.

Shpenzimet e buxhetit përfshihen në këto kategori kryesore ekonomike: pagat dhe mëditjet, mallrat dhe shërbimet, shpenzimet komunale. Tabela në vijim pasqyron buxhetin fillestar dhe buxhetin përfundimtar për vitin 2020, duke përfshirë kategoritë ekonomike.

### Buxheti dhe shpenzimet 2020

Përshkrimi	Buxheti Fillestar	Reduktimet dhe Kursimet Buxhetore	Buxheti Përfundimtar	Shpenzimet 2020
Pagat dhe Mëditjet	261,944.00	(42,905.92)	219,038.08	219,038.08
Mallrat dhe Shërbimet	655,880.00	(363,084.16)	292,795.84	222,670.83
Shpenzimet Komunale	16,500.00	(8,430.66)	8,069.34	6,948.87
Kapitale	30,000.00	(30,000.00)	-	-
Donacionet	-	-	15,277.80	5,809.30
<b>Totali</b>	<b>964,324.00</b>	<b>(444,420.74)</b>	<b>535,181.06</b>	<b>454,467.08</b>

Tabela nr. 4. Raporti i Buxhetit për vitin 2020

Me Ligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, buxheti fillestar për këtë vit ka qenë 964,324 euro, për të gjitha kategoritë ekonomike përfshirë këtu pagat dhe mëditje, mallrat dhe shërbimet, shpenzime komunale dhe shpenzime kapitale.

Totali i donacioneve të realizuara për vitin 2020 ka qenë 15,277.80 euro, nga GIZ donacion janë 5,552.80 euro, prej të cilave 5,355.02 euro bartje nga viti i kaluar dhe 197.78 euro të realizuara këtë vit, nga JUFREX janë realizuar këtë vit donacion prej 9,725.00 euro.


Me kërkesë të Ministrisë së Financave për deklaram të kursimeve gjatë rishikimit buxhetor, AD ka deklaruar si kursime buxhetore 132,000.00, ndërsa gjatë procesit të rishikimit janë reduktuar edhe 104,429.00 euro. Në total gjatë rishikimit të vitit 2020 janë deklaruar dhe reduktuar 236,429.00 euro nga këto kategori: 200,000.00 euro kategoria mallra dhe shërbime prej të cilave kursim 100,000.00 euro, reduktim 100,000.00 euro, kategoria shpenzime komunale 6,429.00 euro prej të cilave 2,000.00 euro kursim, reduktim 4,429.00 euro dhe nga kategoria shpenzime kapitale, për shkak të gjendjes me COVID -19, janë deklaruar kursim 30,000.00 euro.

Ndërsa me vendimin Nr.01/46 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, buxheti është zvogëluar (reduktuar) edhe për 102,762.69 euro në kategorinë mallra dhe shërbime. Poashtu me vendimin Nr.09/50 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, buxheti AD-së është reduktuar në këto vlera sipas kategorive: paga dhe mëditje është reduktuar në vlerë prej 42,905.91 euro, kategorinë mallra dhe shërbime në vlerë prej 60,321.45 euro dhe në kategorinë shpenzime komunale në vlerë prej 2,002.11 euro. Në total sipas vendimit nr.01/46 dhe 09/50 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, buxheti i Akademisë së Drejtësisë është reduktuar në vlerë prej 207,991.74 euro.

Buxheti përfundimtar për vitin 2020, në paga dhe mëditje është 219,038.08 euro, në mallra dhe shërbime 308,073.64 euro, prej të cilave 292,795.84 euro, nga buxheti dhe 15,277.80 euro donacionet dhe në shpenzime komunal 8,069.34 euro.

Përshkrimi	Buxheti	Shpenzimet	Shpenzimet në % në raport me buxhetin total	Mbetja	Përqindja	Shpërndarja e buxhetit në %
Pagat dhe Mëditjet	219,038	219,038	49%	-	100	42
Mallrat dhe Shërbimet	292,796	222,671	50%	70,125	76	56
Shpenzimet Komunale	8,069	6,949	2%	1,120	86	2
<b>Totali</b>	<b>519,903</b>	<b>448,658</b>	<b>100%</b>	<b>71,245</b>	<b>86</b>	<b>100</b>

Tabela nr. 5. Ekzekutimi i Buxhetit për vitin 2020




Grafikoni nr. 21 Ekzekutimi i Buxhetit për vitin 2020

Nga buxheti përfundimtar janë shpenzuar 448,658 euro apo 86.30 % e buxhetit. Pjesa e mjeteve të kursyera dhe të reduktuara nuk ka rrezikuar aktivitetet e AD-së. Këto kursime dhe reduktime janë bërë për shkak të gjendjes së krijuar nga pandemia COVID – 19.



Grafikoni nr. 23: Shpërndarja e buxhetit

Sipas këtij grafikoni shihet se 56% e buxhetit përfundimtar është ndarë për mallra dhe shërbime, 42% për paga dhe mëditje dhe 2% për shpenzimet komunale.



Grafikoni nr. 24: Shpenzimi i buxhetit

Në raport me shumën totale të buxhetit të shpenzuar, mallrat dhe shërbimet përfshihen me 49.63%, pagat dhe mëditjet me 48.82% dhe shpenzimet komunale me 1.55%

Në tabelën në vazhdim përveç kategorive ekonomike shpenzimet prezantohen edhe për nënkategoritë ekonomike duke krahasuar me buxhetin e vitit për secilën nënkategori.

## Shpenzimet sipas kategorive dhe nënkategorive 2020

Numri i Llogarisë	Emri i Llogarisë	Shpenzimet	Buxheti	Ndryshimi	Përqindja
<b>Paga</b>					
11110	Pagat neto përmes listës	185,902.66	185,902.66	-	100.00
11500	Tatimi i ndalur në të ardhura	12,274.36	12,274.36	-	100.00
11600	Kontributi i punëtorit	10,430.53	10,430.53	-	100.00
11700	Kontributi i punëdhënësit	10,430.53	10,430.53	-	100.00
<b>Shuma</b>		<b>219,038.08</b>	<b>219,038.08</b>	<b>-</b>	<b>100.00</b>
<b>Mallra dhe Sherbime</b>					
13132	Akomodimi udhëtime zyrtre brenda vendit	-	-	-	-
13141	Meditjet për udhëtime zyrtre jashtë vendit	288.00	3,000.00	2,712.00	9.60
13142	Akomodimi udhëtime zyrtre jashtë vendit	-	2,000.00	2,000.00	-
13143	Shpenzime tjera udhëtime zyrtre jashtë vendit	142.20	500.00	357.80	28.44
13320	Shpenzimet e telefonisë mobile	2,480.14	3,000.00	519.86	82.67
13330	Shpenzimet postare	-	-	-	-
13410	Shërbimet e arsimit trajnimit	83,983.91	100,000.00	16,016.09	83.98
13430	Shërbime të ndryshme shëndetsore	-	-	-	-
13440	Shërbime të ndryshme intelektuale dhe këshilldhënëse	1,667.25	2,025.22	357.97	82.32
13450	Sherbime shtypje-jo marketing	130.80	300.00	169.20	43.60
13460	Sherbime kontraktuese tjera	7,881.23	10,000.00	2,118.77	78.81
13501	Mobilje (me pak se 1000 euro)	3,325.00	3,500.00	175.00	-
13509	Pajisje tjera	2,575.80	3,000.00	424.20	85.86
13610	Furnizime per zyre	1,484.62	8,000.00	6,515.38	18.56
13620	Furnizim me ushqim, pije (jo dreka zyrtare)	2,392.70	6,000.00	3,607.30	39.88
13640	Furnizime pastrimi	1,756.00	2,000.00	244.00	87.80
13720	Nafte per ngrohje qendrore	7,343.25	9,600.00	2,256.75	76.49
13770	Derivate per gjenerator	-	1,300.00	1,300.00	-
13780	Karburant per vetura	1,368.22	5,000.00	3,631.78	27.36
13951	Sigurimi i automjeteve	176.04	176.04	-	100.00
13952	Taksat Komunale e Regjistrimi te automjeteve	-	-	-	-
13953	Sigurim I ndertesave dhe tjera	6,999.02	9,000.00	2,000.98	77.77
13950	Regjistrim i automjeteve	179.50	179.50	-	-
14010	Mirembajtje dhe riparim i automjeteve	36.00	4,000.00	3,964.00	0.90
14020	Mirembajtje e ndertesave	7,339.61	10,000.00	2,660.39	73.40
14040	Mirembajtje e teknologjise informative	951.00	2,300.00	1,349.00	41.35
14050	Mirembajtje e mobiljeve dhe pajisjeve	804.28	3,200.00	2,395.72	25.13
14110	Qiraja e ndertesave	75,115.08	75,115.08	-	100.00
14130	Qiraja per pajisjet	1,381.79	6,000.00	4,618.21	23.03
14140	Qiraja per makineri	9,815.52	16,600.00	6,784.48	59.13
14210	Reklamat dhe konkurset	-	1,000.00	1,000.00	-
14220	Botimet e publikimeve	2,761.37	5,000.00	2,238.63	55.23
14310	Dreka zyrtare	292.50	1,000.00	707.50	29.25
<b>Shuma</b>		<b>222,670.83</b>	<b>292,795.84</b>	<b>70,125.01</b>	<b>76.05</b>
<b>Komunali</b>					
13210	Rryma	4,173.23	4,569.34	396.11	91.33
13220	Uji	344.41	400.00	55.59	86.10
13230	Mbeturinat	515.50	600.00	84.50	85.92
13250	Shpenzimet e telefonit	1,915.73	2,500.00	584.27	76.63
<b>Shuma</b>		<b>6,948.87</b>	<b>8,069.34</b>	<b>1,120.47</b>	<b>86.11</b>
<b>Totali</b>		<b>448,657.78</b>	<b>519,903.26</b>	<b>71,245.48</b>	<b>86.30</b>

Tabela nr. 5. Shpenzimet për kategori dhe nën kategori ekonomike

## 5.6 Mbështetja financiare nga donatorët

Shpenzimet e prezantuara në kuadër të këtij shënimi janë shpenzimet e krijuara me rastin e implementimit të projektit me GIZ dhe JUFREX.

Totali i donacioneve të realizuara për vitin 2020 ka qenë 15,277.80 euro, nga GIZ donacion janë 5,552.80 euro, prej të cilave 5,355.02 euro bartje nga viti i kaluar dhe 197.78 euro të realizuara këtë vit, nga JUFREX janë realizuar këtë vit donacion prej 9,725.00 euro.

Donacionet e menaxhuara nga AD

Viti	Emri i Donatori	Shpenzimet	Alokimi	Mbetja
2020	GIZ	5,552.80	5,552.80	-
2020	JUFREX	256.5	9,725.00	9,468.50
<b>Shuma</b>		<b>5,809.30</b>	<b>15,277.80</b>	<b>9,468.50</b>

Tabela nr. 6. Donacionet e menaxhuara nga AD

Donacionet e menaxhuara nga donatorët

			2020
Emri donatorit	Nr.i projektit	Emëri i projektit	Euro
Ambasada SHBA - US DOJ/OPDAT			4,300.00
GIZ			30,000.00
USDOL			1,200.00
OSCE			9,300.00
<b>Totali i Granteve në euro</b>			<b>44,800.00</b>

Tabela nr. 7. Donacionet e menaxhuara nga donatorët

Në tabelën 8 shpalosen donacionet e menaxhuara nga vet donatorët që do të thotë se këto mjete nuk kanë rrjedhë përmes llogarisë së Thesarit.

Sipas informatave të ofruar nga përfaqësuesit e projekteve me donatorë në këtë tabelë bëhet shpalosja e mbështetjes financiare nga donatorët vetëm në totalin e shpenzimeve ashtu siç janë pranuar, pa pasur mundësi të shpalosen në detaje.

Prezantimi dhe shpalosja e donacioneve në këtë rast tregon se AD edhe në këtë vit ka realizuar aktivitetet trajnuese në mbështetje të donatorëve të ndryshëm. Edhe pse nuk janë të specifikuar dhe të detajuara, shpenzimet e mbuluara kanë qenë kryesisht shpenzimet për shërbimet e trajnimit, shpenzimet e botimeve dhe publikimeve etj.

### 6.7 Auditimi nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm

Në periudhën raportuese ka përfunduar auditimi nga ZKA për vitin 2019 dhe raport i auditimit është publikuar. Raporti final i Auditimit të pasqyrave financiare të AD-së për vitin 2020 është vlerësuar pozitiv dhe pasqyrat vjetore financiare në të gjitha aspektet kanë prezantuar një pamje të drejtë dhe të vërtetë. Me qëllim të zbatimit të rekomandimeve të dala nga ky raport është përgatitur dhe zbatuar plani për rekomandimin e dhënë në lidhje me çështjet e gjetura gjatë vitit 2019.

Rekomandimet dhe plani i zbatim

Nr	Rekomandimi	Veprimi i ndërmarrë	Afati i zbatimit	Statusi aktual i rekomandimit	Vleresimi i rrezikut
1	Mos regjistrimi i pasurive në regjistrat përkatës	Është bërë regjistrimi i softverit ( pasurisë ) në regjistrat përkatës	Qershor - Dhjetor 2020	Plotësuar	
2	Dobësi në raportimin e obligimeve të papaguara	Duke filluar nga data 01 shtator të gjitha obligimet qe kanë kaluar afatin e pagese do të prezantohen sipas ligjeve dhe rregulloreve në fuqi	Shtator - Dhjetor 2020	Plotësuar	

Tabela nr.8. Plan i zbatim të rekomandimeve

### IX. Sfidat dhe rekomandimet

Viti 2020 është përcjellë me sfida të shumta duke përfshirë edhe pandeminë COVID 19 e cila ka ndikuar tërësisht në realizimin e aktiviteteve të Akademisë së Drejtësisë. Përveç kësaj, Akademia ka pasur edhe sfida të tjera në aspektin legjislativ, burimeve njerëzore respektivisht numrit të vogël të stafit, si dhe sfida të tjera për në detaje gjendet si në vijim:

- Rishikimi institucional i sistemit të drejtësisë;
- Forma e re e realizimit të trajnimeve (virtuale), për shkak të pandemisë (mos aplikimi i pajisjeve që vërteton prezencën apo mos prezencën në trajnim);
- Pjesëmarrja jo aktive në trajnimet virtuale;
- Mungesa e trajnuesve të profilizuar;
- Sigurimi i buxhetit sipas planifikimeve të përcaktuara në programet trajnuese;
- Hartimi dhe zbatimi i programeve trajnuese në mbështetje të reformave të sistemit gjyqësor e prokurorial;
- Personeli i pamjaftueshëm, i kualifikuar dhe profesional për të realizuar funksionet ligjore;
- Promovimi i bashkëpunimit ndërinstitucional me institucionet përgjegjëse të sistemit të drejtësisë në vendin tonë;
- Ndryshimet legjislative të cilat kanë ndikim direkt dhe indirekt në punën e përfituesve dhe të vet Akademisë;
- Ndërtimi i sistemit të monitorimit të trajnimeve dhe efektit të tyre në punë;

- Mungesa e literaturës dhe burimeve tjera për trajnime në gjuhën shqipe;
- Zbatimi i metodologjisë bashkëkohore të trajnimit veçanërisht të metodologjisë së trajnimit të bazuar në raste.
- Ngritja profesionale e stafit të AD-së;
- Rishikimi i webfaqes.

Për tejkalimin e sfidave të lartpërmendura, Akademia e Drejtësisë jep këto rekomandime:

- Alokimi i buxhetit të nevojshëm për transferimin në ndërtesën e re të Akademisë;
- Rritja e buxhetit sipas nevojave dhe kërkesës buxhetore të dorëzuar në Ministrinë e Financave;
- Rritja e numrit të punësuarve dhe pranimi i statusit të ngjashëm të punësuarve në Akademi me ata të punësuar në sistemin gjyqësor, përkatësisht KGJK dhe KPK në mënyrë që të ndalet trendi i largimit të stafit nga Akademia që kalojnë në sistemin gjyqësor;
- Të rishikohet dhe rregullohet organizimi i brendshëm i AD sipas nevojave dhe praktikave më të mira në institucionet trajnuese ndërkombëtare;
- Të plotësohet dhe ndryshohet ligji për AD dhe të mundësohet nxjerrja e akteve nënligjore të domosdoshme;
- Të rregullohet nëpërmes ligjit komunikimi ndër-institucional me KGJK dhe KPK.

## X. Aneksat

Si pjesë e Raportit Vjetor të Punës së AD-së për vitin 2020, janë bashkëngjitur edhe anekset si më poshtë:

- Aneksi 1-Trajnimet e realizuara në PTV;
- Aneksi 2-Trajnimet e realizuara në PTF;
- Aneksi 3-Aktivitetet e realizuara në PHP;
- Aneksi 4-Aktivitetet e realizuara për stafin administrativ të gjykatave dhe prokurorive;
- Aneksi 5-Trajnimet e realizuara për trajnues;
- Aneksi 6-Trajnimet e realizuara për profesionet e lira;
- Aneksi 7-Trajnimet e realizuara përmes platformës së mësimit në distancë;



**Aneksi 1 – Trajnimet e realizuara në PTV**

Muaji	Nr.	Tema e trajnimit	Ditët	Lëmia
Janar	1.	Masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit	1	Penale
	2.	Shqyrtimi paraprak i padisë	1	Civile
Shkurt	3.	Program i Specializuar - Krimi i organizuar dhe korrupsioni - Sesioni I	2	Penale
	4.	Procedura gjyësore në rastet e mbrojtjes nga dhuna në familje	1	Civile
	5.	Ndërmjetësimi Regjioni i Prishtinë	1	(penale, civile dhe ekonomike)
	6.	Risitë në Ligjin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme	1	DHPGJS
	7.	Veprat penale të narkotikëve	1	penale
	8.	Ndërmjetësimi Regjioni Ferizaj	1	(penale, civile dhe ekonomike)
	9.	E Drejta në Gjykim te Drejtë – neni 6 i KEDNJ	1	KEDNJ
	10.	Hetimet financiare	4	Penale
	11.	Ndërmjetësimi Regjioni Gjilan	1	(penale,civile dhe ekonomike)
	12.	Kontestet tregtare – mos përmbushja e kontratave	2	Ekonomike
	13.	Ndihma e ndërsjellët juridike e Kosovës me vendet jo-njohëse	1	Penale
Mars	14.	Mbrojtja gjyqësore në rastet e së drejtës së pronësisë, servituteve dhe pengimit të posedimi	2	Civile
	15.	Ndërmjetësimi Regjioni Mitrovicë	1	Penale,civile dhe ekonomike
	16.	Procedura penale ku përfshihen kryerësit me çrregullime mendore	1	Penale
	17.	Ndërmjetësimi Regjioni Pejë	1	Penale,civile dhe ekonomike
Pril	18.	Bashkëpunimi juridik ndërkombëtar-në lëminë civile	2	Penale
	19.	Sekuestrimi dhe konfiskimi	2	Penale
	20.	Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative-Udhëzuesi praktik	2	Administrative
	21.	Dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje- HELP/KE	1	Penale

Maj	22.	Program i Specializuar Trajnimi - Shpërlarja e Parave- Sesioni I	2	Penale
	23.	Shqyrtimi kryesor dhe mjetet provuese	2	Civile
	24.	Ndërmjetësimi Regjioni Prizren dhe Gjakovë	1	Penale, civile dhe ekonomike
	25.	Procedura gjyqësore në rastet e kompensimit të dëmit dhe kriteret e vlerësimit	2	Civile
	26.	Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve pa kujdes prindëror dhe në rastet e ndryshimit të statusit të tyre	2	Civile
Qershor	27.	Burimet e së drejtës, analogjia dhe interpretimi i zotësisë juridike dhe zotësisë së veprimit së personave fizik dhe juridik si dhe punët juridike	1	Civile
	28.	Masat e Diversitetit	2	Drejtësia për fëmijë - Penale
	29.	E drejta për liri dhe siguri-neni 5 i KEDNJ	2	KEDNJ
	30.	Procedura gjyqësore në rastet e shpronësimit	2	Civile
	31.	Program i Specializuar Trajnimi për Prokurimin Publik të Kosovës - Sesioni I	2	Penale
	32.	Pastrimi i parave me ekspertë të sektorit publik dhe privat të Italisë	2	Penale
	33.	Hartimi dhe arsyetimi i vendimeve gjyqësore	2	Civile
	34.	Program i Specializuar Trajnimi-Krimi kibernetik, provat elektronike - Sesioni I	2	Penale
	35.	Mjetet e përmbarimit	2	Civile
Korrik	36.	Marrja në pyetje e të dëmtuarit në veprat penale kundër integritetit seksual	2	Penale
	37.	Mbrojtja gjyqësore në kontestet nga marrëdhënia e punës sipas Ligjit të Punës	2	Civile
	38.	Falimentimi	2	Ekonomike
	39.	Program i Specializuar Trajnimi - Krimi i organizuar dhe korrupsioni- Sesioni II	2	Penale
	40.	Trafikimi i qenieve njerëzore dhe kontrabandimi më migrantë	2	Penale
	41.	Program i Specializuar-Krimi kibernetik, provat elektronike - Sesioni II	2	Penale
Gusht	42.	Avancim mbi të drejtat e personave LGBTI në Kosovë	1	Kundërdiskriminimit
	43.	Faza e procedurës paraprake – hetimet proaktive dhe sigurimi i provave	2	Penale
	44.	Program i Specializuar Trajnimi- Shpërlarja e Parave-Sesioni II	2	Penale

Shtator	45.	Mbrojtja e nevojshme, nevoja ekstreme dhe rrethanat e tjera që e përjashtojnë kundërligjshmërinë e veprës penale	1	Penale
	46.	Pavlefshmëria absolute dhe relative e kontratave si dhe bazat e përgjegjësisë për kompensimin e dëmit	2	Civile
	47.	Masat edukative dhe dënimet	1	Drejtesia për Fëmijë - Penale
	48.	Arbitrazhi	2	Ekonomike
	49.	Etika profesionale (sistemi prokurorial)	1	Interdisiplinare
	50.	Personat juridik në procedurën e kundërvajtjes	1	Kundërvajtje
	51.	Fillimi dhe zhvillimi i konflikteve administrative	1	Administrative
	52.	Etika profesionale (sistemi prokurorial)	1	Interdisiplinare
	53.	Program i Specializuar Trajnimi- Prokurimi Publik i Kosovës- Sesiioni II	2	Penale
	54.	Vendimet gjyqësore në Procedurë Kontestimore	1	Civile
	55.	Avancimi i konfiskimit të pasurisë së paligjshme	2	Penale
	56.	Vendimet e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, efektet juridike dhe mënyra e përmbarimit të tyre	1	Civile
	57.	Avancimi i konfiskimit të pasurisë së paligjshme	2	Penale
	Tetor	58.	Lejimi i përmbarimit dhe procedura sipas prapësimit, ankesës dhe mjeteve të jashtëzakonshme juridike në Procedurën Përmbarimore	1
59.		Zbatimi i Udhëzuesit për Politikën Ndëshkimore	2	Penale
60.		Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve në rastet e shkurorëzimit dhe në rastet e dhunës në familje	2	Civile
61.		E drejta në Pronë - Jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut	1	KEDNJ
62.		Procedura kundërvajtëse sipas kërkesave të inspektorateve	1	Kundërvajtje
63.		Mjetet juridike të rregullta dhe të jashtëzakonshme sipas ligjit për procedurën kontestimore	1	Civile
64.		Fitimi i pronësisë në mënyrë orgjinere/ Komentimi i rasteve-vendimeve të gjykatave	1	Civile
65.		Etika Profesionale (sistemi prokurorial Gr. III)	1	Interdisiplinare
66.		Procedura Administrative dhe Procedura e Konfliktit Administrativ në fushën e Skemave Pensionale, Kontestet e Shërbimit Civil, Tatimi dhe Dogana dhe Agjencise Kadastrale	1	Administrative
67.		Program i Specializuar Trajnimi - Krimi i organizuar dhe korrupsioni-Sesioni III	2	Penale

	68.	Regjimi pasuror martesor sipas Kodit Civil/ Komentim i Rasteve të gjykatave	1	Civile
Nëntor	69.	Krimet e Luftës	2	Penale
	70.	Mjetet e rrëzimit të vendimeve pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme	1	DHPGJS
	71.	Sesioni 1 - Trafikimin për qëllime të shfrytëzimit për punë të detyruar	1	Penale
	72.	E drejta e ndërtimit dhe qiraja afagjate në tokë	1	Civile
	73.	Intervistimi forenzik i fëmijëve	3	Penale
	74.	Zbatimi i Ligjit për Zyrtarët Publik	3	Administrative
	75.	Bashkëpunimi juridik ndërkombëtar - në lëmin penale	1	Penale
	76.	Sesioni 2 - Trafikimi i fëmijëve dhe të rriturve për qëllime seksuale	1	Penale
	77.	Ndërmjetësimi	1	Civile
	78.	Program i Specializuar Trajnimi - Krimi kibernetik dhe provat elektronike-Sesioni III	2	Penale
	79.	Shkathtësitë e përfaqësimit në gjykim	3	Penale
	80.	Sesioni 3 - Trafikimi përmes internetit/online	1	Penale
	81.	Avancimi mbi të drejtën e personave LGBTI në Kosovë	1	Kundër diskriminimit
	82.	Tryezë me gjyqtarë dhe avokatë Harmonizimi i vendimeve të gjykatave në çështje civile	1	Civile
	83.	Liria e shprehjes dhe mbrojtja nga shpifja - neni 10 i KEDNJ	2	KEDNJ
Dhjetor	84.	Program i Specializuar Trajnimi – Shpëlarja e Parave-Sesioni III	2	Penale
	85.	Mbikqyrja e ligjshmërisë së punës dhe inspektimin e përmbaruesve	1	Civile
	86.	E Drejta e Azilit dhe legjislacioni në fuqi	1	Administrative
	87.	Ligji për Pyjet e Kosovës, Mbrojtjen e Natyrës dhe Mbrojtjen e Ambientit	1	Kundërvajtje
	88.	Tryezë - Harmonizimi i vendimeve të gjykatave në çështjet trashëgimore	1	Civile
	89.	Tryezë - Komentimi i vendimeve të gjykatave/ Harmonizimi në çështjet detyrimore	1	Civile

## Aneksi 2 – Aktivitetet e realizuara në PTF

Muaji	Nr. i ditëve të trajnimit teorik dhe praktik	Aktivitetet për gjyqtarët e sapo emëruar gjen.VII dhe e prokurorëve, gjen. VIII	Numri i sesioneve dhe ditët e trajnimit praktikë	Financimi
Janar	39	Kodi Penal – pjesa e përgjithshme	4	AD
		Kodi Penal – pjesa e veçantë	4	
		Veprat Penale të korrupsioni dhe kundër detyrës zyrtare	2	
		Parashkrimi	4	
		Administrimi i procedurës penale	2	
		Masat për sigurinë e të pandehurit në procedurën penale	2	
		Kontrolli dhe konfiskimi	2	
		Vendi i ngjarjes dhe forenzika	2	
		Ushtrimi i mjeteve juridike	3	
		Procedurat e veçanta sipas KPPK	2	
		Shpenzimet e Procedurës	1	
		Marrja dhe komunikimi i vendimeve	1	
		E drejta kushtetuese	1	
		Vija ndarëse mes veprave penale dhe kundërvajtjes	1	
		Bashkëpunimi juridik ndërkombëtarë në lëminë penale	1	
		Numri i ditëve të trajnimit praktik në gjykatë dhe në prokurori	21	
Shkurt	37	Procedura e veçanta sipas KPPK	2	AD
		Procedura sipas mjeteve juridike	2	
		Kontrolli dhe konfiskimi	5	
		Ekspertiza dhe analiza	4	
		Masat e fshehta të hetimit dhe vëzhgimit	4	
		Masat për sigurinë e pranisë së të pandehurit	1	
		Shqyrtimi fillestar dhe i dytë gjyqësor	1	
		Provat në procedurën penale	1	
		KEDNJ	5	
		E drejta e BE-së	4	
		Rregullat e komunikimit	2	
		Numri i trajnim praktik në gjykatë dhe prokurori	20	

Mars	20	Zhvillimi i shkathtësive gjyqësore	3	AD
		Shqyrtimi fillestar dhe i dytë gjyqësor	4	
		Provat në procedurën penale	2	
		KEDNJ	3	
		Kontrolli dhe konfiskimi	3	
		Etikë profesionale	2	
		Provat në procedurën penale	2	
		Zhvillimi i shkathtësive gjyqësore	6	
		Simulim gjykimi	2	
		Trajnim praktik në gjykatë dhe prokurori	10	
Prill	6	Provat në procedurë penale	3	AD
		Dëshmitarët dhe të dëmtuarit	2	
		Ngritja e shkathtësive sociale	3	
		Menaxhimi i stresit	2	
		Kodi i drejtësisë për të mitur	1	
		Ndërmjetësimi	2	
Maj	11	Menaxhimi i rasteve	3	AD
		Etikë profesionale	6	
		E drejta e BE-së	3	AD+IRZ
		Dëshmitarët dhe të dëmtuarit	3	AD
		I pandehuri në procedurë penale	5	
		Etikë profesionale	2	
Qershor	42	Organizimi i sistemit gjyqësor dhe prokurorial	2	AD
		Shqyrtimi fillestar, i dytë dhe shqyrtimi gjyqësor	1	
		Arsyetimi i vendimeve/akteve akuzuese	6	
		Trajnim praktik në gjykatë dhe prokurori	31	
Korrik	23	Hetimi i krimit ndërkuftar	3	AD
		KEDNJ	2	
		Trajnim praktik në prokurori	15	
Gusht	20	Trajnimi praktik në prokurori	20	

**Aneksi 3 – Aktivitetet e realizuara në PHP**

Periudha Kohore	Aktivitetet/ Publikime	Përfituesit	Financimi
<b>Janar</b> <b>Dhjetor</b>	Ofrimi i burimeve ligjore sipas kërkesave të përfituesve Programi Trajnues 2020 Plani i Punës 2020 Buletini informativ i AD-së	Kategoritë përfituese të AD-së	AD
<b>Qershor</b> <b>Dhjetor</b>	Puna me Redaksionin e revistave	Kategoritë përfituese të AD-së	AD
<b>Korrik</b> <b>Gusht</b>	Vlerësimi i nevojave trajnuese në fushën e diskriminimit	Kategoritë përfituese të AD-së	UNDP
<b>Shtator</b> <b>Dhjetor</b>	Hulumtime dhe analiza për vlerësimin e nevojave të gjyqtarëve dhe prokurorëve për trajnime si dhe për zhvillimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve trajnuese për vitin 2021 Publikimi Udhëzuesit për procedurën e konfliktit administrativ Programi Kornizë 2021 Revista Justicia Programi i Trajnimit Fillestar për gjyqtarët e sapo emëruar, gjenerata e VIII	Kategoritë përfituese të Akademisë	AD Twining

**Aneksi 4 – Aktivitetet e realizuara për stafin administrativ të gjykatave dhe prokurorive**

Muaji	Nr.	Tema e trajnimit	Ditët	Financuesi
Janar	1	Bazat e përkthimit konsektiv (marrja e shënimeve) për përkthyes gjyqësor-Gr.III - (Staf Administrativ)	2	USAID /JSSP (Justice System Strengthening Program in Kosovo)
Shkurt	2	Trajnim për protokolin	2	AD
Mars	3	Sistemi gjyqësor, struktura dhe kompetencat	1	AD
Shator	4	Menaxhimi i punës në administratën e sistemit gjyqësor dhe prokurorial	1	
Tetor	5	Shkrimi dhe arsyetimi ligjor - (Staf administrativ)	1	
Tetor	6	Menaxhimi i dosjes dhe lëndës në sistemin gjyqësor dhe prokurorial - (Staf administrativ)	1	
Nëntor	7	Integriteti dhe sjelljet etike	2	
Dhjetor	8	Menaxhimi i TIK-(sistemi SMIL)	1	
	9	Menaxhimi i kohës dhe stresit	2	
	10	Të drejtat e njeriut dhe garancitë juridike dhe procedurale për mbrojtjen e tyre - (Staf administrativ)	2	UNDP



**Aneksi 5 – Trajnimet e realizuara për trajnues**

Muaji	Nr.	Tema e trajnimit	Ditët	Financuesi
Janar	1	Bazat e përkthimit konsektiv (marrja e shënimeve për përkthyes gjyqësor)	1	USAID /Fuqizimi e Sektorit të Drejtësisë në Kosovë – JSSP
Janar	2	Trajnim për trajnues rreth udhëzuesit për përdorim të HUDOC	1	UNDP
Gusht-shtator	3	Hartimi i Avancuar i Aktakuzave	5	OSCE
Tetor	4	Trajnim për Trajnues (ToT) - Analizë praktike e rasteve dhe avokimit në gjykim	2	AXIOM
Tetor	5	Trajnimit për Trajnerë në Fushën e Lirisë së Shprehjes	1	(JUFREX 2)”, pjesë e Programit të përbashkët të Bashkimit Evropian/Këshillit të Evropës
Nëntor	6	Trajnimit i Trajnuesve në fushën e Drejtësisë Komerciale	4	USAID / Checchi&Company Consulting Inc.,

**Aneksi 6 - Trajnimet e realizuara për profesionet e lira (Zyrtarët nga Agjencioni për Ndihmë Juridike Falas si dhe Përmbaruesit Privat)**

Muaji	Nr.	Tema e trajnimit	Ditët	Financuesi
Janar	1	Shqyrtimi paraprak i padisë - ( përfitues ANJF)	1	AD & GIZ
	2	Mënyra e fitimit të pronësisë dhe mbrojtja e saj ( përfitues ANJF)	1	AD & GIZ
Shkurt	3	Mbrojtja gjyqësore nga pengim posedimi dhe servitutet ( përfitues ANJF)	1	AD & GIZ
	4	Shpërblimi i dëmit material dhe jo material ( përfitues ANJF)	1	AD & GIZ
Dhjetor	5	Mbikëqyrja e ligjshmërisë së punës së përmbaruesve privat ( përfitues Përmbaruesit privat)	1	AD & Oda e përmbaruesve privat

Aneksi 7 – Kurset trajnuese përmes platformës së mësimi në distancë

Muaji	Nr.	Tema e trajnimit	Ditët	Financuesi
Janar – Dhjetor	1	(Etika Profesionale) Procedura dhe përgjegjësia disiplinore(Shqip)	275	AD
	2	Etika Profesionale I	275	AD
	3	Etika Profesionale II	275	AD
	4	(Etika Profesionale) Procedura dhe përgjegjësia disiplinore(Serbisht)	275	AD
	5	Etika Profesionale I (Serbisht)	275	AD
	6	Etika Profesionale II (Serbisht)	275	AD
	7	Masat e diversitetit	275	AD
	8	Masat e diversitetit (Serbisht)	275	AD
	9	Menaxhimi efektiv (Shqip)	275	AD
	10	Menaxhimi efektiv (Serbisht)	275	AD
	11	Drejtësia për fëmijë aspekti civil	275	AD
	12	Drejtësia për fëmijë aspekti Penal	275	AD
	13	Hetimi dhe zbulimi i korrupsionit	275	AD
	14	Korrupsioni sipas legjislacionit vendor dhe ndërkombëtar	275	AD
	15	Menaxhimi i Gjykatës	275	AD
	16	Udhëheqësia - Lidershipi	275	AD
	17	E drejta e autorit dhe mbrojtja juridike (Shqip)	275	AD
	18	E drejta e autorit dhe mbrojtja juridike (Serbisht)	275	AD
	19	Faza e aktakuzës dhe deklarimit për Fajësinë (Shqip)	275	AD
	20	Faza e aktakuzës dhe deklarimit për Fajësinë (Serbisht)	275	AD
	21	Menaxhimi i stresit (Shqip)	275	AD

Janar – Dhjetor	22	Menaxhimi i stresit (Serbisht)	275	AD
	23	Shkathësitë e komunikimit social (Shqip)	275	AD
	24	Shkathësitë e komunikimit social (Serbisht)	275	AD
	25	Anglishtja Ligjore	275	AD
	26	Teknologjia Informative	275	AD
	27	Trajnimi për implementimin e legjislacionit tatimor në Kosovë (Shqip)	275	AD
	28	Trajnimi për implementimin e legjislacionit tatimor në Kosovë (Serbisht)	275	AD
	29	Komunikimi dhe marrëdhëniet me publikun (Shqip)	275	AD
	30	Komunikimi dhe marrëdhëniet me publikun (Serbisht)	275	AD
	31	Dhuna në Familje (Shqip)	275	AD&INJECT
	32	Dhuna në Familje (Serbisht)	275	AD&INJECT
	33	Mbajtja e shënimeve për Interpret Gjyqësor	275	AD&JSSP
	34	Mbajtja e shënimeve për Interpret Gjyqësor (Serbisht)	275	AD&JSSP

**Aneksi 8 – Aktivitetet me donatorë**

	<b>GIZ&amp;LARP</b>
	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Shqyrtimi paraprak i padisë dhe i kërkesëpadisë (trajnim për zyrtarët e ANJF)</li> <li>• Mënyra e fitimit të pronësisë dhe mbrojtja e saj (trajnim për zyrtarët e ANJF)</li> <li>• Takimi fillestar i luftimit të fluksit të paligjshëm financiar në Ballkanin Perëndimor</li> <li>• Mbrojtja gjyqësore nga pengim posedimi dhe servitutet (ANJF)</li> <li>• Shpërblimi i dëmit material dhe jo material (ANJF)</li> <li>• Procedura penale ku përfshihen kryesit me çrregullime mendore (trajnim për gjyqtare dhe prokurore)</li> <li>• Procedura gjyqësore në rastet e shpronësimit</li> <li>• Mjetet e përmbarimit</li> <li>• Fillimi dhe zhvillimi i konfliktit administrativ</li> <li>• Procedura Administrative dhe Procedura e Konfliktit Administrativ në fushën e Skemave Pensionale, Kontestet e Shërbimit Civil, Tatimi dhe Dogana dhe Agjencisë Kadastrale</li> <li>• Zbatimi i Ligjit për zyrtarët publik</li> <li>• E Drejta e Azilit dhe legjislacioni në fuqi</li> <li>• Ligji për Pyjet e Kosovës, Mbrojtjen e Natyrës dhe Mbrojtjen e Ambientit</li> </ul>
	<b>USAID- Millenium DPI Partners JSSP Fuqizimi i sektorit të drejtësisë-JSSP</b>
	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Bazat e përkthimit konsektiv (marrja e shënimeve) për përkthyes gjyqësor</li> <li>• Takim me trajnuesit nga radhët e përkthyesve dhe interpretëve gjyqësor</li> </ul>
	<b>USAID-Drejtësia komerciale implementuar nga Checchi and Co. Consulting, Inc.</b>
	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndërmjetësimi në aspektin penal, civil dhe ekonomik-regjioni i Prishtinës</li> <li>• Ndërmjetësimi në aspektin penal, civil dhe ekonomik-regjioni i Ferizajt</li> <li>• Ndërmjetësimi në aspektin penal, civil dhe ekonomik-regjioni i Gjilanit</li> <li>• Zgjidhja alternative e kontesteve-Ndërmjetësimi</li> <li>• Ndërmjetësimi në aspektin penal, civil dhe ekonomik-regjioni i Mitrovicës</li> <li>• Ndërmjetësimi në aspektin penal, civil dhe ekonomik-regjioni i Pejës</li> <li>• Ndërmjetësimi në aspektin penal, civil dhe ekonomik-regjioni i Prizrenit dhe Gjakovës</li> <li>• Procedura gjyqësore në rastet e kompensimit të dëmit dhe kriteret e vlerësimit</li> <li>• Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve pa kujdes prindëror dhe në rastet e ndryshimit të statusit të tyre</li> <li>• Burimet se së drejtës, analogjia dhe interpretimi i zotësisë juridike dhe zotësisë së veprimit të personave fizik dhe juridik si dhe punët juridike</li> <li>• Arbitrazhi</li> <li>• Vlerësimi i nevojave të trajnimit për drejtësinë komerciale</li> <li>• Zgjidhja Alternative e Kontesteve Ndërmjetësimi</li> <li>• Trajnimi për trajnues në drejtësinë komerciale</li> <li>• Zhvillimi i kurikulës për drejtësinë komerciale</li> </ul>
	<b>UNDP</b>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• TIT lidhur me Udhëzuesin për përdorimin e HUDOC</li> <li>• Pastrimi i parave me ekspertë të sektorit publik dhe privat të Italisë përmes projektit të SAEK II</li> <li>• Takimi i përbashkët AD me UNDP për zhvillimin e procesit për vlerësim të nevojave trajnuese për mosdiskriminimin</li> <li>• Takimi me përfaqësues nga zyra për qeverisje të mirë, zyrtarë nga institucioni i avokatit të popullit, shoqëria civile si dhe nga mediat për vlerësimin e nevojave trajnuese dhe hartimit të programit trajnues për mosdiskriminimin</li> <li>• Takimi me përfaqësues të ministrive dhe komunave për vlerësimin e nevojave trajnuese dhe hartimit të programit trajnues për mosdiskriminimin</li> <li>• Takimi me gjyqtarë dhe prokurorë për vlerësimin e nevojave trajnuese dhe hartimit të programit trajnues për mosdiskriminimin</li> <li>• Të drejtat e njeriut dhe garancitë juridike dhe procedurale për mbrojtjen e tyre</li> </ul>
	<p><b>Zyra e BE-së në Kosovë -Projekti i BE-së Mbështetje e Kodit Civil faza II</b></p>
	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Takimi me ekspertët e angazhuar</li> <li>• Mbrojtja gjyqësore në rastet e së drejtës së pronësisë, servituteve dhe pengimit të posedimit</li> <li>• Shqyrtimi kryesor dhe mjetet provuese</li> <li>• Fitimi i pronësisë në mënyrë orgjinere/ Komentimi i rasteve-vendimeve të gjykatave</li> <li>• Regjimi pasuror martesor sipas Kodit Civil / Komentim i rasteve të gjykatave</li> <li>• E drejta e ndërtimit dhe qiraja afatgjate në tokë</li> <li>• Tryezë me gjyqtarë dhe avokat – Harmonizimi i vendimeve të gjykatave në çështje civile</li> <li>• Procedura gjyqësore në rastet e kompensimit të demit dhe kriteret e vlerësimit</li> <li>• Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve pa kujdes prindëror dhe në rastet e ndryshimit të statusit të tyre</li> <li>• Burimet e së drejtës, analogjia dhe interpretimi i zotësisë juridike dhe zotësisë së veprimtë personave fizikë dhe juridikë si dhe punët juridike</li> <li>• Komentimi i vendimeve të gjykatave - Harmonizimi në çështjet detyrimore</li> <li>• Harmonizimi i vendimeve të gjykatave në çështjet trashëgimore</li> </ul>
	<p><b>Zyra e BE-së në Kosovë-Programi Evropian për Arsimimin e Profesionistëve Ligjor për të Drejtat e Njeriut (HELP - Human Rights Education for Legal Professionals)</b></p>
	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Zhvillimi i kurrikulës së TIT për gjyqtarë dhe prokurorë mbi dhunën në familje dhe dhunën ndaj grave</li> <li>• Në kuadrin e kursit HELP-Punëtori: Dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje</li> <li>• Konferenca HELP</li> <li>• Ceremoni e certifikimit të pjesëmarrësve në kursin: Dhuna kundër grave, dhuna në familje përmes platformës së mësimin në distancë HELP.</li> </ul>
	<p><b>Zyra e BE-së në Kosovë-dhe Këshillit të Evropës JUFREX - Reinforcing Judicial Expertise on Freedom of Expression and the Media in South-East Europe</b></p>
	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Liria e shprehjes dhe liria e mediave ne Kosovë (JUFREX2) - Trajnimi për Trajnerë në Fushën e Lirisë së Shprehjes</li> <li>• Liria e shprehjes dhe mbrojtja nga shpifja-neni 10 i KEDNJ-së</li> <li>• Gazetarët dhe rreziqet e dhunës ndaj grave</li> </ul>

	<b>Këshilli i Evropës</b>
	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Konferenca rajonale online - Mbrojtja e pronës: GJEDNJ dhe jurisprudenca kombëtare në Ballkanin Perëndimor</li> <li>• Tryezë diskutimi: Gazetarët dhe rreziqet e dhunës ndaj grave</li> </ul>
	<b>Zyra e BE-së EUO/EUSR</b>
	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndihma e ndërsjellë juridike e Kosovës me vendet jo njohëse</li> </ul>
	<b>OSBE</b>
	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Punësoria për rishikimin e PTF-së për gjeneratën e VIII-të gjyqtarëve të sapo emërua 2020/2021</li> <li>• TIT - Hartimi i avancuar i aktakuzave</li> <li>• Ceremonia e certifikimit të prokurorëve për trajnimin Hartimi i Avansuar i Aktakuzave</li> <li>• Intervistimi forenzik i fëmijëve</li> </ul>
	<b>UNODC</b>
	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Hetimet financiare</li> </ul>
	<b>Ambasada Amerikane - Departamenti i Drejtësisë/ OPDAT</b>
	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Sekuestrimi dhe konfiskimi</li> <li>• Program i Specializuar i trajnimit-Prokurimi Publik-Sesioni I</li> <li>• Avancimi i konfiskimit të pasurisë së paligjshme</li> <li>• Avancimi i konfiskimit të pasurisë së paligjshme</li> <li>• Trafikimi për qëllime të shfrytëzimit për punë të detyruar</li> <li>• Trafikimi me qëllim të shfrytëzimit seksual dhe çështjet që ndërlidhen me viktimat fëmijë dhe të mitur</li> <li>• Shkathësitë e përfaqësimit në gjykim</li> <li>• Hetimet në Internet në rastet e trafikimit me njerëz dhe çështjet që ndërlidhen me format e shfrytëzimit të fëmijëve” - Sesioni 3</li> </ul>
	<b>IFC/Grupi i bankës botërore</b>
	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Falimentimi</li> </ul>
	<b>CEL/Qendra për barazi dhe liri për të drejtat e komunitetit LGBTI</b>
	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Avancimi i të drejtave të personave LGBTI në Kosovë</li> <li>• Avancim mbi të drejtën e personave LGBTI në Kosovë</li> </ul>
	<b>Ambasada e Turqisë në bashkëpunim me projektin (Procesi i bashkëpunimit të Evropës Juglindore (SEECp))</b>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>Punëtori për zhvillimin e trajnimit fillestar dhe të vazhdueshëm pas pandemisë</li> </ul>
	<b>SEE JTI/ Këshilli Rajonal për Bashkëpunim (RCC) dhe Akademia Gjqësore e Serbisë</b>
	<ul style="list-style-type: none"> <li>Takimi i 4-të i rrjetit të institucioneve të trajnimit gjyqësor të Evropës Juglindore</li> </ul>
	<b>Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar – Projekti “Forcimi i sistemit të Drejtësisë në Kosovë AXIOM International”</b>
	<ul style="list-style-type: none"> <li>Forcimi i sistemit gjyqësor në Kosovë</li> <li>Analizë e rasteve praktike dhe shkathtësitë e avokimit në gjykim</li> </ul>
	<b>Programi praktik i kandidatëve të ENM-së në Kosovë i organizuar nga Akademia e Drejtësisë</b>
	<ul style="list-style-type: none"> <li>10 ditë Programi i praktikës në institucionet gjyqësore në Kosovë për kandidatet e Shkollës së Magjistraturës së Francës (ENM)</li> </ul>
	<b>Programi i Sektorit të Drejtësisë të Bashkimit Evropian/Kosovës “EUKOJUST”</b>
	<ul style="list-style-type: none"> <li>Forcimi i kapaciteteve të Akademisë së Drejtësisë</li> </ul>
	<b>IRZ –German Cooperation</b>
	<ul style="list-style-type: none"> <li>Bashkëpunimi juridik ndërkombëtar - në lëmin penale</li> <li>Program i Specializuar Trajnimi - Krimi kibernetik dhe provat elektronike-Sesioni III</li> <li>Program i specializuar Trajnimi - Shpëlarja e parave sesioni III</li> </ul>
	<b>ILO - Organizata Ndërkombëtare e Punës</b>
	<ul style="list-style-type: none"> <li>Angazhimi i fëmijëve në forma të rënda të punës dhe punë të detyruara</li> </ul>
	<b>TAIEX në bashkëpunim me EUROJUST</b>
	<ul style="list-style-type: none"> <li>Video-konferencë e TAIEX lidhur me themelimin e bashkëpunimit të Kosovës me Eurojust</li> </ul>
	<b>KOSEJ 2 i KE-së</b>
	<ul style="list-style-type: none"> <li>SurveyMonkey (platformë) pyetësori për vlerësimin e nevojave për trajnime për kryetar të gjykatave, gjyqtarë dhe staf administrativ</li> </ul>

**Akademia e Drejtësisë**  
<https://ad.rks-gov.net>  
[infoad@rks-gov.net](mailto:infoad@rks-gov.net)  
Rr. "Muharrem Fejza"-Prishtinë  
Tel:+383 38 200 18 660